



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 157

Tiranë – E mërkurë, 22 korrik 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 58/2026, datë 18.6.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar..... 16217
Dekret i Presidentit nr. 401, datë 17.7.2026	Për shpallje ligji..... 16219
Udhëzim i ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 7, datë 15.7.2026	Për përcaktimin e kushteve, kritereve, procedurave dhe mënyrave për dhënien e miratimit, për ekspozimin e pasurive kulturore, masave të nevojshme për ruajtjen dhe garantimin e integritetit të tyre, si dhe procedurave, mënyrave dhe kushteve të lëshimit të deklaratës së marrjes përsipër të rrezikut..... 16219
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 10917, datë 17.7.2026	Për hyrjen në fuqi të marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadër të WIPO-s..... 16226
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 62, datë 1.6.2026	Me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar detyrimin e Kuvendit për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit: i. “Për verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve të zyrtarëve shqiptarë në raport me ish-agjentin special të FBI-së <i>Charles McGonigal</i> ”; ii. “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, si dhe për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 11 majit 2025”. Deklarimin e vendimit nr. 77/2025 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për mosmiratimin e projektvendimit ‘Për ngritjen e komisionit hetimor për verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve të zyrtarëve shqiptarë në raport me ish-agjentin special të FBI-së <i>Charles McGonigal</i> ’, si të pajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Deklarimin e vendimit nr. 78/2025 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për mosmiratimin e projektvendimit ‘Për ngritjen e

	komisionit hetimor për kontrollin e ligjshmërisë së veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, si dhe për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 11 majit 2025”, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	16227
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 66, datë 3.6.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 810 regj. them., datë 27.10.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 465 (30-2023-1596), datë 25.4.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; nr. 00-2025-596 (89), datë 8.4.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	16241
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 81, datë 2.7.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 370, datë 30.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 194 (87-2024-282), datë 10.10.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-159, datë 30.1.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilët vazhdon masa e sigurimit “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, të caktuar ndaj shtetasit Evis Berberi me anë të vendimeve nr. 21, datë 13.3.2025 dhe nr. 27, datë 16.3.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, miratuar me vendimin nr. 16, datë 25.4.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.	16252



LIGJ
Nr. 58/2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 8378, DATË 22.7.1998,
“KODI RRUGOR I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 10 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Kudo në nen fjalët “shkronja “n”” zëvendësohen me fjalët “shkronja “l””.

2. Në fund të pikës 6 shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) që kanë të vendosura në to teknologji të reja ose shpikje, të cilat nuk plotësojnë një apo disa kushte të përmasave gabaritë ose peshave dhe kryejnë operacione lokale transporti për një periudhë prove.”.

Neni 2

Neni 61 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 61

Përmasat gabaritë kufitare

1. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, mjetet rrugore, duke përfshirë edhe ngarkesën e tyre, duhet të kenë përmasat

gabaritë, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Për të siguruar lëvizje të rregullt në kthesë të mjeteve dhe komplekseve të mjeteve, vendimi i Këshillit të Ministrave përcakton kushtet që duhet të plotësojnë mjetet dhe mënyrën e kontrollit.

3. Mjetet që për kërkesa të veçanta funksionale, vetëm ose së bashku me ngarkesën e tyre, i tejkalojnë përmasat gabaritë kufitare të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, mund të qarkullojnë vetëm si mjete jashtë norme ose si transporte në kushte jonormale.

4. Cilido që qarkullon me mjete ose komplekse mjetesh, duke përfshirë edhe ngarkesën, që tejkalojnë përmasat gabaritë kufitare të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, ndëshkohet me sanksione sipas nenit 10 të këtij ligji.”.

Neni 3

Neni 62 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 62

Ngarkesat kufitare

1. Pësja kufitare e përgjithshme me ngarkesë të plotë e një mjeti, që përbëhet nga pësja e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje dhe ajo e ngarkesës së tij, duke përjashtuar rastet e parashikuara në nenin 10 të këtij ligji, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Kushdo që qarkullon me një mjet, i cili me ngarkesën e tij i tejkalon kufijtë e peshave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, u nënshtrohet sanksioneve sipas neneve 10 e 165 të këtij ligji.”.

Neni 4

Në nenin 115/1, pas pikës 10 shtohet pika 10.1 me këtë përmbajtje:

“10.1 Drejtuesit të mjetit, i cili konstatohet duke drejtuar mjetin pa qenë i pajisur me leje drejtimi, përveç përgjegjësisë sipas legjislacionit penal në fuqi, i shtyhet për një periudhë prej 1 viti e drejta për t’u

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me:

- direktivën e Këshillit 96/53/BE, datë 25 korrik 1996, “Për përcaktimin për disa mjete, që qarkullojnë në Komunitet, të përmasave maksimale në trafikun kombëtar dhe

ndërkombëtar, dhe peshave maksimale të autorizuar në trafikun ndërkombëtar”, numri CELEX 01996L0053, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, numër 235, datë 17.9.1996, faqe 59.



pajisur me leje drejtimi pranë sistemit të autoshkollave si masë administrative ndëshkuese.

Kur drejtuesi i mjetit është i mitur, afati për t'u pajisur me leje drejtimi pranë sistemit të autoshkollave shtyhet për një periudhë 2-vjeçare nga momenti kur i lind kjo e drejtë sipas legjislacionit në fuqi.

Organet e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor kujdesen për evidentimin e kundërvajtësve dhe kryerjen e procedurave përkatëse të regjistrimit në sistem.”.

Neni 5

Në nenin 117/1, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Drejtuesit e mjeteve, të cilët janë pajisur me leje drejtimi të kategorisë ‘B’ brenda 24 (njëzet e katër) muajve të fundit, u nënshtrohen këtyre kufizimeve të posaçme:

a) kufiri i lejuar i alkoolit në gjak është 0.0‰;

b) shpejtësia maksimale e lejuar është 90 km/orë në autostrada dhe rrugë interurbane kryesore, si dhe 80 km/orë jashtë qendrave të banuara;

c) mosrespektimi i kufizimeve të përcaktuara në këtë pikë dënohet me gjobë administrative nga 5 000 (pesë mijë) lekë deri në 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, si dhe merret masa plotësuese e pezullimit të lejes së drejtimit për 1 muaj dhe heqja e pikëve sipas përcaktimeve të akteve nënligjore në fuqi;

ç) pas përfundimit të periudhës së provës prej 24 muajsh pa shkelje, kufizimet hiqen automatikisht. Për drejtuesit e mjeteve, të cilët gjatë një viti konstatohet se kanë kryer dy shkelje të normave të sjelljes ose të kufizimeve të përcaktuara në këtë pikë, si dhe u janë hequr të paktën 10 pikë, periudha e kufizimeve zgjatet edhe me 1 vit.”.

Neni 6

Në nenin 127, në pikën 3.1 hiqet fjalia “I njëjti rregull aplikohet edhe për lejet e drejtimit të lëshuara nga shteti shqiptar në rastin kur kundërvajtësi jep pëlqimin.”.

Neni 7

Në nenin 139 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 5, pas fjalës “shpejtësi” shtohen fjalët “duke sjellë rrezik serioz për përdoruesit e rrugës,

Faqe | 16218

sidomos në zonat urbane, përfshirë manovrat agresive, ndryshimet e shpeshta të korsisë pa sinjalizim dhe sjelljet josociale në rrugë.”.

2. Në pikën 7 hiqen fjalët “të barrës dhe të shalës”.

3. Në pikën 8, fjalët “nga dhjetë mijë deri në dyzet mijë lekë” zëvendësohen me fjalët “nga njëzet mijë deri në gjashtëdhjetë mijë lekë”.

Neni 8

Në nenin 165 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Mjetet me motor, rimorkiot dhe makinat teknologjike nuk mund të kalojnë peshën kufitare të përgjithshme të përcaktuar në aktin nënligjor dhe në lejeqarkullimin.”.

2. Në pikat 2 dhe 5, fjala “lejeqarkullimin” zëvendësohet me fjalët “aktin nënligjor dhe në lejeqarkullimin”.

3. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Për efekt të sanksioneve administrative të parashikuara nga ky nen, vlerat numerike të marra ndërmjet zbatimit të çfarëdo përqindjeje duhen konsideruar të rrumbullakuara me 100 kg më shumë.”.

4. Në pikën 10 fjalët “e peshës së përgjithshme me ngarkesë të plotë të treguar në lejeqarkullimin” zëvendësohen me fjalët “e peshës kufitare të përgjithshme të treguar në aktin nënligjor dhe në lejeqarkullimin”.

Neni 9

Në nenin 171 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet në “Përdorimi i aparateve telefonike dhe i pajisjeve digjitale të komunikimit, i syzeve optike dhe i pajisjeve të tjera gjatë drejtimit të mjetit”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1 dhe 2.2 me këtë përmbajtje:

“2.1 Ndalohet, gjithashtu, përdorimi i telefonit celular të mbajtur me dorë gjatë drejtimit të mjeteve të tjera, përfshirë biçikletat, motomjetet deri në 50 cc dhe monopatinat me motor.

2.2 Mbajtësi i lejedrejtimin të mjetit, të cilit gjatë lëshimit ose rinovimit të lejedrejtimin i është vendosur kushti për korrigjimin e të metave organike ose të aftësive të ulëta anatomike ose funksionale nëpërmjet syzeve optike ose aparateve



të tjera të caktuara, është i detyruar t'i përdorë ato gjatë drejtimit të mjetit.”.

3. Në pikën 4 fjalët “ tre herë brenda të njëjtë vit” zëvendësohen me fjalët “dy herë brenda të njëjtë vit”.

Neni 10

Në nenin 184, pas pikës 11 shtohet pika 11.1 me këtë përmbajtje:

“11.1 Kur nga verifikimet e parashikuara në pikat e këtij neni rezulton një vlerë alkoolike më e lartë se 0,5 gram për litër (g/l) në gjakun e drejtuesit të mjetit dhe ky drejtues është konstatuar e ndëshkuar më parë për drejtim mjeti nën ndikimin e alkoolit ose në gjendje të dehur, në rast përsëritjeje merret masa e heqjes së lejes së drejtimit përgjithmonë.”.

Neni 11

Akti nënligjor

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktin nënligjor në zbatim të neneve 61 dhe 62 të Kodit Rrugor.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.6.2026.

Shpallur me dekretin nr. 401, datë 17.7.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 401, datë 17.7.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 58/2026, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8378, datë

22.7.1998, ‘Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM

Nr. 7, datë 15.7.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE,
KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE
MËNYRAVE PËR DHËNIEN E
MIRATIMIT, PËR EKSPOZIMIN E
PASURIVE KULTURORE, MASAVE TË
NEVOJSHME PËR RUAJTJEN DHE
GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË
TYRE, SI DHE PROCEDURAVE,
MËNYRAVE DHE KUSHTEVE TË
LËSHIMIT TË DEKLARATËS SË
MARRJES PËRSIPËR TË RREZIKUT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 99, pikave 3 dhe 5, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

1. Ky udhëzim përcakton:

a) kushtet, kriteret, procedurat dhe mënyrat për dhënie e miratimit për huapërdorjen e pasurive kulturore të luajtshme për shfaqje në ekspozita, panairë dhe ngjarje kulturore;

b) masat e nevojshme për ruajtjen, mbrojtjen dhe garantimin e integritetit të pasurive kulturore gjatë transportit, ekspozimit dhe kthimit të tyre;

c) procedurat, mënyrat dhe kushtet për lëshimin e deklaratës së marrjes përsipër të rrezikut, sipas nenit 99, pika 5, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.



Neni 2 Fusha e zbatimit

Ky udhëzim zbatohet për pasuritë kulturore të luajtshme, të përcaktuara në nenin 99, pika 2, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, të cilat jepen në huapërdorim për qëllime shfaqjeje në ekspozita, panaire ose ngjarje kulturore, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3 Përkufizime

Për qëllimet e këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Huapërdorues” është personi fizik ose juridik, publik ose privat, që merr në përdorim të përkohshëm një pasuri kulturore për qëllime shfaqjeje në ekspozita, panaire ose ngjarje kulturore;
- b) “Integritet” është ruajtja e karakteristikave materiale, historike dhe estetike që përbëjnë vlerën e tij kulturore;
- c) “Institucion administrues” është institucioni publik ose privat që administron pasurinë kulturore objekt huapërdorimi;
- d) “Raport i gjendjes” është dokumenti teknik që pasqyron gjendjen fizike dhe konservuese të pasurisë kulturore përpara dorëzimit dhe pas kthimit të saj;
- e) “Projekt ekspozimi” është dokumentacioni teknik dhe kuratorial që përshkruan konceptin, qëllimin, organizimin, kushtet e ekspozimit dhe masat e sigurisë për pasurinë kulturore;
- f) “Deklaratë e marrjes përsipër të rrezikut” është deklarata e lëshuar nga institucioni shtetëror organizator i ekspozitës, panairit ose ngjarjes kulturore, me të cilën merret përsipër përgjegjësia për dëmtimin, humbjen, vjedhjen ose cenimin e integritetit të pasurisë kulturore, në përputhje me nenin 99, pika 5, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

KREU II KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURA PËR DHËNIEN E MIRATIMIT

Neni 4 Autoriteti kompetent

Leja për huapërdorjen e pasurive kulturore për shfaqje në ekspozita, panaire dhe ngjarje kulturore
Faqe | 16220

jepet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, pas shqyrtimit të kërkesës dhe verifikimit të përmbushjes së kushteve, kriterëve dhe kërkesave të përcaktuara në këtë udhëzim.

Neni 5 Kriteret e vlerësimit

Kërkesa për dhënie e lejes vlerësohet, në bazë të:

- a) rëndësisë kulturore, historike, artistike, shkencore ose dokumentare të pasurisë kulturore;
- b) gjendjes së konservimit dhe ndjeshmërisë së saj ndaj faktorëve të jashtëm;
- c) nivelit të rrezikut që lidhet me transportin, paketimin, vendosjen në ekspozim, ekspozimin, heqjen nga ekspozimi dhe kthimin e pasurisë kulturore;
- ç) ndikimit të mundshëm mbi integritetin të pasurisë kulturore;
- d) përputhshmërisë së projektit të ekspozimit me vlerat dhe karakteristikat e pasurisë kulturore;
- dh) kohëzgjatjes së ekspozimit;
- e) kapacitetit teknik dhe organizativ të huapërdoruesit;
- ë) përmbushjes së standardeve të ruajtjes dhe sigurisë.

Neni 6 Kushtet për dhënie e lejes

Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore jep leje për huapërdorje vetëm kur provohet, se:

- a) ambientet e ekspozimit sigurojnë kushte të përshtatshme ruajtjeje dhe monitorimi të pasurisë kulturore, përfshirë kushtet mikroklimatike, si: temperatura, lagështia relative dhe ndriçimi, në përputhje me natyrën dhe gjendjen e konservimit të pasurisë kulturore;
- b) janë garantuar kushtet e sigurisë fizike të ambienteve ku do të ekspozohet pasuria kulturore;
- c) ekzistojnë masa mbrojtëse kundër zjarrit, përmytjeve dhe rreziqeve të tjera që mund të cenojnë integritetin e pasurisë kulturore;
- ç) janë parashikuar masa të përshtatshme për transportin, paketimin, vendosjen në ekspozim, ekspozimin dhe heqjen nga ekspozimi të pasurisë kulturore;
- d) është siguruar garancia e lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë, sipas nenit 99, pika 4, të ligjit nr.



27/2018 ose deklarata e marrjes përsipër të rrezikut sipas nenit 99, pika 5, të këtij ligji.

Neni 7

Rastet e refuzimit të lejes

Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore refuzon dhënien e lejes, kur:

a) pasuria kulturore ndodhet në gjendje të tillë konservimi që transporti ose ekspozimi mund të cenojë integritetin e saj, ose, për shkak të karakteristikave të saj materiale, mund të dëmtohet lehtësisht nga transporti, ekspozimi ose nga ndryshimet e kushteve ambientale;

b) pasuria kulturore përbën pjesë të fondit thelbësor të një seksioni të rëndësishëm dhe organik të një muzeu, pinakoteke, galerie, arkivi ose biblioteke, apo të një koleksioni artistik ose bibliografik, dhe largimi i saj cenon integritetin, funksionin publik ose karakterin përfaqësues të fondit përkatës;

c) nuk plotësohen kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim;

ç) dokumentacioni i paraqitur rezulton i pasaktë ose i pavërtetë.

KREU III

PROCEDURA E PARAQITJES DHE E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS

Neni 8

Paraqitja e kërkesës

1. Subjekti i interesuar paraqet kërkesë për dhënien e lejes për huapërdorjen e pasurive kulturore për shfaqje në ekspozita, panairë ose ngjarje kulturore, jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë përpara datës së planifikuar të fillimit të veprimtarisë.

2. Kërkesa paraqitet nëpërmjet sistemit elektronik “e-Albania” dhe përmban:

a) të dhënat identifikuese të kërkuarit, si emër/emërtim tregtar, NUIS, adresa/selia;

b) lista e pasurive kulturore, për të cilat paraqitet kërkesa;

c) projektin e ekspozimit, ku përcaktohen qëllimi, vendi, kohëzgjatja dhe koncepti kuratorial;

ç) dokumentimin fotografik të secilës pasuri kulturore;

d) planin teknik të ekspozimit, që përfshin masat e ruajtjes, sigurisë dhe kushtet e ekspozimit;

dh) dokumentacionin që provon vlerën financiare të pasurisë kulturore, të lëshuar nga institucioni administrues ose nga ekspertë të kualifikuar sipas legjislacionit në fuqi, për qëllime të përlllogaritjes së vlerës së sigurimit ose të garancisë bankare;

e) projektkontratën ose projekt marrëveshjen ndërmjet kërkuarit dhe palës pritëse, që provon angazhimin e palëve për të shfaqur pasurinë kulturore në ekspozitën, panairin ose ngjarjen kulturore përkatëse;

ë) dokument që vërteton garancinë e lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë, në masën 1% të vlerës së deklaruar ose kërkesën për miratimin e zëvendësimit të garancisë me deklaratën e marrjes përsipër të rrezikut, sipas kreut V të këtij udhëzimi.

3. Në rastet kur subjekti i interesuar nuk është institucioni administrues i pasurisë kulturore objekt i kërkesës, struktura përgjegjëse e ministrit kërkon nga institucioni administrues i pasurisë kulturore dokumentacionin teknik dhe mendimin për huapërdorjen, duke përfshirë raportin e gjendjes së konservimit, dokumentacionin fotografik, si dhe vlerësimin mbi përshtatshmërinë e zhvendosjes, transportit dhe ekspozimit të pasurisë kulturore.

4. Institucioni administrues paraqet dokumentacionin dhe mendimin sipas pikës 3 të këtij neni, brenda 3 (tre) ditëve pune nga marrja e njoftimit, duke mbajtur përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e të dhënave teknike të paraqitura.

Neni 9

Shqyrtimi i kërkesës

1. Struktura përgjegjëse e ministrit verifikon dokumentacionin e paraqitur nga kërkuari.

2. Në rast se dokumentacioni është i paplotë, kërkuari njoftohet për plotësimin e mangësive brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh nga data e njoftimit.

3. Për vlerësimin e kërkesës, ministria kërkon mendim teknik nga institucioni përgjegjës, sipas tipologjisë së pasurisë kulturore, lidhur me gjendjen e konservimit të pasurisë kulturore dhe masat e nevojshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e saj.

4. Për verifikimin e statusit të pasurisë kulturore dhe të të dhënave të regjistrimit, kërkohet



konfirmim nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

5. Kur pasuria kulturore administrohet nga muze, galeri arti, bibliotekë, arkiv ose institucion tjetër administrues, ministria merr mendimin e institucionit administrues, lidhur me gjendjen e konservimit të pasurisë kulturore, përshtatshmërinë e zhvendosjes, transportit dhe ekspozimit të saj, si dhe masat e nevojshme për ruajtjen dhe garantimin e integritetit fizik, material dhe estetik të saj gjatë të gjithë procesit, nga marrja në dorëzim, paketimi, zhvendosja, transporti, ekspozimi dhe kthimi pranë institucionit administrues.

6. Kërkesa shqyrtohet brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga data e paraqitjes së dokumentacionit të plotë.

7. Vendimi për miratimin ose refuzimin e lejes jepet i arsyetuar dhe i njoftohet subjektit kërkuar.

8. Leja mund të shoqërohet me kushte, kufizime ose masa të posaçme për garantimin e ruajtjes dhe integritetit të pasurisë kulturore.

Neni 10

Vlefshmëria e lejes

1. Leja hyn në fuqi në datën e njoftimit të subjektit kërkuar, përveç rasteve kur në urdhrin e ministrit përcaktohet ndryshe.

2. Leja është e vlefshme vetëm për pasurinë kulturore, veprimtarinë, vendin dhe afatën e përcaktuar në të.

3. Subjekti i pajisur me leje është i detyruar të zbatojë kushtet, kufizimet dhe masat e përcaktuara në urdhrin përkatës dhe në këtë udhëzim.

4. Çdo ndryshim i elementeve mbi bazën e të cilëve është dhënë leja kërkon miratim paraprak nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

5. Mosrespektimi i kushteve të lejes përbën shkak për shfuqizimin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU IV

MASAT PËR RUAJTJEN DHE GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PASURIVE KULTURORE

Neni 11

Masat për ruajtjen e pasurisë kulturore

1. Huapërdoruesi merr të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen dhe garantimin e integritetit

të pasurisë kulturore gjatë transportit, ekspozimit dhe kthimit të saj.

2. Huapërdoruesi ka detyrimin për të garantuar që ambientet e ekspozimit kanë kushte të përshtatshme ruajtjeje dhe monitorimi të pasurisë kulturore, përfshirë kushtet mikroklimatike, si: temperatura, lagështia relative dhe ndriçimi, në përputhje me natyrën dhe gjendjen e konservimit të pasurisë kulturore.

3. Kushtet mikroklimatike monitorohen dhe dokumentohen gjatë të gjithë periudhës së ekspozimit dhe të dhënat përkatëse vihen në dispozicion të ministrisë ose institucioneve të specializuara të trashëgimisë kulturore, me kërkesën e tyre.

4. Materialet dhe pajisjet që përdoren për ekspozimin e pasurisë kulturore duhet të jenë të përshtatshme për ruajtjen e saj dhe të mos cenojnë integritetin fizik ose material të pasurisë kulturore.

Neni 12

Masat e sigurisë

1. Ambientet ku ekspozohet pasuria kulturore pajisen me sisteme sigurie dhe mbrojtjeje të përshtatshme për natyrën dhe vlerën e pasurisë kulturore që ekspozohet.

2. Ambientet e ekspozimit duhet të jenë të pajisura me sisteme mbrojtjeje kundër zjarrit, sisteme alarmi dhe sisteme monitorimi.

3. Kur natyra, vlera ose gjendja e konservimit të pasurisë kulturore e kërkon, ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore mund të vendosë masa shtesë sigurie.

4. Para marrjes në dorëzim të pasurisë kulturore, huapërdoruesi paraqet planin e masave për menaxhimin e rrezikut dhe të situatave emergjente, i cili përfshin procedurat e ndërhyrjes në rast zjarri, përmytjeje ose rreziqesh të tjera që mund të cenojnë integritetin e pasurisë kulturore.

Neni 13

Transporti dhe trajtimi i pasurisë kulturore

1. Transporti, paketimi, vendosja në ekspozim, ekspozimi dhe heqja nga ekspozimi i pasurisë kulturore kryhen në mënyrë të tillë që të mos cenojnë integritetin e pasurisë kulturore.



2. Pasuria kulturore transportohet në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga natyra, përmasat, materiali dhe gjendja e konservimit të saj.

3. Gjatë transportit dhe trajtimit të pasurisë kulturore merren masat e nevojshme për mbrojtjen e tyre nga dëmtimi, humbja, vjedhja ose çdo rrezik tjetër që mund të cenojë integritetin e tyre.

4. Huapërdoruesi siguron mbulimin me sigurim të pasurive kulturore objekt huapërdorimi gjatë të gjithë periudhës së huapërdorimit, nga momenti i marrjes në dorëzim deri në kthimin e tyre pranë institucionit administrues, përfshirë paketimin, transportin, qëndrimin në ambientet pritëse dhe ekspozimin, në përputhje me vlerën e deklaruar të tyre.

Neni 14

Monitorimi i gjendjes së pasurisë kulturore

1. Për çdo pasuri kulturore që është objekt huapërdorimi hartohet raporti i gjendjes përpara dorëzimit dhe pas kthimit të saj, nga institucioni përkatës administrues.

2. Dorëzimi, marrja në dorëzim dhe kthimi i pasurisë kulturore dokumentohen me procesverbal dhe pasqyrohen në raportin përfundimtar.

3. Çdo dorëzim, marrje në dorëzim ose zhvendosje e pasurisë kulturore jashtë institucionit administrues dokumentohet me procesverbal dhe raport gjendjeje. Kur kërkohet nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ose nga institucioni administrues, këto veprime kryhen në prani të përfaqësuesve të institucionit administrues, Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore ose institucioneve të tjera të specializuara të trashëgimisë kulturore.

4. Kur pasuria kulturore transportohet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dorëzimi dhe marrja në dorëzim pranë institucionit pritës dokumentohen sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e huapërdorimit dhe raportet përkatëse të gjendjes.

5. Gjatë periudhës së huapërdorimit ndalohej kryerja e ndërhyrjeve konservuese, restauruese ose e çdo ndërhyrjeje tjetër që mund të ndikojë në integritetin e pasurisë kulturore, pa miratimin paraprak me shkrim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe të institucionit administrues.

Neni 15

Detyrimi për njoftim

1. Çdo dëmtim, humbje, vjedhje ose rrethanë tjetër që mund të cenojë integritetin e pasurisë kulturore i njoftohet menjëherë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucionit administrues.

2. Njoftimi sipas pikës 1 të këtij neni bëhet jo më vonë se 2 (dy) orë nga momenti i konstatimit të ngjarjes.

Neni 16

Përgjegjësia e huapërdoruesit

1. Huapërdoruesi është përgjegjës për ruajtjen, sigurimin dhe garantimin e integritetit të pasurisë kulturore nga momenti i marrjes në dorëzim deri në kthimin e saj pranë institucionit administrues.

2. Në rast dëmtimi, humbjeje, vjedhjeje ose cenimi tjetër të integritetit të pasurisë kulturore, përgjegjësia dhe pasojat financiare përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dokumentacionin teknik përkatës.

KREU V

PROCEDURAT, MËNYRAT DHE KUSHTET PËR LËSHIMIN E DEKLARATËS SË MARRJES PËRSIPËR TË RREZIKUT

Neni 17

Fusha e zbatimit

1. Deklarata e marrjes përsipër të rrezikut lëshohet për ekspozitat, panairët ose ngjarjet kulturore që zhvillohen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe promovohen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ose organizohen me pjesëmarrjen e institucioneve shtetërore, në përputhje me nenin 99, pika 5, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

2. Deklarata e marrjes përsipër të rrezikut zëvendëson garancinë e lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë, të parashikuar në nenin 99, pika 4, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.



Neni 18

Paraqitja e kërkesës për zëvendësim

1. Institucioni shtetëror organizator që kërkon zëvendësimin e garancisë bankare me deklaratën e marrjes përsipër të rrezikut e paraqet këtë kërkesë njëkohësisht me kërkesën për dhënien e miratimit për huapërdorimin e pasurive kulturore, sipas nenit 8 të këtij udhëzimi.

2. Kërkesa për zëvendësimin e garancisë bankare përfshihet në dokumentacionin fillestar të paraqitur nëpërmjet sistemit elektronik “*e-Albania*” dhe nuk mund të paraqitet pas dorëzimit të kërkesës për miratim.

3. Në kërkesë identifikohen pasuritë kulturore, për të cilat kërkohet zëvendësimi i garancisë bankare, si dhe institucioni shtetëror që merr përsipër rrezikun.

Neni 19

Kushtet për miratimin e kërkesës

1. Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore miraton zëvendësimin e garancisë bankare me deklaratën e marrjes përsipër të rrezikut kur plotësohen njëkohësisht këto kushte:

a) veprimtaria zhvillohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

b) veprimtaria promovohet nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ose organizohet me pjesëmarrjen e institucioneve shtetërore;

c) institucioni shtetëror organizator disponon kapacitetet administrative, teknike dhe financiare të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga marrja përsipër e rrezikut;

ç) institucioni shtetëror organizator disponon plan të dokumentuar për menaxhimin e rrezikut dhe situatave emergjente që mund të cenojnë integritetin e pasurive kulturore objekt huapërdorimi.

2. Për qëllim të zbatimit të shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij neni, kapacitetet administrative, teknike dhe financiare të institucionit shtetëror organizator vlerësohen mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur prej tij, përfshirë aktet e organizimit institucional, planin e menaxhimit të rrezikut, masat e sigurisë, dokumentacionin buxhetor dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm që provon aftësinë për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga deklaratat e marrjes përsipër të rrezikut.

Neni 20

Shqyrtimi i kërkesës dhe lëshimi i deklaratës

1. Kërkesa për zëvendësimin e garancisë bankare shqyrtohet njëkohësisht me kërkesën për miratimin e huapërdorimit të pasurisë kulturore, sipas procedurës dhe afateve të përcaktuara në kreun III të këtij udhëzimi.

2. Struktura përgjegjëse e ministrisë verifikon dokumentacionin e paraqitur dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara në nenin 19 të këtij udhëzimi.

3. Kur dokumentacioni është i paplotë ose kërkon sqarime të mëtejshme, institucioni kërkues njoftohet elektronikisht, nëpërmjet sistemit “*e-Albania*”, për plotësimin e mangësive brenda afatit të përcaktuar në nenin 9 të këtij udhëzimi.

4. Vendimi për pranimin ose refuzimin e kërkesës për zëvendësimin e garancisë bankare jepet në të njëjtin akt administrativ me vendimin për miratimin ose refuzimin e huapërdorimit të pasurisë kulturore.

5. Në rast miratimi, deklarata e depozituar nga institucioni shtetëror organizator, sipas nenit 18 të këtij udhëzimi, konsiderohet e pranuar dhe bëhet pjesë e dosjes.

6. Deklarata depozitohet nëpërmjet sistemit elektronik “*e-Albania*” dhe nënshkruhet nga titullari i institucionit shtetëror organizator ose nga personi i autorizuar prej tij.

7. Pas verifikimit të përputhshmërisë së deklaratës me kushtet e miratuara, struktura përgjegjëse e ministrisë e administron atë në dosjen e procedurës dhe njofton institucionin administrues të pasurisë kulturore.

8. Institucioni administrues nuk mund të dorëzojë pasurinë kulturore për huapërdorim përpara administrimit në dosje të deklaratës së marrjes përsipër të rrezikut ose të garancisë bankare, sipas rastit.

9. Në rast refuzimi të kërkesës për zëvendësimin e garancisë bankare me deklaratën e marrjes përsipër të rrezikut, kërkuesi njoftohet brenda 3(tre) ditëve pune nga data e njoftimit të vendimit për paraqitjen e garancisë së lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë, sipas nenit 99, pika 4, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

10. Kërkuesi paraqet garancinë bankare jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga data e njoftimit.



11. Deri në paraqitjen e garancisë bankare, procedura për shqyrtimin e kërkesës për dhënien e lejes së huapërdorimit pezullohet.

12. Në rast se garancia bankare nuk paraqitet brenda afatit të përcaktuar në pikën 10 të këtij neni, kërkesa për dhënien e lejes së huapërdorimit refuzohet.

Neni 21

Përmbajtja e deklaratës

1. Deklarata e marrjes përsipër të rrezikut përmban të paktën:

a) emërtimin e institucionit shtetëror që merr përsipër rrezikun;

b) identifikimin e pasurive kulturore objekt të deklaratës;

c) vendin dhe kohëzgjatjen e ekspozitës, panairit ose ngjarjes kulturore;

ç) deklarimin e marrjes përsipër të përgjegjësisë për dëmtimin, humbjen, vjedhjen ose cenimin e integritetit të pasurive kulturore gjatë periudhës së huapërdorimit;

d) detyrimin për marrjen e masave të ruajtjes, sigurisë dhe monitorimit sipas këtij udhëzimi;

dh) datën e lëshimit dhe nënshkrimin e titullarit të institucionit shtetëror ose të personit të autorizuar prej tij;

e) vlerën e deklaruar të pasurisë kulturore objekt huapërdorimi;

ë) angazhimin e institucionit deklarues për përmbushjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga përgjegjësia e tij për dëmtimin, humbjen, vjedhjen ose cenimin tjetër të integritetit të pasurisë kulturore gjatë periudhës së huapërdorimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vlerësimin teknik të dëmit.

Neni 22

Vlefshmëria e deklaratës

1. Deklarata e marrjes përsipër të rrezikut është e vlefshme vetëm për pasuritë kulturore, veprimtarinë, vendin dhe afatin e përcaktuar në të.

2. Vlefshmëria e deklaratës fillon në datën e marrjes në dorëzim të pasurisë kulturore dhe përfundon me kthimin e saj pranë institucionit administrues dhe nënshkrimin e dokumentacionit përkatës të dorëzimit, sipas pikës 2, të nenit 14 të këtij udhëzimi.

3. Çdo ndryshim i elementeve mbi bazën e të cilave është lëshuar deklarata kërkon miratim paraprak nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

4. Në rast të mosrespektimit të kushteve të përcaktuara në këtë udhëzim ose në vendimin e miratimit, ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore mund të shfuqizojë miratimin, sipas legjislacionit në fuqi. Në këtë rast deklarata e marrjes përsipër të rrezikut humbet vlefshmërinë.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 23

Ngarkimi për zbatim

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi strukturat përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore dhe institucionet e tjera publike të përfshira sipas kompetencave të tyre.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT,
KULTURËS DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja

SHTOJCA NR. 1
MODEL I DEKLARATËS SË MARRJES
PËRSIPËR TË RREZIKUT

DEKLARATË E MARRJES PËRSIPËR TË
RREZIKUT

Në mbështetje të nenit 99, pika 5, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, si dhe të kreut V, të udhëzimit nr. _____, datë _____.2026, “Për përcaktimin e kushteve, kriterëve, procedurave dhe mënyrave për dhënien e miratimit për ekspozimin e pasurive kulturore, masave të nevojshme për ruajtjen dhe garantimin e integritetit të tyre, si dhe procedurave,



mënyrave dhe kushteve të lëshimit të deklarates së marrjes përsipër të rrezikut”,

INSTITUCIONI SHTETËROR

Emërtimi: _____

NUIS-i: _____

Adresa: _____

Përfaqësuar nga: _____

Funksioni: _____

DEKLARON SE:

1. Merr përsipër rrezikun dhe përgjegjësinë për dëmtimin, humbjen, vjedhjen ose çdo cenim tjetër të integritetit të pasurive kulturore të identifikuar në këtë deklaratë, gjatë periudhës së huapërdorimit të tyre.

2. Pasuritë kulturore objekt i kësaj deklarate do të ekspozohen, në kuadër të:

Emërtimi i ekspozitës/panairit/ngjarjes kulturore: _____

Vendi i zhvillimit: _____

Periudha e zhvillimit: nga _____._____._____ deri më _____._____._____.

3. Pasuritë kulturore, objekt i kësaj deklarate, janë:

Nr.	Emërtimi i pasurisë kulturore	Numri i regjistrimit	Institucioni administrues	Vlera e deklaruar (lekë)
1				
2				
3				

Vlera totale e deklaruar e pasurive kulturore: _____ lekë.

4. Disponon kapacitetet administrative, teknike dhe financiare të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo deklaratë.

5. Angazhohet për përmbushjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga përgjegjësia e tij për dëmtimin, humbjen, vjedhjen ose cenimin tjetër të integritetit të pasurive kulturore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vlerësimin teknik përkatës.

6. Janë marrë dhe do të zbatohen gjatë të gjithë periudhës së huapërdorimit masat e nevojshme për:

a) ruajtjen e pasurive kulturore;

b) sigurinë fizike të ambienteve të ekspozimit;

c) monitorimin e kushteve mikroklimatike;

ç) menaxhimin e rrezikut dhe situatave emergjente;

d) transportin, paketimin, vendosjen në ekspozim, ekspozimin, heqjen nga ekspozimi të pasurive kulturore.

7. Çdo dëmtim, humbje, vjedhje ose ngjarje tjetër që mund të cenojë integritetin e pasurive kulturore do t'i njoftohet menjëherë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucionit administrues, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Kjo deklaratë lëshohet për qëllime të zëvendësimit të garancisë së lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë, sipas nenit 99, pika 5, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

9. Kjo deklaratë është e vlefshme vetëm për pasuritë kulturore, veprimtarinë, vendin dhe afatin e përcaktuar në të, si dhe për periudhën nga marrja në dorëzim e pasurive kulturore deri në kthimin e tyre pranë institucionit administrues.

Deklaruesi

TITULLAR I INSTITUCIONIT
SHTETËROR

(emër, mbiemër, funksion, nënshkrim, vula e institucionit, data)

Shënim. Kjo deklaratë depozitohet pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në kuadër të procedurës së miratimit të huapërdorimit të pasurive kulturore dhe bëhet pjesë e dosjes administrative përkatëse.

NJOFTIM

Nr. 10917, datë 17.7.2026

PËR HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE NË KUADËR TË WIPO-s

1. “Traktati i Najrobit për mbrojtjen e simbolit olimpik”, bërë në Najrobi, më 26 shtator 1981, hyn në fuqi më 1 gusht 2026.

2. “Traktati i Singaporit mbi ligjin e Markatave Tregtare”, bërë në Singapor, më 27 mars 2006, hyn në fuqi më 1 tetor 2026.

3. “Traktati i Marrakeshit për lehtësimin e aksesit në veprat e botuara për personat e verbër, me vështirësi në shikim ose me aftësi të kufizuara në leximin e teksteve të shtypura”, bërë në Marrakesh, më 27 qershor 2013, hyn në fuqi më 1 tetor 2026.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME

Armand Skapi



VENDIM
Nr. 62, datë 1.6.2026

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 5.5.2026,
mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen
nr. 11 (J) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Një grup prej 38 deputetësh të
Kuvendit të Shqipërisë (jo më pak se një e katërta),
përfaqësuar me autorizim nga deputeti Gazment
Bardhi dhe avokati Marash Logu.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar
me autorizim nga Gazmend Bici.

OBJEKTI: Zgjidhja e mosmarrëveshjes së
kompetencës ndërmjet jo më pak se një të katërtës
së deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së
Shqipërisë, duke përcaktuar detyrimin e Kuvendit
për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit:

i. “Për verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve të
zyrtarëve shqiptarë në raport me ish-agjentin special
të FBI-së *Charles McGonigal*”;

ii. “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimtarisë
së organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit
vendor, si dhe për të verifikuar përdorimin e
burimeve të administratës shtetërore për qëllime
elektorale në zgjedhjet e 11 majit 2025”.

Deklarimi i vendimit nr. 77/2025 të Kuvendit të
Republikës së Shqipërisë “Për mosmiratimin e
projektvendimit ‘Për ngritjen e komisionit hetimor
për verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve të
zyrtarëve shqiptarë në raport me ish-agjentin special
të FBI-së *Charles McGonigal*’”, si i papajtueshëm me
Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Deklarimi i vendimit nr. 78/2025 të Kuvendit të
Republikës së Shqipërisë “Për mosmiratimin e
projektvendimit ‘Për ngritjen e komisionit hetimor
për kontrollin e ligjshmërisë së veprimtarisë së

organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor,
si dhe për të verifikuar përdorimin e burimeve të
administratës shtetërore për qëllime elektorale në
zgjedhjet e 11 majit 2025”, si i papajtueshëm me
Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 7, 77, 78 dhe 131, pika
1, shkronja “ç”, të Kushtetutës së Republikës së
Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 54, 55 dhe 56 të ligjit
nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe
funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar
(*Ligji Organik i Gjykatës*); ligji nr. 8891, datë 2.5.2002,
“Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve
hetimore të Kuvendit”, i ndryshuar; neni 25 i
Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë
(*Rregullorja e Kuvendit*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida
Xhaferllari, shqyrtoi pretendimet e kërkesës, një
grup prej 38 deputetësh të Kuvendit të Republikës
së Shqipërisë (*kërkesë*), i cili ka kërkuar pranimin e
kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar,
Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), i cili
ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi
çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 13.10.2025 kërkesi ka depozituar në
Kuvend dy kërkesa për ngritjen e dy komisioneve
hetimore parlamentare.

2. Komisioni hetimor i parë propozoi të kishte
për qëllim verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve të
zyrtarëve shqiptarë në raport me ish-agjentin special
të Byrosë Federale të Inteligjencës (*FBI*) të Shteteve
të Bashkuara të Amerikës (*SHBA*), të quajtur *Charles
McGonigal*. Ky i fundit është dënuar nga drejtësia
amerikane, por sipas të dhënave të kërkesës
marrëdhënia e paligjshme e tij me zyrtarët shqiptarë
është duke u hetuar edhe nga drejtësia shqiptare.
Objekti i këtij komisioni u propozua të ishte: i.
verifikimi i ligjshmërisë së të gjitha veprimeve të
zyrtarëve shqiptarë me ish-agjentin; ii. vlerësimi i
nevojës për marrjen e masave, përfshirë ndërhyrjet
ligjore, për garantimin e parimeve të ligjshmërisë,
integritetit, korrektësisë dhe ndershmërisë në



raportet e zyrtarëve shqiptarë me zyrtarët e huaj, pavarësisht nëse ata veprojnë ose jo në cilësitë e tyre zyrtare. Në kërkesën për ngritjen e komisionit parashtrohej e drejta e atij komisioni për të hetuar dhe bërë transparencë për çështjen në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht me parimin e ndarjes së pushteteve, duke mos iu mbivendosur punës së organeve të drejtësisë, me të drejtën për proces të rregullt ligjor, me parimin e prezumimit të pafajësisë, me parimin e paanshmërisë dhe respektimin e jetës private të individit.

3. Komisioni hetimor i dytë propozohej të kishte për qëllim kontrollin e ligjshmërisë së veprimtarisë të organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, si dhe verifikimin e përdorimit të burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 11 majit 2025, sipas gjetjeve të raportit të OSBE-ODIHR-it. Objekti i këtij komisioni do të ishte: i. verifikimi i ligjshmërisë së veprimtarisë të organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, si dhe i përdorimit të burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 11 majit 2025; ii. vlerësimi i nevojës për marrjen e masave, përfshirë ndërhyrjet ligjore për garantimin e parimeve të ligjshmërisë, integritetit, barazisë, lirisë dhe ndershmërisë në proceset zgjedhore të ardhshme. Edhe në këtë rast në kërkesë evidentohej se komisioni do të kishte të drejtë të hetonte dhe të bënte transparencë për çështjen, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, duke mos iu mbivendosur punës së organeve ligjzbatuese.

4. Kryetari i Kuvendit në datën 15.10.2025 ka thirrur mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve në datën 17.10.2025, duke përfshirë në rendin e ditës edhe shqyrtimin e dy kërkesave të paraqitura nga kërkuesi. Mbledhja është zhvilluar sipas planifikimit, ku deputetët kanë debatuar për formulimin dhe gjuhën e përdorur në kërkesat e paraqitura, pa shfaqur mendim për thelbin e tyre. Kështu, sipas përfaqësuesit të shumicës, objekti i kërkesës për komisionin e parë duhej rishikuar dhe parimi i prezumimit të pafajësisë duhej të integrohej në parashtrim; duhej të rregullohej çështja që lidhej me të provuarin qartazi të përfshirjes së Kryeministrit në veprimtari të dyshimta në kontekstin e dyshimit të arsyeshëm; duhej të hiqeshin nga përmbajtja faktet që lidheshin me ndërhyrjen në hetimet penale në SHBA (ndaj lobistit të Partisë Demokratike) dhe fakti i fillimit të një procedimi penal nga Prokuroria

e Tiranës; duhej të qartësoheshin pretendimet mbi takimet dhe ndikimet e kryetarit të Bashkisë së Tiranës; duhej të bëheshin rregullime gjuhësore; duhej të saktësoheshin dhe konkretizoheshin faktet lidhur me shitjen dhe vlerën e votës në diasporë; duhej të riformuloheshin faktet sipas ligjit. Ndërsa përfaqësuesi i pakicës (kërkuesi) ka pranuar të korrigjojë pasaktësitë teknike në shkrimin e kërkesave. Në përfundim të mbledhjes, Konferenca e Kryetarëve ka rënë dakord që të dyja kërkesat për ngritjen e dy komisioneve hetimore të shqyrtoheshin në seancën plenare të Kuvendit të datës 30.10.2025.

5. Tri ditë më vonë, më 20.10.2025, grupi i deputetëve të pakicës ka riparaqitur kërkesat për ngritjen e dy komisioneve, duke parashtruar se kishte reflektuar diskutimet në Konferencën e Kryetarëve dhe kishte përmirësuar formulimin e tyre. Në lidhje me kërkesën për Komisionin Hetimor McGonigal, kërkuesi kishte zëvendësuar formulimet kategorike me shprehje që evidentonin ekzistencën e indicieve ose të dyshimeve të arsyeshme, kishte zëvendësuar disa referenca faktike të konsideruara të panevojshme dhe kishte shtuar shprehimisht se hetimi parlamentar do të zhvillohej në respekt të parimeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor dhe të prezumimit të pafajësisë (*shih faqet 3–7 të kërkesës së datës 20.10.2025*). E njëjta qasje u ndoq edhe në kërkesën për ngritjen e Komisionit Hetimor për Zgjedhjet e 11 majit 2025. Edhe në këtë rast formulimet që paraqisnin si të provuara shkeljet e pretenduara u zëvendësuan me shprehje që u referoheshin indicieve, fakteve ose grupeve të fakteve që justifikonin zhvillimin e një hetimi parlamentar, ndërsa u hoqën disa pohime me karakter kategorik, përfshirë referencën për shitblerjen e votave të diasporës në Itali dhe Greqi (*shih faqet 1–6 të kërkesës së datës 20.10.2025*).

6. Në vijim, me urdhrin e datës 28.10.2025, Kryetari i Kuvendit ka thirrur seancën plenare të datës 30.10.2025 për shqyrtimin e kërkesave për ngritjen e dy komisioneve hetimore. Nga përmbajtja e debateve parlamentare rezulton se për komisionin e parë (çështja McGonigal), diskutimet u përqendruan në pretendimin se objekti i propozuar tejkalonte kufijtë kushtetues të hetimit parlamentar. Konkretisht, u argumentua se, nga njëra anë, ai lidhej me fakte që kishin qenë objekt i një procesi penal të zhvilluar në një juridiksion të huaj (SHBA), për të cilat Kuvendi nuk kishte juridiksion, dhe, nga ana



tjetër, mungonin akte ose procedura të zhvilluara nga organet publike shqiptare që përmbanin indicie ose të dhëna konkrete për të justifikuar ushtrimin e funksionit hetimor parlamentar.

7. Për sa i takon komisionit të dytë (zgjedhjet e 11 majit 2025), debatet u përqendruan, gjithashtu, në mospërputhjen e objektit të propozuar me standardet kushtetuese. Në këtë drejtim u argumentua, se: i. objekti ishte formuluar në mënyrë të përgjithshme, pa identifikuar akte administrative individuale, vendime ose procedura konkrete që të tregonin ekzistencën e indicieve dhe të dhënave mbi të cilat do të mbështetej hetimi parlamentar; ii. ai mbivendosej me objektin e veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore (*Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore*), të ngritur më 27.10.2025; iii. problematikat e evidentuara në procesin zgjedhor mund të trajtoheshin përmes mekanizmave të posaçëm ligjorë dhe gjyqësorë, si dhe në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të raportit të OSBE/ODIHR-it, ndaj komisioni hetimor nuk mund të shërbente si forum paralel për vlerësimin e tyre.

8. Në përfundim të debateve, Kuvendi, me vendimet nr. 77/2025 “Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e komisionit hetimor për verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve të zyrtarëve shqiptarë në raport me ish-agjentin special të FBI-së *Charles McGonigal*” (vendimi nr. 77/2025) dhe nr. 78/2025 “Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e komisionit hetimor për kontrollin e ligjshmërisë së veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, si dhe për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 11 majit 2025” (vendimi nr. 78/2025), vendosi të mos miratojë ngritjen e dy komisioneve hetimore të propozuara.

9. Në datën 12.11.2025 kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës midis tij dhe Kuvendit, si dhe deklarimin si të papajftueshme me Kushtetutën të dy vendimeve të Kuvendit për mosmiratimin e ngritjes së dy komisioneve hetimore. Gjithashtu, ai ka kërkuar edhe përshejtimin e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata, me argumentin e interesit publik.

10. Kolegji i Gjykatës në datën 21.1.2026 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë

plenare publike. Ndërsa Mbledhja e Gjyqtarëve në datën 26.1.2026 ka vendosur pranimin e kërimit për përshejtimin e shqyrtimit të çështjes, duke e nxjerrë çështjen për shqyrtim nga kalendari i zakonshëm.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se pakicës parlamentare i është mohuar e drejta kushtetuese për ngritjen e dy komisioneve hetimore, e garantuar nga neni 77, pika 2, i Kushtetutës, pasi:

11.1. Kuvendi ishte i detyruar të miratonte ngritjen e komisioneve hetimore, sepse kërkesat ishin paraqitur nga një e katërta e deputetëve, ndaj kompetenca kushtetuese e pakicës parlamentare nuk mund të kufizohej nga vullneti politik i shumicës. Kërkesat plotësonin kriteret e nenit 77 të Kushtetutës dhe standardet e zhvilluara në jurisprudencën kushtetuese lidhur me veçantinë e çështjes, përcaktimin e objektit dhe respektimin e parimeve kushtetuese. Në secilën kërkesë ishte përcaktuar qartë objekti i hetimit, lidhja e tij me funksionet kushtetuese të Kuvendit, çështja konkrete që do t'i nënshtrohej hetimit, si dhe ishte garantuar respektimi i parimeve kushtetuese. Kuvendi nuk mund të refuzojë ngritjen e komisionit vetëm me votën e shumicës, pa ofruar një formulim alternativ të objektit dhe për arsye të pabazuara. Duke refuzuar ngritjen e komisioneve hetimore, Kuvendi ka cenuar edhe forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës, e cila ka pohuar se e drejta kushtetuese e një të katërtës së deputetëve për të kërkuar ngritjen e komisioneve hetimore nuk mund të kushtëzohet nga vullneti i shumicës parlamentare.

11.2. Kërkesat mbështeteshin në indicie të mjaftueshme, konkretisht në akte të autoriteteve të drejtësisë amerikane, në vendime të gjykatave shqiptare dhe në raportin e vëzhguesve ndërkombëtarë. Argumenti sipas të cilit Kuvendi nuk kishte juridiksion për të hetuar fakte të trajtuara në një proces penal të zhvilluar në SHBA është i pabazuar, pasi në atë proces nuk është gjykuar asnjë zyrtar shqiptar dhe kërkesa nuk synonte hetimin e shtetasve të huaj, por verifikimin e përgjegjësive të mundshme të autoriteteve publike shqiptare. Argumenti se objekti i Komisionit Hetimor për Zgjedhjet e 11 majit 2025 mbivendosej me atë të



Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore është i pabazuar, sepse praktika parlamentare e vitit 2021 njih raste të ngritjes së komisioneve me objekte të ngjashme.

12. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se kërkesa është e pabazuar, pasi:

12.1. E drejta kushtetuese e një të katërtës së deputetëve për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor nuk është e pakufizuar. Ajo kushtëzohet nga kriteret dhe standardet kushtetuese. Nuk ekziston asnjë konflikt kompetencash ndërmjet pakicës parlamentare dhe Kuvendit, por një ushtrim paralel i kompetencave kushtetuese përkatëse. Mosmiratimi i projektvendimeve nuk ka penguar ushtrimin e kompetencës së pakicës parlamentare, pasi kërkuesi ka ushtruar plotësisht të drejtën e tij për të paraqitur kërkesat dhe për t'i mbrojtur ato në seancë plenare, pa iu mohuar e drejta e shqyrtimit ose e debatit parlamentar. Për rrjedhojë, Kuvendi ka vepruar brenda kompetencës së tij kushtetuese për të verifikuar përputhshmërinë e kërkesave me nenin 77 të Kushtetutës dhe për të parandaluar përdorimin e komisioneve hetimore jashtë funksionit të tyre kushtetues.

12.2. Kërkesat për ngritjen e dy komisioneve hetimore nuk përmbushin kriteret dhe standardet kushtetuese, veçanërisht për sa i përket ekzistencës së indicieve konkrete dhe përcaktimit të qartë të objektit të hetimit. Objekti i propozuar i komisionit hetimor McGonigal lidhet me fakte që janë trajtuar në një proces penal të zhvilluar në një juridiksion të huaj, ndërkohë që në Shqipëri nuk ekziston një procedim penal për të njëjtat rrethana. Për rrjedhojë, ngritja e komisionit do të mbivendoste hetimin parlamentar me kompetencat e pushtetit gjyqësor dhe përdorimin e tij për qëllime politike. Edhe kërkesa për ngritjen e Komisionit Hetimor për Zgjedhjet e 11 majit 2025 nuk ka objekt të qartë. Raportet e vëzhguesve ndërkombëtarë nuk identifikojnë akte administrative individuale ose procedura konkrete që mund të përbëjnë objekt të hetimit parlamentar, por përmbajnë vlerësime dhe rekomandime me karakter të përgjithshëm. Shumica parlamentare nuk ka detyrimin të riformulojë objektin e kërkesave, pasi një ndërhyrje e tillë do të zhvendoste përgjegjësinë kushtetuese për përcaktimin e objektit nga pakica parlamentare te shumica dhe do të cenonte vetë natyrën e së drejtës së garantuar nga neni 77 i Kushtetutës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesës

13. Neni 131, pika 1, shkronja “ç”, i Kushtetutës, i detajuar në nenet 54-56 të Ligjit Organik të Gjykatës, parashikon se Gjykata vendos për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, të cilat duhet të kenë natyrë kushtetuese dhe të lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e veprimtarisë së organeve brenda secilit pushtet.

14. Në jurisprudencën e saj të konsoliduar, Gjykata ka pohuar se kjo dispozitë përfshin rastet e konflikteve me natyrë kushtetuese që lindin ndërmjet organeve ose subjekteve të parashikuara nga Kushtetuta, kur kontestohet ushtrimi i një kompetence të parashikuar prej saj (*shih vendimin nr. 20, datë 4.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata ka pranuar se pengimi i ushtrimit të kompetencës që neni 77, pika 2, i Kushtetutës i njeh një të katërtës së deputetëve për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar përbën konflikt kushtetues kompetencash. Për rrjedhojë, mosmiratimi nga Kuvendi i një kërkesë të tillë mund të krijojë një mosmarrëveshje kushtetuese ndërmjet pakicës parlamentare (jo më pak se një e katërta e deputetëve) dhe Kuvendit për ushtrimin e së njëjtës kompetencë kushtetuese (*shih vendimet nr. 57, datë 23.7.2015; nr. 30, datë 16.5.2014; nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin në shqyrtim, ankimi kushtetues është paraqitur nga i njëjti grup prej 38 deputetësh që kanë nënshkruar edhe dy kërkesat për ngritjen e dy komisioneve hetimore parlamentare. Kërkuesi pretendon se Kuvendi me vendimet nr. 77/2025 dhe nr. 78/2025, duke rrëzuar këto kërkesa, i ka mohuar të drejtën kushtetuese që neni 77, pika 2, i Kushtetutës i njeh një të katërtës së deputetëve për të kërkuar ngritjen e komisioneve hetimore, duke shkaktuar kështu lindjen e një mosmarrëveshjeje kushtetuese të kompetencës.

16. Gjykata çmon se grupi prej 38 deputetësh përmbush kërkesën e nenit 77, pika 2, të Kushtetutës lidhur me numrin e deputetëve (jo më pak se një e katërta) që legjitimohet për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Përderisa pretendon se është cenuar drejtpërdrejt në ushtrimin e një kompetence kushtetuese nga vendimet e Kuvendit, legjitimohet *ratione personae*, në cilësinë e subjektit në konflikt. Po kështu, kërkesa është paraqitur brenda



afatit 6-mujor të parashikuar nga neni 55 i Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimet e kundërshtuara janë marrë më 30.10.2025, ndërsa kërkesa është depozituar më 12.11.2025, ndaj kërkuasi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

17. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se ndërmjet pakicës parlamentare (jo më pak se një e katërta e deputetëve) dhe Kuvendit ka lindur një mosmarrëveshje kushtetuese për ushtrimin e së drejtës që neni 77, pika 2, i Kushtetutës i njeh pakicës parlamentare për të kërkuar ngritjen e komisioneve hetimore. Për rrjedhojë, duke qenë se pretendimet lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e një të drejte të parashikuar nga Kushtetuta, Gjykata çmon se kërkuasi legjitimohet edhe *ratione materiae*.

B. Për themelin e kërkesës

18. Kërkuasi, në themel të ankimit kushtetues, ka pretenduar se Kuvendi, duke mos miratuar kërkesat për ngritjen e dy komisioneve hetimore parlamentare, i ka mohuar të drejtën që i garantohet pakicës parlamentare nga nenet 7 dhe 77 të Kushtetutës për të kërkuar ngritjen e komisioneve hetimore. Sipas tij, të dyja kërkesat përmbushin kriteret e përcaktuara në Kushtetutë dhe standardet e zhvilluara në jurisprudencën kushtetuese, ndaj refuzimi i tyre ka cenuar këtë të drejtë kushtetuese (*shih paragrafin 11.1. të vendimit*).

19. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se kërkesat për ngritjen e dy komisioneve hetimore nuk përmbushin kriteret kushtetuese, veçanërisht për sa i përket përcaktimit të qartë të objektit të hetimit dhe ekzistencës së indicieve konkrete që justifikojnë ushtrimin e hetimit parlamentar. Për rrjedhojë, sipas tij, mosmiratimi i tyre nuk përbën pengim të ushtrimit të së drejtës kushtetuese të pakicës parlamentare (*shih paragrafin 12.2. të vendimit*).

20. Gjykata vëren se fjalë e parë e pikës 2 të nenit 77 të Kushtetutës parashikon se: “Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesë të një së katërtës të të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë.”.

21. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se në kuptim të kësaj norme, Kuvendi vihet në dy pozicione të ndryshme: nga njëra anë, krijimi i komisionit hetimor paraqitet si një e drejtë e tij, që realizohet sipas procedurave të parashikuara në Kushtetutë dhe në Rregullore; nga ana tjetër, Kuvendi vendoset në një pozicion disi të veçantë, pa pasur të drejtën për të vlerësuar vendimmarrjen për

ngritjen e komisionit hetimor. Në rastin e fundit norma kushtetuese njëkohësisht institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushtet i pakicës parlamentare. Kushtetuta, duke njohur të drejtën e një të katërtës së deputetëve për të kërkuar ngritjen e komisioneve hetimore, si e drejtë për të vepruar në mënyrë të pavarur nga shumica parlamentare, nëpërmjet shprehjes “është i detyruar” ka evituar kalimin e çështjes në procedurat e zakonshme të votimit, duke vendosur një balancë ndërmjet së drejtës së shumicës për të vendosur dhe asaj të pakicës së cilësuar për të kërkuar një komision të tillë (*shih vendimet nr. 57, datë 23.7.2015; nr. 30, datë 16.5.2014; nr. 20, datë 4.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata ka pohuar se e drejta e pakicës parlamentare për të kërkuar ngritjen e komisioneve hetimore nuk mund të kufizohet nga vullneti i shumicës parlamentare, përveç rasteve kur, për shkak të objektit ose qëllimit të hetimit, cenohen parimet kushtetuese, veçanërisht ato që lidhen me ndarjen dhe balancimin e pushteteve, të drejtën për proces të rregullt ligjor, prezumimin e pafajësisë, paanshmërinë dhe respektimin e jetës private të individit (*shih vendimet nr. 22, datë 5.5.2010; nr. 20, datë 4.5.2007; nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata ka theksuar se hetimi parlamentar duhet, së pari, të ketë për qëllim sigurimin e informacionit të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve kushtetuese të Kuvendit dhe, së dyti, të përqendrohet në një çështje të veçantë (*shih vendimin nr. 20, datë 4.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në lidhje me qëllimin e ngritjes së komisioneve hetimore, Gjykata ka pohuar se ai ka të bëjë me njohjen dhe verifikimin e një fenomeni, një ngjarjeje ose një veprimtarie, me synimin për të nxjerrë përfundime mbi nevojën e miratimit, plotësimit ose korigjimit të ligjeve të veçanta, si dhe për të nxjerrë përgjegjësinë për mënyrën e qeverisjes (*shih vendimet nr. 57, datë 23.7.2015; nr. 30, datë 16.5.2014; nr. 22, datë 5.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Natyra e hetimit parlamentar nuk mund të barazohet me hetimin që realizojnë organet e tjera të pavarura ose të specializuara. Në këtë kuptim, ky instrument i rëndësishëm nuk mund të përdoret në mënyrë abuzive dhe tej hapësirës kontrolluese që Kushtetuta i njeh Kuvendit (*shih vendimet nr. 30, datë 16.5.2014; nr. 22, datë 5.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Ndërsa në lidhje me “çështjen e veçantë”, Gjykata ka pohuar se ajo nënkupton të gjitha ato



çështje që përfshihen brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe që përmbajnë në vetvete një interes publik, në kuptimin e rëndësisë së veçantë shtetërore/publike. Edhe pse lista e çështjeve me interes publik nuk mund të jetë shteruese, pasi interesi publik kuptohet në varësi të situatave të ndryshme që krijohen, Gjykata ka vlerësuar se çështjet e verifikimit të zbatueshmërisë së legjislacionit, të formulimit të propozimeve ose iniciativave ligjore, që kanë për qëllim frenimin dhe parandalimin e fenomeneve negative për shoqërinë e shtetit, janë të përfshira në konceptin kushtetues “*çështje e veçantë*” (shih vendimet nr. 42, datë 27.12.2022, nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese).

25. Përcaktimi i ekzistencës së një çështjeje që kërkon verifikim dhe vlerësim, si parakusht për ngritjen e një komisioni, duhet të kryhet në një mënyrë objektive. Për këtë qëllim, objekti i hetimit duhet të përmbajë fakte të përcaktueshme ose grup faktesh, të cilat të tregojnë se çfarë synohet të hetohet, pasi në këtë mënyrë ai evidenton edhe çështjen e veçantë. Identifikimi i subjekteve dhe objektit të veprimtarisë hetimore të komisionit është një kërkesë *sine qua non* për të përcaktuar saktësisht çështjet që duhet të adresojë komisioni ose për të vlerësuar nëse duhet të ndërmerret apo jo një hetim për këtë çështje. “*Çështja e veçantë*”, në kuptim të nenit 77 të Kushtetutës, përbëhet nga një sërë rrethanash, të cilat përcaktojnë objektin e interesit të Kuvendit dhe që duhet të specifikohen në vendimin e Kuvendit për ngritjen e një komisioni hetimor (shih vendimet nr. 12, datë 20.5.2008; nr. 20, datë 4.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese).

26. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se gjatë procedurës parlamentare palët kanë mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me objektin dhe qëllimin e dy komisioneve hetimore, ndërsa në përfundim të seancës plenare të datës 30.10.2025 kërkesat për ngritjen e tyre nuk u miratuan. Prandaj, në vijim, Gjykata do të vlerësojë nëse refuzimi i ngritjes së këtyre komisioneve është bërë në përputhje me kriteret dhe standardet kushtetuese që rregullojnë ushtrimin e së drejtës së pakicës parlamentare sipas nenit 77, pika 2, të Kushtetutës, duke shqyrtuar nëse arsyet e paraqitura nga shumica parlamentare përbënin pengesa me natyrë kushtetuese. Për këtë qëllim, Gjykata do të analizojë veçmas secilën kërkesë për ngritjen e komisioneve hetimore dhe arsyet e refuzimit të tyre.

27. Paraprakisht, Gjykata evidenton se vendimet e Kuvendit nr. 77/2025 dhe nr. 78/2025, me të cilat u refuzua ngritja e dy komisioneve hetimore parlamentare, nuk përmbajnë ndonjë arsyetim mbi bazën e të cilit është marrë vendimarrja. Po kështu, Gjykata konstaton se as Rregullorja e Kuvendit nuk parashikon detyrimin që vendime të tilla të shoqërohen me një relacion ose akt tjetër shpjegues. Megjithatë, mungesa e një detyrimi formal të Kuvendit për arsyetimin e vendimit nuk përjashton nevojën që shkaqet kushtetuese të refuzimit të jenë të identifikueshme dhe t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues. Për rrjedhojë, për të identifikuar arsyet që kanë çuar në refuzimin e kërkesave dhe për të vlerësuar bazueshmërinë e pretendimeve të palëve, Gjykata do t'i referohet dokumentacionit parlamentar që pasqyron debatin e zhvilluar gjatë procedurës së shqyrtimit të tyre, konkretisht procesverbalit të mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve të datës 17.10.2025 dhe procesverbalit të seancës plenare të datës 30.10.2025. Nga përmbajtja e tyre rezulton se, nën drejtësinë e Kryetarit të Kuvendit, në ushtrim të kompetencës së tij kushtetuese, debati është zhvilluar ndërmjet deputetëve që mbështesnin dhe atyre që kundërshtonin ngritjen e komisioneve hetimore, ku secili qëndrim është paraqitur në seancë plenare nga një deputet përfaqësues i grupit përkatës.

B.1 Për kërkesën për ngritjen e Komisionit Hetimor McGonigal

28. Gjykata vëren se në kërkesën e depozituar në Kuvend në datën 13.10.2025, kërkuesi ka parashtruar se në datën 15.9.2022 Zyra e Prokurorit pranë Gjykatës së Distriktit të Kolumbias ka depozituar aktakuzën në çështjen *SHBA kundër McGonigal*, në të cilën ish-agjenti special i FBI-së akuzohej për fshehje të të ardhurave, deklarime të rreme dhe falsifikim dokumentesh. Sipas kërkuarit, në këtë aktakuzë përmenden edhe marrëdhënie dhe veprime që përfshijnë zyrtarë shqiptarë, përfshirë Kryeministrin e vendit dhe dy shtetas të tjerë të lidhur me të. Ai ka pretenduar se këto fakte, të mbështetura edhe në dokumente zyrtare të publikuara nga autoritetet amerikane, në raportime të burimeve serioze mediatike dhe në vendime gjyqësore shqiptare për anulimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure, krijojnë dyshime të arsyeshme për ligjëshmërinë e veprimeve të disa zyrtarëve shqiptarë në marrëdhëniet e tyre me ish-agjentin.



29. Nisur nga këto rrethana, kërkuesi ka kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve të zyrtarëve shqiptarë në lidhje me ish-agjentin e FBI-së, evidentimin e përgjegjësive institucionale dhe vlerësimin e nevojës për marrjen e masave, përfshirë ndërhyrjet ligjore, me qëllim parandalimin e përsëritjes së fenomeneve të ngjashme. Sipas tij, komisioni do të ushtronte veprimtarinë e tij në funksion të garantimit të transparencës, duke respektuar parimet kushtetuese (*shih paragrafin 2 të vendimit*).

30. Në mbështetje të kërkesës, kërkuesi ka argumentuar se objekti dhe qëllimi i komisionit janë në përputhje me Kushtetutën, pasi ai nuk synon të ushtrojë kompetenca që u përkasin organeve të drejtësisë ose të përcaktojë përgjegjësi penale individuale, por të ushtrojë kontroll parlamentar mbi veprimtarinë e autoriteteve publike, të evidentojë përgjegjësi me karakter institucional dhe të vlerësojë nevojën për përmirësime të kuadrit ligjor. Sipas tij, kërkesa lidhet drejtpërdrejt me funksionet kushtetuese të Kuvendit, kishte objekt të përcaktuar qartë dhe mbështetej në indicie të mjaftueshme që justifikonin zhvillimin e hetimit parlamentar.

31. Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se Kuvendi e ka rrëzuar kërkesën pa identifikuar ndonjë mangësi kushtetuese të objektit të hetimit dhe pa propozuar një formulim alternativ të tij, në kundërshtim me jurisprudencën kushtetuese. Sipas tij, argumenti se Kuvendi nuk kishte juridiksion për të hetuar fakte të trajtuara në një proces penal të zhvilluar në SHBA ishte i pabazuar, pasi ai proces nuk kishte pasur si objekt përgjegjësinë e zyrtarëve shqiptarë, ndërsa komisioni i propozuar synonte vetëm verifikimin e përgjegjësive të mundshme të autoriteteve publike shqiptare në kuadër të ushtrimit të funksionit të kontrollit parlamentar.

32. Nga përmbajtja e debateve parlamentare të zhvilluara në seancën plenare të datës 30.10.2025 rezulton se, për kërkesën për ngritjen e komisionit hetimor për çështjen McGonigal, shumica parlamentare vlerësoi se objekti i propozuar nuk përmbushte kriteret kushtetuese për ushtrimin e hetimit parlamentar. Sipas saj, ai lidhet me fakte të trajtuara në një proces penal të zhvilluar në SHBA, për të cilat Kuvendi nuk kishte juridiksion, ndërsa

mungonin akte ose procedura të zhvilluara nga autoritetet publike shqiptare që të përmbanin indicie ose të dhëna konkrete të mjaftueshme për të justifikuar ushtrimin e funksionit hetimor parlamentar.

33. Në prapësimet e paraqitura para Gjykatës, Kuvendi ka mbajtur të njëjtin qëndrim, duke shtuar se mosmiratimi i projektvendimit nuk cenonte të drejtën kushtetuese të pakicës parlamentare, pasi kërkuesit i ishte garantuar mundësia të paraqiste kërkesën dhe ta mbronte atë në seancë plenare. Sipas Kuvendit, objekti i propozuar nuk ishte i përcaktuar në përputhje me kërkesat kushtetuese, pasi synonte hetimin e fakteve të trajtuara në një proces penal të zhvilluar në një juridiksion të huaj, ndërkohë që në Shqipëri nuk ekzistonte një procedim penal për të njëjtat rrethana. Për rrjedhojë, ngritja e komisionit do të krijonte rrezikun e mbivendosjes së hetimit parlamentar me kompetencat e pushtetit gjyqësor dhe të përdorimit të tij për qëllime politike. Po kështu, Kuvendi ka theksuar se shumica parlamentare nuk kishte detyrimin të riformulonte objektin e kërkesës, pasi një ndërhyrje e tillë do të zhvendoste përgjegjësinë kushtetuese për përcaktimin e objektit të hetimit nga pakica parlamentare te shumica, në kundërshtim me nenin 77 të Kushtetutës.

34. Për sa më sipër, Gjykata, në përfundim të diskutimeve, lidhur me kërkimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave të krijuar nga vendimi nr. 77/2025 i Kuvendit dhe për shfuqizimin e këtij vendimi si të papajtueshëm me Kushtetutën, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës. Kjo për faktin se gjashtë gjyqtarët të cilët u shprehën për rrëzimin e kërimit mbështetën dy linja të ndryshme arsyetimi lidhur me mosplotësimin e kriterëve kushtetuese për ngritjen e komisionit hetimor, ndërsa dy gjyqtarë u shprehën për pranimin e kërimit. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkimi konsiderohet i rrëzuar.

35. Kështu, sipas *njërit qëndrim²*, kërkesa për ngritjen e komisionit hetimor nuk përmbush kriterin kushtetues të ekzistencës së një “*çështjeje të veçantë*”, pasi objekti i propozuar nuk individualizon me

² Votuan sipas këtij qëndrimi Kryetarja Fiona Papajorgji dhe gjyqtarët Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Ilir Toska.



qartësi faktet ose grupin e fakteve që do t'i nënshtroheshin hetimit parlamentar. Në këtë drejtim, të dhënat dhe dokumentet e paraqitura lidhen kryesisht me një hetim të zhvilluar në SHBA ndaj ish-zyrtarit amerikan, si dhe me takimet e tij me disa përfaqësues të shtetit shqiptar. Megjithatë, as në kërkesën drejtuar Kuvendit dhe as gjatë shqyrtimit para Gjykatës nuk janë përcaktuar konkretisht veprimet ose mosveprimet e zyrtarëve shqiptarë që kërkohej të hetoheshin, lidhja e tyre me ushtrimin e funksioneve publike, si dhe mënyra sesi ato preknin interesin publik me rëndësi të veçantë shtetërore. Edhe për faktet që rezultojnë se po shqyrtohen nga organet shqiptare të drejtësisë, kërkuesi nuk ka individualizuar elementet që do të formonin objektin e veçantë të hetimit parlamentar, të dallueshëm nga veprimtaria e këtyre organeve. Në këto kushte, në zbatim të jurisprudencës së Gjykatës (*shih paragrafin 25 të vendimit*), sipas së cilës identifikimi i subjekteve dhe i objektit të veprimtarisë hetimore të komisionit përbën kusht *sine qua non* për të përcaktuar me saktësi çështjen që duhet t'i nënshtrohet hetimit parlamentar, vlerësohet se kërkuesi nuk ka arritur të individualizojë “*çështjen e veçantë*” që kërkon verifikim dhe vlerësim nga Kuvendi. Për rrjedhojë, në mungesë të kriterit kushtetues të “*çështjes së veçantë*”, sipas këtij qëndrimi, kërkimi duhej rrëzuar.

36. Ndërsa sipas *qëndrimit tjetër*³, kërkimi e plotëson kriterin kushtetues “*çështje e veçantë*”, pasi kërkuesi ka arritur të vërtetojë se zhvillimi i procesit penal nga autoritetet amerikane, ndonëse në mënyrë periferike, trajton ngjarje që lidhen me funksionarë dhe interesa të shtetit shqiptar. Për këtë arsye, kërkesa e deputetëve në rastin konkret e arrin pragun kushtetues të “*çështjes së veçantë*”. Megjithatë, përmbushja e këtij kushti të domosdoshëm nuk është gjithmonë e mjaftueshme për aktivizimin e urdhërimit të nenit 77, pika 2, të Kushtetutës ose ngritjen e detyrueshme të komisionit hetimor parlamentar. Duke mbajtur parasysh se e drejta e pakicës parlamentare për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor duhet të ushtrohet në kuadër të parimit të ndarjes së pushteteve dhe të kufijve të natyrshëm kushtetues të funksionit hetimor parlamentar, ushtrimi i këtij funksioni jetik për demokracinë parlamentare lipset të bazohet në disa

të dhëna fillestare objektive, të cilat janë në gjendje të krijojnë një dyshim të arsyeshëm në sytë e një vëzhguesi të jashtëm për praninë e një forme të tillë paligjshmërie ose cenimi të interesave shtetërore që e bën të nevojshme dhe të arsyeshme këtë formë të kontrollit politik mbi ekzekutivin. Kështu, nga përmbajtja e të dyja kërkesave të depozituara në Kuvend, në datat 13.10.2025 dhe 20.10.2025, kërkuesi ka parashtruar pretendimin se ish-agjenti i FBI-së ka zhvilluar takime me Kryeministrin shqiptar dhe me funksionarë dhe shtetas të tjerë shqiptarë, ku në këmbim të favoreve vetjake financiare ai do të ndërhynte në dëm të opozitës shqiptare. Sipas kërkuesit, ish-agjenti ka pranuar para autoriteteve të drejtësisë amerikane se para se të largohej nga FBI-ja në shtator të vitit 2018, bazuar në kontaktet e tij me qeverinë, planifikonte të hapte një biznes konsulence sigurie. Kërkuesi për të dëshmuar lidhjet e ish-agjentit me Kryeministrin ka vënë në përmbajtje të kërkesës edhe një fotografi të tyre të realizuar në zyrën e këtij të fundit. Në analizë të këtyre të dhënave rezulton se takimet e zyrtarit amerikan me përfaqësues të shtetit shqiptar nuk përbëjnë *per se* indicie dhe fakte të mjaftueshme në aspektin kushtetues për të provuar (pa)ligjshmërinë e veprimeve të zyrtarëve shqiptarë ose ekzistencën e fenomeneve negative të lidhura me integritetin e zyrtarëve shqiptarë në marrëdhënie me zyrtarë të huaj. Në këtë kontekst kërkuesi nuk arriti të evidentojë se cilat janë të dhënat dhe indiciet që e bëjnë të domosdoshme kryerjen e një hetimi parlamentar, ndaj për këtë shkak kërkimi duhej rrëzuar.

37. Kurse, sipas *qëndrimit tjetër*⁴, kërkimi plotëson kriteret kushtetuese për ngritjen e komisionit hetimor. *Së pari*, qëllimi i tij ishte ushtrimi i kontrollit politik parlamentar dhe evidentimi i përgjegjësisë politike të zyrtarëve të lartë të pushtetit ekzekutiv për veprimet ose mosveprimet e tyre në ushtrimin e funksioneve publike, pa synuar përcaktimin e përgjegjësisë penale, e cila u përket ekskluzivisht organeve të drejtësisë. *Së dyti*, objekti i hetimit ishte përcaktuar qartë dhe lidhej drejtpërdrejt me funksionet kushtetuese të Kuvendit, pasi synonte të verifikonte ligjshmërinë e veprimeve të zyrtarëve shqiptarë në raport me ish-agjentin e FBI-së dhe të evidentonte problematika që mund të kërkonin

³ Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Genti Ibrahimi dhe Marjana Semini.

⁴ Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Marsida Xhaferllari dhe Asim Vokshi.



ndërhyrje në planin ligjvënës ose në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës të Kuvendit. *Së treti*, çështja paraqiste një karakter të veçantë, pasi kërkesa mbështetej në një grup faktesh konkrete që u atribuoheshin zyrtarëve shqiptarë dhe që ngrinin dyshime të arsyeshme për ligjshmërinë e veprimtarisë së tyre. Këto indicie nuk buronin vetëm nga aktet dhe vendimet e autoriteteve gjyqësore të SHBA-së në lidhje me çështjen McGonigal, por edhe nga vendime të gjykatave shqiptare që shqyrtonin mosmarrëveshje të lidhura me procedura prokurimi të zhvilluara pa garë. Në këto rrethana nuk mund të pranohej argumenti se Kuvendi nuk kishte kompetencë për të ushtruar kontroll politik mbi veprimet e zyrtarëve shqiptarë vetëm për shkak se procedimi penal në SHBA ishte zhvilluar ndaj një shtetasi amerikan. Ushtrimi i juridiksionit penal nga autoritetet amerikane ndaj ish-agentit të FBI-së nuk përjashtonte kompetencën kushtetuese të Kuvendit për të hetuar, në planin politik, sjelljen e zyrtarëve shqiptarë, për aq kohë sa veprimet ose mosveprimet e tyre i nënshtrohen rendit juridik shqiptar dhe mund të kenë cenuar interesin publik, funksionimin e institucioneve shtetërore ose interesat e Republikës së Shqipërisë dhe të qytetarëve të saj. Për këtë arsye, komisioni nuk synonte të mbivendoste kompetencat e organeve të drejtësisë dhe as të ndërhynte në ushtrimin e juridiksionit penal, por vetëm të ushtronte funksionin kushtetues të kontrollit parlamentar mbi veprimtarinë e ekzekutivit. Për rrjedhojë, argumentet e Kuvendit për rrëzimin e projektvendimit nuk ishin të tilla që të justifikonin kufizimin e së drejtës kushtetuese të pakicës parlamentare për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor. Në këto kushte, kërkitimi duhej të pranohej dhe të shfuqizohej vendimi nr. 77/2025 i Kuvendit.

B.2. Për kërkesën për ngritjen e Komisionit Hetimor për Zgjedhjet e 11 majit 2025

38. Gjykata vëren se në kërkesën e depozituar në Kuvend në datën 13.10.2025 kërkuar ka parashtruar se, sipas raportit paraprak të OSBE/ODIHR-it, zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025 u zhvilluan në një mjedis tejet të polarizuar, ku garuesit nuk gëzuan mundësi të barabarta dhe partia në pushtet përfitoi nga përdorimi i gjerë i burimeve administrative gjatë fushatës. Sipas kërkuar, raporti evidentonte gjithashtu akuza për intimidimin e zgjedhësve, veçanërisht të punonjësve të administratës publike, mangësi të legjislacionit

zgjedhor për parandalimin e praktikave abuzive, si dhe problematika që lidhen me pluralizmin mediatik dhe mundësinë e zgjedhësve për të bërë një zgjedhje të informuar. Në mbështetje të këtyre konstatimeve, kërkuar ka pretenduar se zgjedhjet u karakterizuan edhe nga shitblerja e votës, intimidimi i zgjedhësve, përdorimi i administratës shtetërore për qëllime elektorale, sistemi i patronazhimit, manipulimi i votës së diasporës dhe parregullsi të tjera të rënda, të cilat, sipas tij, u toleruan ose u mbështetën nga institucione shtetërore, duke cenuar standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

39. Nisur nga këto rrethana, kërkuar ka kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar, me qëllim verifikimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror dhe vendor, si dhe të përdorimit të burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 11 majit 2025. Sipas tij, komisioni do të evidentonte përgjegjësitë institucionale dhe do të vlerësonte nevojën për marrjen e masave, përfshirë ndryshimet ligjore, me synim parandalimin e përsëritjes së fenomeneve të ngjashme dhe forcimin e integritetit të proceseve zgjedhore në të ardhmen.

40. Në mbështetje të kërkesës, kërkuar ka argumentuar se objekti dhe qëllimi i komisionit janë në përputhje me Kushtetutën, pasi ai nuk synon të ushtrojë kompetenca që u përkasin organeve të tjera kushtetuese, por të realizojë funksionin e kontrollit parlamentar mbi veprimtarinë e autoriteteve publike, të evidentojë përgjegjësi me karakter institucional dhe të vlerësojë nevojën për përmirësimin e kuadrit ligjor. Sipas tij, hetimi parlamentar do të shërbente edhe për mbrojtjen e demokracisë përfaqësuese, pluralizmit politik dhe shtetit të së drejtës, si dhe për garantimin e përdorimit të ligjshëm të burimeve publike dhe të standardeve demokratike, të domosdoshme edhe në kuadër të procesit të integritetit evropian të vendit.

41. Nga përmbajtja e debateve parlamentare të zhvilluara në seancën plenare rezulton se për kërkesën për ngritjen e komisionit hetimor lidhur me zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025, shumica parlamentare vlerësoi se objekti i propozuar nuk përmbushte kriteret kushtetuese për ushtrimin e hetimit parlamentar. Sipas saj, objekti ishte formuluar në mënyrë të përgjithshme, pa identifikuar akte administrative individuale, vendime ose procedura konkrete që të përmbanin indicie dhe



të dhëna të mjaftueshme për të justifikuar zhvillimin e hetimit. Gjithashtu, u vlerësua se ai mbivendosej me objektin e veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore, të ngritur më 27.10.2025, ndërsa problematikat e evidentuara në procesin zgjedhor mund të trajtoheshin nëpërmjet mekanizmave ligjorë dhe gjyqësorë të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, pa qenë e nevojshme ngritja e një komisioni hetimor parlamentar.

42. Kuvendi në gjykimin kushtetues ka prapësuar se mosmiratimi i projektvendimit për ngritjen e komisionit hetimor lidhur me zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025 nuk ka cenuar të drejtën kushtetuese të një të katërtës së deputetëve, pasi kërkuksi ka ushtruar plotësisht të drejtën e tij për të paraqitur kërkesën dhe për ta mbrojtur atë në seancë plenare. Sipas Kuvendit, kërkesa nuk përmbushte kriteret kushtetuese të parashikuara nga neni 77 i Kushtetutës, pasi objekti i hetimit nuk ishte përcaktuar qartë dhe nuk mbështetej në indicie konkrete që të justifikonin ushtrimin e funksionit hetimor parlamentar. Në këtë drejtim ai ka argumentuar se raportet e vëzhguesve ndërkombëtarë përmbajnë vlerësime dhe rekomandime me karakter të përgjithshëm, pa identifikuar akte administrative individuale ose procedura konkrete që mund të përbëjnë objekt të një hetimi parlamentar. Po kështu, Kuvendi ka theksuar se shumica parlamentare nuk kishte detyrimin të riformulonte objektin e kërkesës, pasi një ndërhyrje e tillë do të zhvendoste përgjegjësinë kushtetuese për përcaktimin e objektit të hetimit nga pakica parlamentare te shumica, në kundërshtim me natyrën e së drejtës së garantuar nga neni 77 i Kushtetutës.

43. Në vlerësim të pretendimeve të palëve, Gjykata çmon se çështja që shtrohet për zgjidhje në këtë gjykim ka të bëjë me verifikimin nëse objekti dhe qëllimi i komisionit hetimor të propozuar janë në përputhje me kriteret dhe standardet kushtetuese që rregullojnë ushtrimin e funksionit hetimor parlamentar. Në këtë kuadër, Gjykata do të analizojë nëse objekti i hetimit është përcaktuar me qartësi, lidhet me funksionet kushtetuese të Kuvendit, si dhe nëse qëllimi i tij respekton kufijtë kushtetues të këtij instrumenti të kontrollit parlamentar.

44. Duke u bazuar në standardet kushtetuese të zhvilluara për komisionet hetimore (*shih paragrafët*

21-23 të vendimit), Gjykata thekson se komisionet parlamentare hetimore përbëjnë një nga instrumentet më të rëndësishme nëpërmjet të cilave Kuvendi ushtron funksionin e tij kushtetues të kontrollit politik mbi veprimtarinë e pushtetit ekzekutiv dhe të autoriteteve publike. Nëpërmjet këtij instrumenti, Kuvendi verifikon mënyrën e ushtrimit të funksioneve publike, evidenton problematika me interes publik, vlerëson përgjegjësitë me karakter politik dhe institucional, si edhe krijon bazën e nevojshme për ushtrimin e funksionit ligjvënës, përmes përmirësimit të kuadrit normativ. Në këtë kuptim, komisionet hetimore nuk përbëjnë një mekanizëm për përcaktimin e përgjegjësisë juridike individuale, por një mjet kushtetues të kontrollit politik, që i mundëson Kuvendit të ushtrojë në mënyrë efektive rolin e tij mbikëqyrës dhe përfaqësues në një shtet demokratik.

45. Në të njëjtën linjë, edhe Komisioni i Venecias ka theksuar se komisionet parlamentare hetimore përbëjnë një nga instrumentet kryesore të funksionit kushtetues të kontrollit parlamentar, nëpërmjet të cilit parlamenti mbikëqyr veprimtarinë e pushtetit ekzekutiv, me synim garantimin e përgjegjshmërisë politike, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e administratës publike. Sipas tij, ato shërbejnë njëkohësisht si një mjet i rëndësishëm për ushtrimin e funksionit ligjvënës, duke mundësuar mbledhjen e informacionit të nevojshëm për vlerësimin e legjislacionit në fuqi dhe ndërmarrjen e nismave të reja ligjore. Për këtë arsye, objekti i hetimit parlamentar mund të shtrihet edhe mbi çështje me interes të gjerë publik, për sa kohë që ato lidhen me ushtrimin e funksioneve kushtetuese të parlamentit. Duke pasur parasysh ndikimin e tyre të rëndësishëm politik dhe institucional, Komisioni i Venecias thekson se komisionet hetimore duhet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në respektim të kufijve dhe garancive kushtetuese (*shih Përmbledhjen e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias për Autonominë Parlamentare*, CDL-PI(2025)014, datë 18.12.2025).

46. Gjykata vëren se rëndësia e ushtrimit efektiv të funksionit të kontrollit parlamentar është theksuar edhe në kuadër të procesit të integritetit evropian të Shqipërisë. Në këtë drejtim, Bashkimi Evropian ka vlerësuar se ndonëse roli i Kuvendit është konsoliduar gradualisht, ushtrimi i kontrollit ndaj ekzekutivit mbetet i kufizuar, duke inkurajuar forcimin e mëtejshëm të transparencës,



llogaridhënies, integritetit dhe efektivitetit të veprimtarisë parlamentare. Po kështu, ai ka theksuar se një parlament funksional duhet të jetë në gjendje të ushtrojë kontroll efektiv mbi ekzekutivin dhe të përmbushë funksionin e tij ligjvënës, duke e konsideruar garantimin e këtyre funksioneve si një shtyllë themelore të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (*shih Dokumentin AD 13/26 të Konferencës për Anëtarësim në Bashkimin Evropian – Shqipëria – datë 22.5.2026*).

47. Në dritën e standardeve të mësipërme, Gjykata vlerëson se objekti dhe qëllimi i komisionit hetimor të propozuar për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025 përputhen me kriteret kushtetuese të zhvilluara në jurisprudencën e saj. Objekti i hetimit lidhet me verifikimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror dhe vendor, si dhe të përdorimit të burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale, ndërsa qëllimi i tij është evidentimi i përgjegjësiwe institucionale dhe vlerësimi i nevojës për ndërhyrje ligjore, me synim garantimin e integritetit, ligjshmërisë dhe barazisë në proceset zgjedhore të ardhshme. Për nga natyra e tij, ky hetim nuk synon të përcaktojë përgjegjësi penale individuale, të ndërhyjë në kompetencat e organeve të drejtësisë ose të organeve të administrimit dhe gjykimit të mosmarrëveshjeve zgjedhore, por të ushtrojë funksionin kushtetues të kontrollit parlamentar mbi veprimtarinë e autoriteteve publike dhe të krijojë bazën e nevojshme për ushtrimin e funksionit ligjvënës.

48. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se çështja që synohet t'i nënshtrohet hetimit parlamentar përbën një “*çështje të veçantë*”, në kuptim të nenit 77, pika 2, të Kushtetutës. Integriteti i procesit zgjedhor, respektimi i parimeve të zgjedhjeve të lira e të ndershme dhe përdorimi i burimeve publike gjatë zgjedhjeve janë çështje që lidhen drejtpërdrejt me funksionimin e rendit demokratik dhe paraqesin një interes të veçantë publik. Në këtë kuadër, verifikimi i mënyrës së zbatimit të legjislacionit zgjedhor, evidentimi i problematikave të konstatuara në raportin e vëzhgimit të OSBE/ODIHR-it, përfshirë përdorimin e fondeve dhe burimeve publike, si dhe vlerësimi i nevojës për përmirësimin e kuadrit ligjor përfshihen brenda funksionit kushtetues të kontrollit parlamentar dhe përmbushin kriterin kushtetues të “*çështjes së veçantë*”.

49. Pasi konstatoi se objekti dhe qëllimi i komisionit hetimor përputhen me kriteret

kushtetuese, Gjykata do të shqyrtojë argumentet mbi të cilat Kuvendi ka mbështetur mosmiratimin e projektvendimit. Në këtë kuadër, ajo do të vlerësojë nëse këto argumente janë të natyrës kushtetuese dhe nëse ato justifikojnë kufizimin e së drejtës së pakicës parlamentare për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor.

50. Gjykata nuk e gjen të bazuar argumentin e Kuvendit se objekti i komisionit hetimor ishte formuluar në mënyrë të përgjithshme, pa identifikuar akte administrative individuale, vendime ose procedura konkrete që të përmbanin indicie të mjaftueshme për të justifikuar zhvillimin e hetimit parlamentar. Kërkesa kushtetuese për përcaktimin e qartë të objektit të hetimit nuk mund të interpretohet në kuptimin se pakica parlamentare duhet të paraqesë prova të plota ose të vërtetojë paraprakisht faktet që synon të hetojë komisioni. Një interpretim i tillë do të ishte në kundërshtim me natyrën e këtij instrumenti kushtetues, pasi mbledhja, verifikimi dhe vlerësimi i provave përbëjnë vetë thelbin e veprimtarisë së komisionit hetimor. Për rrjedhojë, për ngritjen e tij mjafton që objekti të jetë i përcaktuar qartë dhe të mbështetet në indicie të arsyeshme që justifikojnë ushtrimin e kontrollit parlamentar. Të kërkohej që faktet të provoheshin plotësisht që në fazën e paraqitjes së kërkesës do të vendoste mbi pakicën parlamentare një barrë joproporcionale, duke e bërë praktikisht të pamundur ngritjen e një komisioni hetimor dhe duke cenuar garancinë kushtetuese të parashikuar në nenin 77 të Kushtetutës.

51. Po kështu, Gjykata nuk e gjen të bazuar argumentin e Kuvendit se ngritja e komisionit hetimor do ta shndërronte Kuvendin në një “superorgan” për rishqyrtimin e pretendimeve të trajtuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ose Kolegji Zgjedhor. Objekti i komisionit nuk synon të ushtrojë funksione gjyqësore, të verifikojë ligjshmërinë e vendimeve të këtyre organeve ose të zëvendësojë kompetencat e tyre kushtetuese dhe ligjore. Përkundrazi, ai synon të ushtrojë kontrollin politik parlamentar mbi veprimtarinë e autoriteteve publike në lidhje me procesin zgjedhor, të evidentojë problematika me interes publik dhe të vlerësojë nëse ekziston nevoja për ndërhyrje ligjore ose masa të tjera institucionale. Për këtë arsye, fakti që disa aspekte të procesit zgjedhor mund të kenë qenë objekt shqyrtimi nga organet e administrimit ose gjykimit zgjedhor nuk përjashton ushtrimin e



funksionit kushtetues të kontrollit parlamentar, për sa kohë që komisioni nuk ndërhyr në kompetencat e tyre dhe nuk synon të rishqyrtojë ose të zëvendësojë vendimmarrjen e tyre.

52. Në të njëjtën linjë, Gjykata nuk e gjen të bazuar as argumentin e Kuvendit se ngritja e komisionit hetimor do të krijonte mbivendosje me Komisionin e Posaçëm për Reformën Zgjedhore. Edhe pse të dyja komisionet lidhen me procesin zgjedhor, ato kanë objekte, funksione dhe rezultate të ndryshme. Komisioni hetimor synon të ushtrojë kontrollin politik parlamentar mbi veprimtarinë e autoriteteve publike në lidhje me zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025, duke evidentuar problematikat dhe përgjegjësitë institucionale, ndërsa Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore ka si mision hartimin e propozimeve për përmirësimin e kuadrit ligjor zgjedhor. Për rrjedhojë, veprimtaria e tyre nuk është konkurruese, por plotësuese, pasi rezultatet e hetimit parlamentar mund të përbëjnë një burim të rëndësishëm informacioni për punën e komisionit të reformës. Në këtë drejtim, Gjykata mban parasysh edhe faktin se, ashtu siç parashtrori kërkuar, një praktikë e ngjashme parlamentare ka ekzistuar edhe në vitin 2021, kur veprimtaria e një komisioni hetimor është zhvilluar paralelisht me atë të Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore, pa u konsideruar se krijohej mbivendosje e papajtueshme ndërmjet tyre. Në përmbledhje të këtij argumenti, Gjykata thekson se vetë fakti që Kuvendi ka vendosur të ngrejë një komision për reformën zgjedhore nuk mund të përbëjë shkak kushtetues për t'i mohuar pakicës parlamentare të drejtën për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor, për sa kohë që ky i fundit përmbush kriteret e parashikuara nga neni 77 i Kushtetutës. Pranimi i këtij interpretimi do ta linte në vullnetin e shumicës parlamentare mundësinë për të neutralizuar ushtrimin e së drejtës kushtetuese të pakicës vetëm nëpërmjet ngritjes së një komisioni tjetër me objekt të ngjashëm. Një rezultat i tillë do të binte ndesh me qëllimin e nenit 77 të Kushtetutës.

53. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkitimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar nga vendimi nr. 78/2025 i Kuvendit dhe shfuqizimi i këtij vendimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, është i bazuar dhe duhet të pranohet, pasi pakicës parlamentare i është kufizuar e drejta për të kërkuar ngritjen e këtij komisioni, në kushtet

kur ajo ka përcaktuar qartësisht objektin dhe çështja plotëson kriterin kushtetues të “*çështjes së veçantë*”.

54. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkimet e kërkuarës janë pjesërisht të bazuara, sipas arsytimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 77 dhe 131, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 54, 55 dhe 56 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.

2. Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar detyrimin e Kuvendit për ngritjen e komisionit hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, si dhe për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 11 majit 2025”.

3. Shfuqizimin e vendimit nr. 78/2025 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e komisionit hetimor për kontrollin e ligjshmërisë së veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, si dhe për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 11 majit 2025””, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

4. Rrëzimin e kërtimeve të tjera.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 1.6.2026.

Shpallur më 17.7.2026.

Kryetar: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Ilir Toska

Anëtarë pjesërisht kundër: Marsida Xhaferllari, Asim Vokshi



MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të vënë në lëvizje nga një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë (jo më pak se një e katërta e deputetëve), me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Shqipërisë, si dhe deklarimin si të papajtueshme me Kushtetutën të dy vendimeve nr. 77/2025 dhe nr. 78/2025 për mosmiratimin e projektvendimeve për ngritjen e dy komisioneve hetimore, edhe pse pajtohemi me shumicën për pranimin e kërkit për sa i takon Komisionit Hetimor për Zgjedhjet e 11 majit 2025, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica lidhur me bazën kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar nga vendimi nr. 78/2025 i Kuvendit dhe shfuqizimin e këtij vendimi. Në vlerësimin tonë, pjesa e objektit që lidhet me kontrollin e ligjshmërisë së disa institucioneve paraqiste një shkallë përgjithësimi që kërkonte qartësim. Megjithatë, kjo mangësi ishte e korrigjueshme përmes bashkëpunimit luajal kushtetues dhe nuk mund të shërbente, pa u ndjekur më parë kjo rrugë, si shkak për refuzimin e ngritjes së komisionit hetimor.

2. Nga shqyrtimi kushtetues i çështjes rezultoi se kërkuksi ka depozituar në Kuvend dy kërkesa për ngritjen e dy komisioneve hetimore, njëra prej të cilave lidhet me kontrollin e ligjshmërisë së veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, si dhe verifikimin e përdorimit të burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 11 majit 2025. Objekti i këtij komisioni do të ishte: i. verifikimi i ligjshmërisë së veprimtarisë të organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, si dhe i përdorimit të burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 11 majit 2025; ii. vlerësimi i nevojës për marrjen e masave, përfshirë ndërhyrjet ligjore për garantimin e parimeve të ligjshmërisë, integritetit, barazisë, lirisë dhe ndershmërisë në proceset zgjedhore të ardhshme.

3. Në vijim të diskutimeve mes palëve për objektin dhe përmbajtjen e kërkesës, u ra dakord që të rregullohej gjuha e përdorur. Për këtë qëllim propozuesi (grupi parlamentar i opozitës) ka riparazitur kërkesën, duke parashtruar se kishin përmirësuar formulimin dhe gjuhën e kërkesës, ndërsa objekti i komisionit nuk kishte ndryshuar. Konkretisht, në kërkesën për ngritjen e komisionit,

shprehjet “*këto zgjedhje konfirmuan edhe një herë shqetësimin e ngritur në vazhdimësi nga opozita*”, “*përdorimit të paligjshëm*”, “*procesi zgjedhor u provua të ishte*”, “*del qartë se*”, “*përballë shkeljeve masive të legjislacionit*” (shih kërkesën e datës 13.10.2025, faqet 1, 2 dhe 3) u zëvendësuan me shprehjet “*në këto zgjedhje krijohen indicie/fakte dhe grupfakte që ngrenë edhe një herë shqetësimet e konstatuara në vazhdimësi nga opozita*”, “*përdorimit të mundshëm të paligjshëm*”, “*procesi zgjedhor ka indicie/fakte/grupfakte se ishte*”, “*është një indicie e qartë se*”, “*përballë indicieve/fakteve/grupfakteve që krijojnë dyshimin e arsyeshëm për shkelje masive të legjislacionit*” (shih kërkesën e datës 20.10.2025, faqet 1, 2 dhe 3). Gjithashtu, nga kërkesa e parë është hequr nga përmbajtja shprehja “*Pati shumë raportime për blerje të votave me fletë votimi të Diasporës në Itali dhe Greqi që shiteshin për shuma nga 100 deri në 500 euro*” (shih kërkesën e datës 13.10.2025, faqe 6).

4. Kuvendi, në seancë plenare, ka vendosur mosmiratimin e ngritjes së këtij komisioni për disa shkaqe, të lidhura edhe me formulimin e objektit dhe përmbajtjes së aktit (shih paragrafët 3, 4, 5 dhe 7 të vendimit). Për këtë arsye, kërkuksi iu drejtua me kërkesë Gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave.

5. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së kërkesave të depozituara në Kuvend lidhur me ngritjen e Komisionit Hetimor për Zgjedhjet e 11 majit 2025 (datë 13.10.2025 dhe datë 20.10.2025) vërehet se dy janë çështjet kryesore të përcaktuara në objekt: *së pari*, kontrolli i ligjshmërisë së veprimtarisë të organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor dhe *së dyti*, verifikimi i përdorimit të burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale. Lidhur me këto dy çështje kërkuksi ka identifikuar mbi bazën e raportit të OSBE-ODIHR-it indicie që, sipas tij, ishin të qarta dhe dëshmonin se zgjedhjet ishin kompromentuar rëndë dhe problematika serioze vëreheshin në drejtim të: i. shiblerjes së votës; ii. intimidimit të zgjedhëseve; iii. shtetit elektorale; iv. sistemit kriminal të patronazhimit; v. manipulimit të votës së diasporës; vi. finalizimit të farsës elektorale në ditën e votimit (shih kërkesën e datës 20.10.2025, faqe 3).

6. Në vijim, kërkuksi ka parashtruar se institucionet kryesore, si KQZ-ja, Policia e Shtetit, Prokuroria e Posaçme dhe prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm përfshirë edhe gjykatat, kanë vepruar në bashkëpunim për të mbrojtur dhe mbështetur në mënyrë të pajustificuar partinë në



pushtet (*shih po aty, faqe 4*). Gjithashtu, sipas kërkesit, qeveria u angazhua në një abuzim të pushtetit dhe burimeve shtetërore për të manipuluar procesin zgjedhor dhe konkretisht: keqpërdorimi i enteve publike (organizimi i 4500 eventeve publike dhe Giro D'Italia), kapja e institucioneve shtetërore (nëpunësve civilë iu caktuan detyra partiake); riaktivizimi i sistemit të patronazhimit (mijëra nëpunës civilë, oficerë policie, personel ushtarak, prokurorë dhe gjyqtarë, u ngarkuan secili me detyrën e sigurimit të një minimumi prej 20 votash; patronazhistëve iu dha akses në *e-Albania*); blerja e drejtpërdrejtë e votave (shpërndarja e pagesave për pensionistët); manipulimi përmes subvecioneve për fermerët (shpërndarja e 300 milionë euro grante dhe garanci sovraane për fermerët), anulimi masiv i gjobave; miratimi i 138 licencave për kultivimin e kanabisit; prokurime të paligjshme me shpenzime mbi 500 milionë euro; abuzimi me lejet e legalizimit dhe të ndërtimit (lëshimi i 15 mijë legalizimeve dhe certifikatave të pronësisë); punësime të paligjshme (afërsisht 10 mijë individë u punësuan në administratën vendore dhe qendrore) etj. (*shih po aty faqet 4–5*).

7. Nga analiza e përmbajtjes së kërkesave evidentohet se argumentet e kërkesit për sa i takon pjesës së parë të objektit të kërkesës – kontrolli i ligjshmërisë së veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor - paraqesin një shkallë përgjithësimi që kërkonte qartësim të mëtejshëm. Edhe pse kërkuesi ka përmendur institucione të tilla si KQZ-ja, Policia e Shtetit, Prokuroria e Posaçme, prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm dhe gjykatat, ai nuk ka konkretizuar në mënyrë të mjaftueshme aktet, vendimet, procedurat ose veprimet e secilit prej këtyre institucioneve që do t'i nënshtroheshin hetimit parlamentar. Përmendja e tyre mbetet e gjerë dhe nuk mundëson përcaktimin e kufijve të saktë të veprimtarisë hetimore, ndërkohë që identifikimi i subjekteve dhe i objektit të hetimit janë kusht i nevojshëm për përcaktimin e çështjes që do t'i nënshtrohet kontrollit parlamentar. Megjithatë, kjo mangësi nuk e bënte të papërcaktueshëm objektin e komisionit në tërësi. Çështja që kërkohej të hetohej, periudha zgjedhore dhe fusha e veprimtarisë publike ishin të identifikueshme, ndaj formulimi i pjesës së parë kërkonte qartësim dhe ngushtim përmes bashkëpunimit ndërmjet shumicës dhe pakicës parlamentare, dhe jo refuzimin e të gjithë kërkesës.

Në ndryshim nga pjesa e parë, pjesa tjetër që lidhet me verifikimin e përdorimit të burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale përmbante të dhëna më specifike dhe më lehtësisht të individualizueshme, si ato që lidheshin me organizimin e veprimtarive publike, dhënien e licencave ose të lejeve të pretenduara si të paligjshme, punësimet në administratë dhe përdorimin e fondeve publike. Këto të dhëna përbënin indicie të mjaftueshme për të justifikuar kryerjen e veprimeve hetimore me qëllim verifikimin nëse dyshimet e ngritura nga kërkuesi ishin ose jo të bazuara.

8. Nga ana tjetër, kërkuesi ka pretenduar se Kuvendi nuk mund ta refuzojë ngritjen e komisionit vetëm me votën e shumicës, pa ofruar një formulim alternativ të objektit dhe për arsye të pabazuara (*shih paragrafin 11.1. të vendimit*). Përkundër këtij pretendimi, Kuvendi ka prapësuar se mosmiratimi i projektvendimeve nuk ka penguar ushtrimin e kompetencës së pakicës parlamentare, pasi kërkuesi kanë ushtruar plotësisht të drejtën e tyre për të paraqitur kërkesat dhe për t'i mbrojtur ato në seancë plenare, pa iu mohuar e drejta e shqyrtimit ose e debatit parlamentar (*shih paragrafin 12.1. të vendimit*).

9. Në analizë të fakteve dhe rrethanave që lidhen me procedurën parlamentare për shqyrtimin dhe (mos)miratimin e ngritjes së këtij komisioni, vërehet se ndërmjet shumicës dhe pakicës parlamentare nuk është arritur një formulim alternativ konsensual i objektit të komisionit. Çështja e bashkëpunimit, me qëllim ofrimin e formulimeve alternative në rastin e kërkesave për ngritjen e komisioneve hetimore, ka qenë e trajtuar gjerësisht nga Gjykata në çështjen për kontrollin e kushtetutshmërisë së ndryshimeve në ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002, "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", i ndryshuar (*Ligji për Komisionet Hetimore*). Në këtë rast Gjykata ka evidentuar se në ligj *mungon rregulli i bashkëpunimit kushtetues luajal midis shumicës dhe pakicës parlamentare, sipas të cilit kur shumica konstaton se objekti i hetimit rrezikon standardet dhe parimet kushtetuese, atëherë ajo ka detyrimin të propozojë formulime alternative, duke i dhënë pakicës mundësinë për të reformuluar objektin e hetimit* (*shih vendimin nr. 54, datë 9.7.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Ky standard kushtetues u kodifikua më pas nga ligjvënësi me ligjin nr. 14/2026, datë 28.1.2026, përmes shtimit të pikës 1/1 në nenin 5 të Ligjit për Komisionet Hetimore, sipas së cilës: "Në çdo rast palët



janë të detyruara të bashkëpunojnë për arritjen e një formulimi konsensual lidhur me objektin e hetimit.”. Megjithëse kjo dispozitë nuk ishte në fuqi në kohën e shqyrtimit parlamentar të kërkesës, ajo konfirmon në nivel ligjor standardin e bashkëpunimit luajal kushtetues të zhvilluar më parë në jurisprudencën e Gjykatës.

11. Pavarësisht këtij standardi kushtetues, në rastin në shqyrtim, shumica parlamentare, pasi vlerësoi se një pjesë e objektit ishte formuluar në mënyrë të përgjithshme, nuk propozoi një formulim alternativ dhe nuk i krijoi pakicës një mundësi reale për qartësimin e tij. Në këtë kuptim, shqetësimi i shumicës për shkallën e përgjithësimit të pjesës së parë të objektit nuk ishte *per se* i parëndësishëm, por ai nuk mund të justifikonte refuzimin e të gjithë kërkesës pa u respektuar më parë detyrimi për bashkëpunim luajal kushtetues. Po kështu, argumentet se objekti mbivendosej me veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore dhe se problematikat mund të trajtoheshin përmes mekanizmave ligjorë ose gjyqësorë nuk përbënin pengesa kushtetuese që të justifikonin mosngritjen e komisionit. Në kushtet kur kërkuesi kishte rishikuar më parë gjuhën e kërkesës pas diskutimeve në Konferencën e Kryetarëve, shumicës i takonte të vijonte procesin e bashkëpunimit, duke identifikuar konkretisht paqartësitë dhe duke propozuar formulime që ruanin thelbin e objektit të kërkuar nga pakica. Mungesa e këtij bashkëpunimi e bëri joefektive garancinë kushtetuese të nenit 77, pika 2, të Kushtetutës.

12. Në përfundim, ndonëse nuk ndajmë vlerësimin e shumicës se çdo pjesë e objektit ishte që në fillim plotësisht e konkretizuar, pajtohemi me përfundimin se vendimi nr. 78/2025 ka cenuar të drejtën kushtetuese të pakicës parlamentare. Pjesa e objektit që lidhej me përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale ishte e konkretizuar dhe mbështetej në indicie të mjaftueshme, ndërsa paqartësitë e pjesës tjetër ishin të korigjueshme përmes bashkëpunimit luajal kushtetues. Refuzimi i të gjithë kërkesës, pa u propozuar një formulim alternativ, nuk përbënte një kufizim të justifikuar të së drejtës së garantuar nga neni 77, pika 2, i Kushtetutës. Për rrjedhojë, kërkimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar nga vendimi nr. 78/2025 dhe për shfuqizimin e këtij

vendimi në tërësi, si të papajtueshëm me Kushtetutën, ishte i bazuar.

Kryetar: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Ilir Toska, Sandër Beci

VENDIM

Nr. 66, datë 3.6.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Asim Vokshi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 3.6.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (F) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Fran Ndreca, i përfaqësuar nga avokati Vladimir Meçi, me aktperfaqësimi.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokurori Isa Jata, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 810 regj. them., datë 27.10.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 465 (30-2023-1596), datë 25.4.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; nr. 00-2025-596 (89), datë 8.4.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, 18, 30, 33, 42, pika 2, 43, 122, pika 2, 124, 131, pika 1, shkronja “P”, 132, 134, pika 1, shkronja “I”, 142, pika 1 dhe 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit Fran Ndreca (*kërkuar*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 293/1999, në lidhje me një ngjarje të ndodhur në datën 16.2.1999, në Tiranë, në të cilën ka mbetur i vrarë shtetasi M. L. Nga hetimi paraparak ka rezultuar se në ngjarje kanë marrë pjesë dy persona, njëri nga të cilët është identifikuar si shtetasi P. M. Megjithatë nuk është arritur të kapet asnjë prej autorëve të dyshuar. Në vijim, shtetasi P. M. është akuzuar për veprat penale “Vrasja me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, si dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 78 e 25 dhe 278, paragrafi i dytë, të Kodit Penal (KP). Personi tjetër i dyshuar si bashkëpunëtor nuk është arritur të identifikohet dhe, për këtë shkak, procedimi penal është veçuar dhe është vendosur pezullimi për zbulimin e tij.

2. Në datën 19.9.1999, çështja penale në ngarkim të shtetasis P. M. është dërguar për gjykim. Në përfundim të gjykimit, të zhvilluar në mungesën e tij, ndërsa ai ka qenë i përfaqësuar nga një avokat i caktuar kryesisht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 125, datë 1.3.2000, e ka deklaruar atë fajtor sipas akuzës, duke e dënuar me 25 vjet burgim. Ky vendim është prishur dhe çështja është dërguar për rigjykim nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 291, datë 7.4.2006. Në rigjykimin e çështjes, të zhvilluar me ritin e shkurtuar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 847, datë 27.9.2006 (*vendimi nr. 847/2006*), e ka deklaruar sërish fajtor shtetasin P. M. për veprat penale “Vrasja me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, si dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, duke e dënuar respektivisht me 21 vjet dhe 1 vit burgim. Pas uljes së dënimeve sipas nenit 406 të Kodit të

Procedurës Penale (KPP) dhe bashkimit të tyre, gjykata i ka caktuar një dënim të vetëm prej 14 vjetësh burgim. Pas ankimit të prokurorit për masën e dënimit, si dhe të ankimit të shtetasis P. M. për cilësimin juridik të veprës penale, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 207, datë 12.3.2007 (*vendimi nr. 207/2007*), e ka deklaruar fajtor këtë shtetas për kryerjen e veprave penale “Vrasja me dashje”, në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, duke e dënuar respektivisht me 18 vjet dhe 1 vit burgim. Pas bashkimit të dënimeve dhe uljes së dënimit sipas nenit 406 të KPP-së, gjykata i ka caktuar atij një dënim të vetëm prej 12 vjetësh burgim. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vijim, me vendimin nr. 324, datë 12.6.2009, ka vendosur mospranimin e rekurseve të shtetasis P. M. dhe të prokurorisë.

3. Në vijim, kërkuar është identifikuar si personi tjetër i dyshuar për kryerjen e veprës penale dhe në datën 29.9.2003, Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale ka njoftuar se ai është ndaluar në shtetin italian, me qëllim ekstradimin në Shqipëri. Çështja penale e pezulluar ka rifilluar dhe kërkuar është akuzuar për veprën penale “Vrasja me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 78 e 25 të KP-së. Një muaj më pas çështja është dërguar për gjykim. Megjithatë, ekstradimi i kërkuarit nuk ka ndodhur menjëherë dhe, për këtë shkak, gjykimi i çështjes është zhvilluar në mungesën e tij, ndërsa ai ka qenë i përfaqësuar nga një avokat i caktuar kryesisht. Me vendimin nr. 6, datë 12.1.2005 (*vendimi nr. 6/2005*), Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka deklaruar fajtor kërkuar për veprën penale “Vrasja me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 78 dhe 25 të KP-së, duke e dënuar me 20 vjet burgim. Sipas asaj gjykate, kërkuar ka ndihmuar shtetasin P. M. në ekzekutimin e viktimës M. L., duke e mbajtur për të mos lëvizur.

4. Pas përfundimit të vuajtjes së një dënimi për një vepër tjetër penale dhe ekstradimit të tij nga shteti italian, kërkuar ka kërkuar rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit nr. 6/2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo kërkesë është pranuar me vendimin nr. 941 akti, datë 15.7.2014, të asaj gjykate.

5. Pas kësaj, çështja penale e themelit është gjykuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 777, datë 14.4.2015, ka vendosur lënien



në fuqi të vendimit nr. 6/2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për dënimin e kërkuarit, duke vlerësuar të drejta përfundimet e gjykatës së shkallës së parë për faktet dhe zbatimin e ligjit material dhe procedural penal. Ndonëse kërkuar ka paraqitur rekurs, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 442, datë 8.6.2017, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga ligji procedural penal.

6. Kërkuar ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), me të cilin kundërshtonte procesin penal në ngarkim të tij, duke pretenduar se i ishte cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për mbrojtje efektive dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 24, datë 30.1.2018, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi ka vlerësuar se kërkuar nuk kishte shteruar mjetet juridike efektive përpara se t'i drejtohej Gjykatës, për shkak se nuk i kishte parashtruar në rekurs pretendimet e ngritura në ankimin kushtetues individual.

7. Në datën 13.9.2022, kërkuar i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 6/2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin ai ishte dënuar penalisht. Kërkesa është bazuar në nenin 450, pika 1, shkronjat “a” dhe “c”, të KPP-së. Kërkuar ka pretenduar se faktet e vëna në themel të vendimit për dënimin penal të tij nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë, si dhe se pas vendimit për dënimin e tij kishin dalë dhe ishin zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që ishin vlerësuar një herë, tregonin se ai vendim ishte i gabuar. Për këtë kërkesë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 810 regj. themeltar, datë 27.10.2022, ka vendosur mospranimin e saj. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin nr. 465 (30-2023-1596), datë 25.4.2023, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pas shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve, me vendimin nr. 00-2025-596 (89), datë 8.4.2025, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

8. Në datën 9.10.2025, kërkuar i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të pasqyruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Ky ankim, pasi është plotësuar sipas

kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 23.10.2025. Kolegji i Gjykatës në datën 24.12.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuar**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1 *Së drejtës së aksesit në gjykatë* në aspektin e së drejtës së ankimit *substancial*, pasi gjykatat e faktit nuk kanë arsyetuar lidhur me pretendimin sipas shkronjës “a”, të nenit 450 të KPP-së. Edhe Gjykata e Lartë nuk i ka adresuar në mënyrë të veçantë pretendimet e kërkuarit, për papajtueshmëri faktike midis vendimeve të formës së prerë, duke mos dhënë një përgjigje specifike ndaj këtij kërkimi thelbësor, që, nëse do të pranohej, mund të prodhonte një rezultat të ndryshëm për kërkuarin. Gjykata e Lartë ka riprodhuar arsyetimin e gjykatës së apelit, pa u përballur konkretisht me thelbin e shkakut të rishikimit sipas nenit 450, pika 1, shkronja “a” (papajtueshmëria faktike mes vendimeve të formës së prerë). Gjykata e Lartë është kufizuar vetëm të shpjegojë në mënyrë abstrakte dallimin ndërmjet fakteve dhe vlerësimit juridik, pa verifikuar nëse ekziston realisht një mospërputhje faktike mes dy vendimeve, si çasti e mënyra e vdekjes, përmbajtja dhe pesha e pohimit të viktimës para se ndërronte jetë, si dhe skema faktike e kapjes së viktimës nga pas. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë është formalist dhe bie ndesh me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas së cilës nuk mjafton që një vendim të përmbajë një arsyetim të përgjithshëm, por pretendimet kryesore të palës duhet të kenë një adresim specifik dhe analizë të çështjeve vendimtare që mund të kenë ndikim në rezultatin e çështjes. Për më tepër, ajo gjykatë e ka shqyrtuar kërkesën për rishikim në dhomën e këshillimit, pa i krijuar mundësinë kërkuarit për të debatuar në seancë gjyqësore, duke e kthyer rishikimin në një mjet jo efektiv për të realizuar një drejtësi korrigjuese.

9.2 *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë refuzuar vlerësimin gjyqësor të deklarimeve publike



që ka bërë bashkëpandehuri P. M., duke i kualifikuar ato *ipso facto* si “jo-prova”. Kjo qasje injoron parimin e lirisë së provave sipas nenit 149, pika 2, të KPP-së dhe rregullin e përcaktuar në nenin 152, pika 3, të po atij kodi se deklaratimet e të bashkëpandehurit vlerësohen në unitet me provat e tjera. Kërkuesi ka kërkuar që transkriptimi i emisionit televiziv të shërbente si indicie për hapjen e procesit të rishikimit, duke vijuar me marrjen në pyetje të të dënuarit P. M., ballafaqimin midis të dyve, si dhe verifikimin e përputhshmërisë së tyre me aktet mjeko-ligjore e balistike.

9.3 *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* të lidhur me *parimin e ligjshmërisë* dhe *sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar në mënyrë të thelluar se përse nuk qëndrojnë kërkimet e mbështetura në shkronjat “a” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 450, së bashku me nenet 149, pika 2 dhe 152 të KPP-së, duke mos ofruar standarde aplikimi për situata analoge dhe për vlerësimin e deklaratimeve pas gjykimit të të bashkëpandehurit që përputhen me prova të reja, siç janë ato mjeko-ligjore ose balistike. Kjo situatë krijon pasiguri juridike dhe rrezik arbitrariteti në praktikë.

10. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

10.1 Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit *substancial* nuk qëndron. Gjykata e Lartë e ka trajtuar shprehimisht kërkesën për rishikim të mbështetur në nenin 450, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së. Pretendimi se në vendimin ndaj shtetasit P. M. “*viktima është dërguar menjëherë për në spital, por kishte vdekur pa arritur aty*”, ndërsa në vendimin ndaj kërkuesit thuhet “*vdekja e menjëhershme*”, është marrë në shqyrtim në kuadër të vlerësimit të asaj gjykate, e cila ka konkluduar se nuk përbëjnë papajtueshmëri faktesh, por lidhen me mënyrën si janë trajtuar dhe vlerësuar rrethanat në vendimmarrje. Për rrjedhojë, me të drejtë, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ka vend për rishikim, pasi nuk është prezent asnjë rast rishikimi. Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje shteruese dhe të drejtë të gjitha pretendimeve të kërkuesit. Ajo gjykatë e ka analizuar kërkesën në përputhje me rregullat procedurale, duke dhënë arsyet për mosshqyrtimin e saj në seancë gjyqësore. Pretendimi se Gjykata e Lartë e ka trajtuar rishikimin si apel të zakonshëm nuk qëndron, pasi ajo ka arsyetuar se pretendimet e kërkuesit nuk

plotësojnë as kërkesat e nenit 450, pika 1, shkronjat “c” dhe “a”, të KPP-së.

10.2 Edhe pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* është haptazi i pabazuar. Pretendimet e kërkuesit lidhen me mënyrën e vlerësimit të provave dhe rrethanave të çështjes, çka nuk përbën shkak për rishikim. Mosadministrimi i deklaratimeve si prova në kuadër të rishikimit është në përputhje me ligjin procedural penal dhe vendimmarrja e gjykatave të faktit është e bazuar në një analizë tërësore të provave të administruara, pa cenuar të drejtat procedurale të kërkuesit. Në gjykimin në shkallë të parë dhe në apel janë dhënë përgjigje shteruese e konkrete, ndërsa Gjykata e Lartë ka vlerësuar se refuzimi i kërkesës për rishikim nuk cenon parimet e procesit të rregullt ligjor. Me të drejtë ajo gjykatë ka arsyetuar se gjykatat e faktit kanë respektuar parimet e vlerësimit të lirë, duke arritur në përfundimin se këto deklaratime nuk përbëjnë prova.

10.3 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë ka argumentuar në mënyrë të qartë e të detajuar për pretendimet thelbësore të kërkuesit, duke sqaruar se rastet e rishikimit të parashikuara në nenin 450 të KPP-së nuk rezultojnë të pranishme në çështjen konkrete. Ajo gjykatë ka arsyetuar se pretendimet e kërkuesit lidhen me vlerësimin e rrethanave dhe të provave të çështjes, çka nuk përbën shkak për rishikim, por apel të fshehur, si dhe ka sqaruar se nuk ekziston papajtueshmëri faktike ndërmjet vendimeve të formës së prerë, por vetëm një vlerësim i ndryshëm i të njëjtave fakte.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të



nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Duke verifikuar kriteret paraprake në çështjen konkrete, Gjykata çmon se kërkuksi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “P” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin ndaj të cilit ka ngritur pretendime, ndaj justifikon interesin e drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar. Po kështu, ai plotëson edhe kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kërkuksi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 8.4.2025 dhe është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate në datën 25.6.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 9.10.2025, pra brenda afatit 4-mujor.

13. Në drejtëm të legjitimitetit *ratione materiae* kërkuksi ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtëm të së drejtës së aksesit në gjykatë në aspektin e ankimit substancial, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe standardit të arsytimit të vendimit të lidhur me *parimin e ligjshmërisë* dhe *sigurisë juridike*. Këto pretendime kërkuksi i ka mbështetur në argumentet se gjykatat e faktit nuk kanë arsyetuar lidhur me kërkimin e mbështetur në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 450 të KPP-së, ndërsa për kërkimin tjetër të mbështetur në shkronjën “c” të atij neni, ato gjykata kanë mbajtur një qasje që cenon parimin e lirisë së provave sipas nenit 149, pika 2, të KPP-së. Gjykata e Lartë, nga ana e saj, nëpërmjet një arsytimi formalist, shpjegon në mënyrë abstrakte dallimin ndërmjet fakteve dhe vlerësimit juridik, pa verifikuar nëse ekziston realisht një mospërputhje faktike mes dy vendimeve. Në kushtet kur pretendimet e kërkuksit, në thelb, lidhen me arsytimin e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për mospranimin e kërkesës për

rishikimin e vendimit të formës së prerë, nisur nga thelbi dhe natyra e këtyre pretendimeve, Gjykata vlerëson t’i shqyrtojë në vijim në drejtëm të së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e ankimit substancial dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, të cilat bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues dhe garantohen respektivisht në nenet 42 dhe 142, pika 1 të Kushtetutës

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e ankimit substancial dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

14. Kërkuksi ka pretenduar se gjykatat padrejtësisht nuk kanë pranuar kërkesën për rishikimin e vendimit penal të dënimit të tij, pas vlerësimit që kanë bërë për provën e re në shkellje të neneve 149 dhe 152 të KPP-së. Gjykatat e faktit nuk kanë verifikuar papajtueshmërinë faktike midis vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ndërsa Gjykata e Lartë nuk i ka adresuar në mënyrë të veçantë këto pretendime të kërkuksit, duke mos dhënë një përgjigje specifike për to. Nëpërmjet një vendimi formalist, ajo gjykatë kufizohet vetëm në shpjegimin në mënyrë abstrakte të dallimit ndërmjet fakteve dhe vlerësimit juridik të fakteve, pa verifikuar nëse ekziston realisht një mospërputhje faktike mes dy vendimeve. Ajo gjykatë e ka trajtuar kërkesën për rishikim si një apel të zakonshëm, për më tepër, që e ka shqyrtuar atë në dhomën e këshillimit, pa i krijuar mundësinë kërkuksit për të debatuar në seancë gjyqësore, duke e shndërruar rishikimin në një mjet jo efektiv për të realizuar një drejtësi korrigjuese.

15. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se pretendimi nuk qëndron, pasi Gjykata e Lartë e ka trajtuar shprehimisht kërkesën për rishikim të mbështetur në nenin 450, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së, duke evidentuar se për të gjetur zbatim duhet të ketë papajtueshmëri në faktet e vëna në themel të vendimeve dhe jo thjesht një qasje të ndryshme në vlerësimin e tyre. Në këtë kuadër, ajo gjykatë ka arritur në përfundimin se në asnjë moment nga këto vendime nuk janë pasqyruar fakte në kundërshtim me njëri-tjetrin, por këto fakte janë vlerësuar në mënyra të ndryshme, duke përjashtuar kështu kushtet për rishikim sipas nenit 450, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së. Me të drejtë, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ka vend për rishikim, pasi nuk është i pranishëm asnjë nga rastet



ligjore të rishikimit. Ajo gjykatë është shprehur se të dyja gjykatat kanë bërë analizë tërësore dhe objektive, kanë dhënë arsye të mbështetura në ligj dhe në prova, dhe se vendimet janë mjaftueshëm të arsyetuar, duke u dhënë përgjigje shteruese dhe të drejtë të gjitha pretendimeve të kërkuarit. Gjykata e Lartë e ka analizuar kërkesën në përputhje me rregullat procedurale, duke dhënë arsyet për mosshqyrtimin e saj në seancë gjyqësore. Ajo gjykatë nuk e ka identifikuar rishikimin si apel të zakonshëm, pasi ka arsyetuar se rishikimi është i lejueshëm vetëm në rastet e përcaktuara në KPP dhe, në rastin konkret, ka konkluduar se pretendimet e kërkuarit nuk plotësojnë kërkesat e nenit 450, pika 1, shkronjat “c” dhe “a”, të KPP-së.

16. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Ndërkohë, neni 142, pika 1, i Kushtetutës parashikon se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuar.

17. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Po kështu, Gjykata ka pohuar se standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e së drejtës së aksesit në gjykim dhe së drejtës së ankimit efektiv (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 1, datë 26.1.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në lidhje me standardin e arsyetimit, Gjykata ka theksuar se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është edhe e drejta e aksesit në gjykim. Megjithatë, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 45, datë 3.7.2017; nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, në vijimësi, ka theksuar se zbatimi i ligjit është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese,

si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm. Kjo do të thotë se Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi dhe, për këtë arsye, vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gabimi ligjor ose faktik është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ose i tillë që e bën të padrejtë gjykimin (*shih vendimet nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata ka pohuar se kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi dhe një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare. Për shkak se ky mjet ka për objekt një vendim gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, ai mund të ushtrohet vetëm për shkaqet e kufizuara të parashikuara shprehimisht nga ligji. Megjithatë, në fushën penale, kërkesat e sigurisë juridike nuk janë absolute, pasi shfaqja e fakteve të reja ose zbulimi i një mangësie thelbësore në procedurat e mëparshme, që mund të ketë ndikuar në rezultatin e çështjes, mund të përligjë rihapjen e procesit për korrigjimin e gabimeve gjyqësore ose të dështimeve të drejtësisë. Për rrjedhojë, kur një shkak rishikimi parashtrohet në mënyrë të argumentuar, natyra e jashtëzakonshme e këtij mjeti nuk e përjashton detyrimin e gjykatës për ta shqyrtuar atë në mënyrë konkrete dhe për t’i dhënë kërkuarit një përgjigje të arsyetuar, përndryshe, aksesit në këtë mjet do të mbetej formal dhe jo substancial. Në veçanti, shkaku i rishikimit i parashikuar nga neni 450, pika 1, shkronja “a”, i KPP-së synon të shmangë që të mbetet në fuqi një vendim penal dënimi, kur faktet vendimtare mbi të cilat ai mbështetet pretendohet se janë të papajtueshme me ato të pranuar në një vendim tjetër të formës së prerë. Për rrjedhojë, zbatimi i këtij shkaku kërkon një ekuilibër ndërmjet sigurisë juridike dhe nevojës për të verifikuar një kontradiktë faktike që mund të ndikojë në themelin e fajësisë. Në këtë kuptim, karakteri përjashtimor i rishikimit nuk mund të përligjë një qasje formaliste që shmang verifikimin efektiv të vetë shkakut të parashikuar nga ligji (*shih vendimet nr. 13, datë 7.3.2024; nr. 61, datë 27.9.2016; nr.17, datë 24.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Duke mbajtur në konsideratë standardet kushtetuese të sipërcituara, natyrën e jashtëzakonshme dhe funksionin korrigjues të mjetit të rishikimit, si dhe thelbin e argumenteve të



kërkuesit, Gjykata do të analizojë në vijim nëse ai ka marrë përgjigje përfundimtare, konkrete dhe të arsyetuar për shkaqet e rishikimit të parashtruara përpara gjykatave. Në veçanti, ajo do të verifikojë nëse shqyrtimi i shkakut të parashikuar nga neni 450, pika 1, shkronja “a”, i KPP-së ka qenë i tillë që t’i ketë garantuar kërkuesit akses substancial në këtë mjet dhe nëse vendimet gjyqësore për mospranimin e saj janë në përputhje me standardet kushtetuese të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

21. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi dhe bashkëpunëtori i tij P. M. janë proceduar dhe gjykuar më vete, për shkak se kërkuesi fillimisht nuk ishte identifikuar. Kështu, procesi gjyqësor ndaj shtetasit P. M. ka përfunduar në datën 12.6.2009, kur Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin edhe të rekursit të këtij shtetasi. Nga ana tjetër, procesi gjyqësor ndaj kërkuesit ka përfunduar në datën 8.6.2017, kur Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të tij. Në këto kushte, për t’i dhënë përgjigje pretendimit të kërkuesit në drejtim të shkakut të rishikimit të mbështetur në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 450 të KPP-së, pra se ai nuk ka marrë përgjigje përfundimtare për pretendimin se vendimi i dënimit të tij ka papajtueshmëri të fakteve me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë, Gjykata do të verifikojë arsyetimin e gjykatave të zakonshme dhe përgjigjet e dhëna nga ato për këtë pretendim të kërkuesit.

22. Nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për nevojat e gjykimit kushtetues, Gjykata vëren se kërkuesi, në datën 13.9.2022, i është drejtuar gjykatës me një kërkesë për rishikimin e vendimit penal të dënimit të tij, duke e bazuar atë në përcaktimet e shkronjave “a” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 450 të KPP-së. Ai ka pretenduar se faktet e vëna në themel të vendimit penal për dënimin e tij, vendimit nr. 6/2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk pajtoheshin me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë, konkretisht me faktet e pranuar në vendimin për dënimin e bashkëpunëtorit P. M., vendimin nr. 207/2007, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Po ashtu, ai ka pretenduar se pas vendimit penal të dënimit të tij kishin dalë dhe ishin zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që ishin vlerësuar një herë, tregonin se ai vendim ishte i gabuar. Në këtë drejtim kërkuesi i është referuar një deklaratë televizive të shtetasit P. M., në të cilën ky i fundit ka pranuar se ishte autor i vetëm në veprën penale të

vrasjes, duke përjashtuar kërkuesin nga pjesëmarrja në ngjarje.

23. Gjykata e shkallës së parë, me vendimin e datës 27.10.2022, ka vendosur mospranimin e kërkesës së kërkuesit për rishikimin e vendimit penal të dënimit, duke arsyetuar se kërkesa për rishikim ishte jashtë rasteve të parashikuara në nenin 450 të KPP-së. Sipas saj, pas vendimit penal të dënimit të kërkuesit nuk kishin dalë ose ishin zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që ishin vlerësuar një herë, të tregonin se ai vendim ishte i gabuar. Lidhur me këtë, gjykata ka arsyetuar se nuk qëndron pretendimi i kërkuesit se deklarimi i shtetasit P. M. në një emision televiziv ishte provë e re, pasi ky shtetas ka dhënë deklarime edhe më parë, përveçse pretendimi i kërkuesit në lidhje me këto deklarime ishte trajtuar edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në rastin e vendimit për mospranimin e rekursit të kërkuesit në çështjen e themelit. Po sipas gjykatës, referuar neneve 149 dhe 152 të KPP-së, deklarimet në emisione televizive nuk parashikohen nga ligji si provë. Ato, sipas ligjit, janë deklarime nga personi i marrë si i pandehur në një procedim të lidhur dhe në rastin konkret ishin trajtuar nga Gjykata e Lartë.

24. Megjithëse kërkuesi ka paraqitur ankim, duke ngritur sërish të njëjtat pretendime si në kërkesën për rishikim, vendimi i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, me vendimin e datës 25.4.2023. Edhe gjykata e apelit ka vlerësuar se pretendimet e kërkuesit nuk qëndronin në asnjë prej rasteve të parashikuara shprehimisht në nenin 450 të KPP-së. Konkretisht, sipas gjykatës së apelit, nuk plotësohej ekzistenca e një prove të re, e cila nuk ka qenë e njohur më parë nga kërkuesi në gjykimin e themelit, në kuptim të shkronjës “c” të këtij neni. Sipas saj, prova e pretenduar nga kërkuesi, intervista e dhënë nga i bashkëpandehuri në një emision televiziv, nuk përbënte provë të re në kuptim të rishikimit si mjet i jashtëzakonshëm ankimi, pasi deklarimet e atij shtetasi nuk kishin dalë ose ishin zbuluar pasi vendimi i dënimit penal të kërkuesit kishte marrë formë të prerë. Ky shtetas ka dhënë deklarimet e tij që në momentet e para pas ngjarjes, përfshirë edhe para gjykatave që kanë shqyrtuar çështjen penale në ngarkim të tij. Përveç kësaj, ato deklarime ishin jashtë çdo forme dhe procedure për marrjen e provave në një proces penal, duke mos përbërë provë në kuptim të nenit 149 të KPP-së. Për më tepër, vetë kërkuesi e kishte ngritur këtë



pretendim edhe në rekursin e tij përpara Gjykatës së Lartë dhe prova e pretenduar si e re ishte marrë në shqyrtim, duke u përcaktuar fuqia e saj provuese në raport me të gjitha provat e tjera të administruara gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes.

25. Çështja në vijim, mbi rekursin e kërkuarit, është shqyrtuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili, me vendimin e datës 8.4.2025, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit. Edhe Gjykata e Lartë ka vlerësuar se “*prova e re*” e pretenduar nga kërkuari, deklarata televizive e të bashkëpandehurit P. M., nuk përbënte provë në kuptim të nenit 149 të KPP-së, duke vlerësuar si në përputhje me ligjin procedural penal dhe me vendimin unifikues nr. 6, datë 11.1.2002, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendimmarrjet e gjykatave të faktit për mospranimin e pretendimit të kërkuarit në lidhje me rastin e rishikimit sipas nenit 450, pika 1, shkronja “c”, të KPP-së.

26. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë është ndalur edhe në pretendimin e kërkuarit për mungesën e arsytimit nga gjykatat e faktit për ekzistencën e rastit të rishikimit sipas nenit 450, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së. Ajo ka vlerësuar se kjo mangësi nuk cenonte vendimmarrjen e tyre, për sa kohë, ndonëse ky shkak rishikimi ishte parashtruar nga kërkuari që në kërkesën për rishikim, në ankim dhe më tej në rekurs, gjykatat më të ulëta, duke u shprehur se nuk ishte i pranishëm asnjë prej rasteve të parashikuara nga neni 450 i KPP-së, i kishin dhënë përgjigje në thelb edhe këtij pretendimi.

27. Në vijim, Gjykata e Lartë ka analizuar bazueshmërinë në themel të pretendimit të kërkuarit, duke arsyetuar se papajtueshmëria, sipas nenit 450, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së, duhet kuptuar si një mospërputhje objektive ndërmjet fakteve historike të pranuar si bazë e vendimeve të ndryshme dhe jo si kontradiktë logjike në vlerësimet juridike të tyre. Ligjvënësi, ka theksuar Gjykata e Lartë, në këtë dispozitë ka përdorur termin “fakte” dhe jo “arsyetim ligjor”. Sipas saj, ky shkak rishikimi kërkon: i. ekzistencën e dy vendimeve të formës së prerë, njëri prej të cilëve ishte ai për të cilin kërkohet rishikimi; ii. lidhjen e vendimeve me të njëjtin person ose me ngjarje të ndërlidhura, sikurse në rastet me shumë të pandehur ose ngjarje komplekse me disa faza, ku individë të ndryshëm gjykohen veçmas; iii. ekzistencën në vendime të një mospërputhjeje faktike dhe jo vetëm të një interpretimi të ndryshëm;

iv. mbështetjen e fakteve të vendimit tjetër në prova të pranura nga gjykata dhe me vlerë të plotë provuese dhe jo thjesht pohime ose dyshime. Qëllimi i këtij shkak rishikimi, sipas Gjykatës së Lartë, është shmangia e situatave në të cilat një person mbahet fajtor, ndërkohë që një vendim tjetër përfundimtar, në të njëjtën ose në një çështje të lidhur, ka pranuar fakte bazë krejt ndryshme, të papajtueshme me fajësinë e tij.

28. Mbështetur në këtë kuptim të ligjit procedural për rastin e rishikimit sipas nenit 450, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së, Gjykata e Lartë në vijim, në analizë të rastit konkret, ka vlerësuar se, nisur nga përmbajtja e vendimit objekt kërkese për rishikim dhe atij të dënimit të shtetasit P. M., nuk provohej rasti i rishikimit sipas kësaj dispozite, pasi, sipas saj, në asnjë moment në këto vendime nuk ishin pasqyruar fakte në kundërshtim me njëri-tjetrin, por vlerësime të ndryshme të tyre nga gjykatat respektive. Në lidhje me këtë, Gjykata e Lartë fillimisht ka evidentuar përmbajtjen e vendimit nr. 6/2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për dënimin e kërkuarit dhe, më pas, ka evidentuar edhe përmbajtjen e vendimit nr. 847/2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për dënimin e shtetasit P. M., vendim për të cilin është shprehur se ishte ndryshuar për sa i përkiste cilësimit juridik të vrasjes së viktimës dhe masës së dënimit me vendimin nr. 207/2007, të Gjykatës së Apelit Tiranë, por pa u ndalur në përmbajtjen e këtij vendimi. Mbi këtë bazë, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se midis dy vendimeve gjyqësore nuk kishte papajtueshmëri faktesh, por vlerësim të ndryshëm të tyre nga gjykatat përkatëse. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka konkluduar se vendimet gjyqësore të gjykatave më të ulëta në lidhje me kërkesën për rishikim ishin mjaftueshëm të arsyetuara, duke u dhënë përgjigje shteruese dhe të drejta të gjitha pretendimeve të kërkuarit.

29. Në këndvështrim të përmbajtjes së pretendimeve të kërkuarit dhe në analizë të vendimeve gjyqësore të mësipërme, Gjykata vëren se gjykatat e faktit kanë marrë në shqyrtim pretendimin e kërkuarit sipas nenit 450, pika 1, shkronja “c”, të KPP-së, për ekzistencën e një prove të re që do ta bënte vendimin e dënimit të tij të gabuar, duke i dhënë përgjigje këtij shkak rishikimi, të cilin e kanë gjetur të pabazuar, pasi kanë çmuar se deklarimi televiziv i të bashkëpandehurit P. M. nuk përbënte provë në kuptim të nenit 149 të KPP-së.



30. Për sa i takon pretendimit të kërkuarit për papajtueshmërinë midis fakteve të vëna në themel të dy vendimeve të formës së prerë, Gjykata vëren se gjykatat e faktit, ndonëse janë shprehur se kërkesa e kërkuarit nuk plotëson asnjë nga rastet e rishikimit sipas nenit 450, pika 1, të KPP-së, nuk kanë arsyetuar në mënyrë të veçantë për pretendimin e tij sipas shkronjës “a” të kësaj dispozite. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë, ndonëse e ka konsideruar të mjaftueshme këtë mënyrë të trajtimit të pretendimit nga gjykatat më të ulëta, ka vlerësuar bazueshmërinë e tij në themel. Fillimisht, ajo ka interpretuar kuptimin e normës ligjore dhe, në vijim, duke iu referuar përmbajtjes së vendimit penal të dënimit të kërkuarit dhe asaj të vendimit nr. 847/2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për dënimin e P. M., ka arritur në përfundimin se midis këtyre vendimeve nuk kishte papajtueshmëri faktesh, por vetëm vlerësim të ndryshëm të tyre nga gjykatat përkatëse.

31. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se natyra e jashtëzakonshme e rishikimit dhe karakteri kufizues i shkaqeve të parashikuara nga neni 450 i KPP-së nuk e përjashtonin detyrimin e Gjykatës së Lartë për të shqyrtuar në mënyrë konkrete shkaku dhe parashtruar nga kërkuari. Përkundrazi, për sa kohë kërkuari kishte identifikuar dy vendime të formës së prerë dhe kishte pretenduar se ato mbështeteshin në fakte të papajtueshme, gjykata duhej të verifikonte nëse pretendimi hynte realisht në fushën e zbatimit të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 450 të KPP-së. Vetëm një verifikim i tillë mund të garantonte që aksesin në mjetin e rishikimit të ishte substancial dhe jo thjesht formal.

32. Gjykata vëren se verifikimi i shkakut të rishikimit, të parashikuar nga neni 450, pika 1, shkronja “a”, i KPP-së, nuk mund të kufizohet në një paraqitje abstrakte të dallimit midis fakteve dhe vlerësimit të tyre juridik ose provues. Një verifikim i tillë kërkon, së pari, identifikimin e vendimit të formës së prerë për të cilin kërkohet rishikimi dhe të vendimit tjetër të formës së prerë me të cilin pretendohet papajtueshmëria. Më pas, gjykata duhet të veçojë nga secili vendim faktet historike që janë vënë realisht në themel të fajësisë dhe t'i dallojë ato nga përshkrimet anësore, provat, indicet ose argumentet e përdorura për vlerësimin e tyre. Pas kësaj, ajo duhet t'i krahasojë konkretisht faktet e pranuar në secilin vendim dhe të përcaktojë nëse ndryshimet e konstatuara përbëjnë papajtueshmëri

faktike ose vetëm një vlerësim të ndryshëm juridik ose provues. Së fundi, gjykata duhet të vlerësojë rëndësinë e papajtueshmërisë së pretenduar, pra nëse ajo mund të ndikojë në fajësinë e personit ose në themelin e vendimit të dënimit. Vetëm pas kryerjes së këtij verifikimi mund të arrihet në përfundimin nëse është ose jo i pranishëm shkak i rishikimit i parashikuar nga dispozita e mësipërme.

33. Në rastin konkret, Gjykata çmon se megjithëse Gjykata e Lartë e ka identifikuar në mënyrë të drejtë në plan abstrakt kuptimin e papajtueshmërisë faktike, ajo nuk e ka zbatuar këtë standard në mënyrë të plotë ndaj rrethanave konkrete të çështjes. Në arsyetimin e saj Gjykata e Lartë është mbështetur gjerësisht në përmbajtjen e vendimit nr. 847/2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për dënimin e shtetasit P. M., duke evidentuar vetëm se ky vendim ishte ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë për sa i përket cilësimit juridik të veprës penale dhe masës së dënimit. Megjithatë, ajo nuk ka analizuar arsyet mbi të cilat është mbështetur ky ndryshim dhe as situatën faktike të pranuar nga gjykata e apelit. Për sa kohë vendimi nr. 847/2006, ishte ndryshuar me vendimin nr. 207/2007, të Gjykatës së Apelit Tiranë, ndërsa për rekurset kundër këtij të fundit Gjykata e Lartë kishte vendosur mospranimin e tyre, vendimmarrja e formës së prerë për P. M. nuk mund të identifikohet vetëm me përmbajtjen fillestare të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Lartë duhej të merrte në shqyrtim edhe përmbajtjen e vendimit nr. 207/2007, së paku për pjesët në të cilat ai kishte ndryshuar vendimin e shkallës së parë dhe kishte pranuar një situatë tjetër faktike ose juridike.

34. Nga përmbajtja e vendimit nr. 207/2007, rezulton se gjykata e apelit ka pranuar se nuk ishte provuar ekzistenca e konflikteve të mëparshme midis viktimës dhe P. M., se konflikti kishte lindur në çast, se vrasja kishte ndodhur pas një intervali prej 5–10 minutash dhe se ajo nuk ishte kryer me paramendim. Këto rrethana, ndonëse kanë çuar edhe në ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga “Vrasja me paramendim” në “Vrasja me dashje”, nuk përbëjnë vetëm një interpretim të ndryshëm juridik të së njëjtës situatë. Ato lidhen me fakte historike që kanë të bëjnë me origjinën dhe natyrën e konfliktit, zhvillimin e tij në kohë dhe ekzistencën ose jo të një vendimi paraprak për kryerjen e vrasjes. Për rrjedhojë, ato duhej të



krahasoheshin konkretisht me faktet e vëna në themel të vendimit të dënimit të kërkuarit për vrasje me paramendim, të kryer në bashkëpunim, përfshirë faktin e pranuar se ai kishte ndihmuar P. M. në ekzekutimin e viktimës, duke e mbajtur atë që të mos lëvizte. Në veçanti, duhej të vlerësohej nëse situata faktike e pranuar nga gjykata e apelit për spontanitetin e konfliktit dhe mungesën e paramendimit ishte e pajtueshme me ekzistencën e një plani ose vendimi të përbashkët paraprak, mbi të cilin ishte mbështetur fajësia e kërkuarit.

35. Gjykata çmon të theksojë se nuk i takon asaj të përcaktojë nëse midis dy vendimeve ekziston përfundimisht papajtueshmëri faktike dhe as nëse kërkesa për rishikim duhet të pranohet. Këto çështje i përkasin juridiksionit të gjykatave të zakonshme dhe, në veçanti, Gjykatës së Lartë. Megjithatë, duke pasur parasysh funksionin e rishikimit për korrigjimin e gabimeve që mund të qëndrojnë në themel të një vendimi penal të formës së prerë, Gjykata e Lartë kishte detyrimin të shqyrtonte në mënyrë konkrete dhe të plotë pretendimin e kërkuarit. Ajo duhej të identifikonte vendimmarrjen përfundimtare për P. M., të veçonte faktet përcaktuese të pranura në të dhe t'i krahasonte ato me faktet mbi të cilat ishte mbështetur dënimi i kërkuarit. Mungesa e këtij verifikimi e lë të pambështetur përfundimin se të dyja vendimet nuk përmbanin papajtueshmëri faktesh, pasi nuk rezultoi që Gjykata e Lartë të ketë shqyrtuar rrethanat faktike mbi të cilat ishte bazuar ndryshimi i vendimit për P. M. dhe rëndësinë e mundshme të tyre për themelin e fajësisë së kërkuarit. Në këto kushte, përgjigjja e dhënë nga ajo gjykatë nuk përmbush kërkesën për një shqyrtim konkret dhe efektiv të shkakut të rishikimit. Për rrjedhojë, kërkuarit i është cenuar e *drejta për akses substancial* në mjetin e rishikimit e lidhur me *standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

36. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja

“I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-596 (89), datë 8.4.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 3.6.2026.

Shpallur më 17.7.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferrllari, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini

Anëtarë kundër: Asim Vokshi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtari Asim Vokshi, në shqyrtimin e çështjes që i përket kërkesës së kërkuarit Fran Ndreca, me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 810, të regjistrit themeltar, datë 27.10.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 465, datë 25.4.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; nr. 00-2025-596 (89), datë 8.4.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, jam kundër vendimit të shumicës për pranimin e kërkesës, për arsye të mëposhtme.

2. Shumica vendosi shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate, pasi gjeti cenim të së drejtës së aksesit në gjykatë në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, veçanërisht për sa i përket arsyetimit të detajuar të Gjykatës së Lartë në lidhje me shkakun e rishikimit të pretenduar nga kërkuari sipas nenit 450, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së.

3. Pakica vlerëson se, siç pranohet edhe nga jurisprudenca e Gjykatës dhe ajo e GJEDNJ-së, kërkesa për rishikim nuk mund të jetë “apel ose



rekurs i fshehur” dhe rrjedhimisht nuk mund të përdoret për të zhbërë një vendim penal të formës së prerë bazuar në fakte që dihen ose mund të dihen në kohën e zhvillimit të gjykimit të themelit. Neni 450, pika 1, shkronja “a”, i KPP-së parashikon shprehimisht si shkak kërkesë për rishikim “kur faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë”. Nga kjo dispozitë vihet re se shkak për rishikim nuk përbën vlerësimi i ndryshëm juridik nga gjykata i të njëjtave fakte, por nëse një fakt që është kryesor për përcaktimin e fajësisë, del se është i ndryshëm në dy vendime gjyqësore penale që trajtojnë po atë fakt në mënyrë primare. Për më tepër që, vendimi penal që pretendohet se përbën shkak për rishikimin e vendimit të dënimit të kërkuarit, është përmbjllur rreth 8 vjet (2009) përpara se të përmbjllë gjykimi penal i themelit ndaj kërkuarit (2017). Pra, gjatë kohës që kërkuari po gjykohej në themel, vendimi i dënimit të bashkëpunëtorit të tij ishte prej kohësh i formës së prerë dhe ai kishte mundësi të merrte dijeni për të e të kërkonte nga gjykatat e zakonshme ta vlerësonin në kuadër të saktësisë të fakteve dhe të rrethanave të çështjes.

4. Në këtë çështje shtrohej për diskutim kualifikimi i ndryshëm i veprës penale sipas neneve 76 ose 78 të KP-së, për sa i përket ekzistencës së paramendimit në vrasjen e kryer në bashkëpunim. Paramendimi është aspekt i dashjes dhe nuk përbën një fakt objektiv të pasqyruar më vete, por interpretim i *mens rea* bazuar mbi rrethanat e çështjes, ashtu siç janë vërtetuar gjatë gjykimit. Interpretimi ligjor i fakteve është veprimtari gjyqësor që nuk mund të përbëjë kurrësi shkak për rishikim, pasi nëse pranohet e kundërta, atëherë hapet rruga për arbitraritet.

5. Pakica vlerëson se në kërkesën për rishikim nuk është ngritur asnjë problematikë e argumentuar që mund të inkadrohet në fushën e zbatimit të nenit 450 të KPP-së, për sa u përket aspekteve faktike, të cilat ka marrë parasysh gjykata e apelit në rastin e ndryshimit të kualifikimit të dënimit të bashkëpunëtorit P. M., sipas arsytimit të vendimit nr. 207/2007, të kësaj gjykate. Kërkesa drejtuar Gjykatës nga kërkuari në faqen 5 të saj përcakton qartë edhe thelbin e shkakut të rishikimit për të cilin ishin ankuar me rekurs në Gjykatën e Lartë, e konkretisht: “Në vendimin ndaj P. M. pranohet se viktima është dërguar drejt spitalit dhe vdekja nuk është e tipizuar si e menjëhershme, ndërsa në vendimin ndaj kërkuarit vdekja

cilësobet e menjëhershme dhe injoroben fjalët e fundit të viktimit (më vrau P. M.) të përcjella te E. Q.”. Po kështu, në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, të pasqyruar në faqen 4 të vendimit të Gjykatës së Lartë, kërkuari ka pretenduar vetëm se: “Vendimi për dënimin e Fran Ndreçës bie ndesh me vendimin për deklarimin fajtor dhe dënimin e shtetasit P. M., pasi një fakt i vendosur në themel të vendimit të dënimit të Fran Ndreçës nuk pajtohet me atë të një vendimi tjetër të formës së prerë, siç është ai për deklarimin fajtor të P. M. Është fjala këtu për momentin kur E. Q. pas të shtënave ka qenë e para që ka dalë nga lokali duke i dhënë ndihmën e parë viktimit M. L. dhe se viktima i ka thënë asaj se: “E kishte vrarë P. M.”, duke i lënë amanet që t’ia tregonte këtë fakt kumatit të tij të quajtur Gj. Gj. Në vendimin për dënimin e P. M. thuhet se viktima M. L. ka vdekur në spital, ndërsa në vendimin për dënimin e Fran Ndreçës jo vetëm që flitet për fjalët e fundit që viktima i ka thënë E. Q., por thuhet që vdekja e viktimit ka qenë e menjëhershme. Në këtë rast kemi të bëjmë me parashikimin e nenit 450, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së [...]”.

6. Tejt atyre që vetë kërkuari ka ngritur si shkak rekursi përpara Gjykatës së Lartë, shumica duke bërë një analizë të zgjeruar (tejt atyre që kërkuari ka pretenduar edhe në kërkesën drejtuar Gjykatës), ka konstatuar se: “Nga përmbajtja e vendimit nr. 207/2007, rezulton se gjykata e apelit ka pranuar se nuk ishte provuar ekzistenca e konflikteve të mëparshme midis viktimit dhe P. M., se konflikti kishte lindur në mënyrë të çastit, se vrasja kishte ndodhur pas një intervali prej 5–10 minutash dhe se ajo nuk ishte kryer me paramendim. Këto rrethana, ndonëse kanë çuar edhe në ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga “Vrasja me paramendim” në “Vrasja me dashje”, nuk përbëjnë vetëm një interpretim të ndryshëm juridik të së njëjtës situatë. Ato lidhen me fakte historike që kanë të bëjnë me origjinën dhe natyrën e konfliktit, zhvillimin e tij në kohë dhe ekzistencën ose jo të një vendimi paraprak për kryerjen e vrasjes. Për rrjedhojë, ato duhej të krahasoheshin konkretisht me faktet e vëna në themel të vendimit të dënimit të kërkuarit për vrasje me paramendim, të kryer në bashkëpunim, përfshirë faktin e pranuar se ai kishte ndihmuar P. M. në ekzekutimin e viktimit, duke e mbajtur atë që të mos lëvizte. Në veçanti, duhej të vlerësohej nëse situata faktike e pranuar nga gjykata e apelit për spontanitetin e konfliktit dhe mungesën e paramendimit ishte e pajtueshme me ekzistencën e një plani ose vendimi të përbashkët paraprak, mbi të cilin ishte mbështetur fajësia e kërkuarit.”. Kërkuari nuk ka ngritur pretendime se “fakti” i pajtueshëm me vendimin tjetër të formës së prerë, konform nenit 450, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së, lidhej me kohën prej 10 minutash nga konflikti i



parë me momentin e vrasjes, ose me ekzistencën apo jo të konflikteve të mëparshme midis palëve, por në lidhje vetëm me faktin nëse viktimë kishte vdekur ose jo menjëherë, apo kur ishte dërguar në spital (ose rrugës) dhe rrjedhimisht nëse kishte pasur mundësi t'ia thoshte fjalët dëshmitares. Për këtë element, në vendimin nr. 207/2007, Gjykata e Apelit Tiranë ka konstatuar faktin (e pajtueshëm me atë të konstatuar nga gjykatat në gjykimin e kërkuarit) se: *“Viktima M. L. është dërguar menjëherë në spital, por fatkeqësisht ka gjetur vdekjen përpara se të arrinte aty.”*

7. Pikërisht në lidhje me aq sa kërkuar si pretenduar si shkak rekursi, dhe për aq sa ai ka ngritur pretendime të argumentuara edhe përpara Gjykatës, duket se Gjykata e Lartë i ka kthyer përgjigje shteruese në paragrafin 19 të vendimit të saj kur ka arsyetuar se: *“Kolegji, referuar shkaqeve të ngritura në rekurs, e konsideron të drejtë konkluzionin e gjykatës së apelit se në rastin konkret nuk ka vend për rishikim, pasi nuk është prezent asnjë rast rishikimi, për sa kohë që dy gjykata të ndryshme faktin e pranojnë njësoj, por vlerësimin juridik për të e kanë bërë të ndryshëm. Pala kërkuar, kërkesën për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë e mbështet në shkronjën “a”, të nenit 450 të KPP-së, e cila parashikon se mund të kërket rishikimi kur faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë. Lidhur me këtë parashikim, Kolegji vlerëson se do të përbëjë shkak rishikimi vetëm rasti kur dy vendime gjyqësore të formës së prerë janë bazuar mbi fakte të ndryshme të pajtueshme me njëra-tjetrën. Nuk parashikohet dhe nuk mund të përbëjë shkak rishikimi vendimarrja e bazuar në vlerësimin e ndryshëm që dy gjykata i bëjnë të njëjtit fakt. Ligjvënësi ka dashur të parashikojë si shkak rishikimi konstatimin e fakteve të ndryshme dhe jo konstatimin e vlerësimit të ndryshëm të tyre, për vetë faktin se nuk mund t'i imponohet një gjykatë në proces rishikimi një arsyetim ose vlerësim i paracaktuar i fakteve. Përkundrazi, në kuadër të konstatimit të fakteve të ndryshme, gjykata e rishikimit ka detyrën të hetojë përsëri në lidhje me një fakt, i cili ka rezultuar ndryshe në një proces tjetër. Në rastin objekt gjykimi, Kolegji vlerëson se dy vendimet gjyqësore nuk kanë asnjë pajtueshmëri faktesh me njëra-tjetrën, por kanë një vlerësim të ndryshëm të të njëjtit fakt nga ana e dy gjykatave të ndryshme.”* Gjykata e Lartë ka marrë parasysh edhe vendimin nr. 207/2007, të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili, ndonëse ka ndryshuar kualifikimin juridik të veprës penale për bashkëpunëtorin P. M. (edhe ekzekutori i viktimës), nuk ka konstatuar fakte të tjera, të ndryshme nga ato

të konstatuara nga gjykatat në procesin ndaj kërkuarit, por thjesht ka parë ligjërisht në prizëm tjetër kohën e vrasjes dhe *mens rea* të fajtorit për atë vepër tjetër penale. Çmuarja e fakteve nga një gjykatë konform nenit 152, pika 1 të KPP-së, nuk përbën “fakt të pajtueshëm” për çmuarjen që një gjykatë tjetër do të bëjë për to, kur shqyrton çështjen penale të veçuar për bashkëpunëtorin tjetër. Nëse do të pranohej kjo, atëherë do të rrezikohej të lihej pa zbatim parimi i pavarësisë së gjykatës në gjykimin e çështjes të parashikuar nga neni 3, pika 2, i KPP-së, sipas të cilit “Gjykata jep vendim në bazë të provave që shqyrtohen e verifikohen në seancë gjyqësore.”

8. Kërkesa për rishikim, në këtë rast, për aq sa është pretenduar dhe argumentuar nga kërkuar, është, në thelb, një “apel i heshtur”, rrjedhimisht i palejueshëm, sepse nuk vë në diskutim mekanizmin e ngjarjes së rëndë kriminale të kulmuar me vrasjen e një njeriu, në mes të ditës e në një vend publik (kjo edhe nëse bazohemi te konstatimet e vendimit nr. 207/2007, të Gjykatës së Apelit Tiranë). Ndaj, jam i mendimit të mbetur në pakicë që, në këtë rast, Gjykata e Lartë, për aq sa i është pretenduar në rekurs, ka arsyetuar mjaftueshëm vendimin e vet dhe nuk kishte vend për cenimin e kësaj vendimarrjeje. Edhe në ankimin kushtetues individual kërkuar nuk ka argumentuar bindshëm ndonjë të drejtë kushtetuese që t'i jetë cenuar nga kjo vendimarrje.

Anëtarë: Asim Vokshi

VENDIM Nr. 81, datë 2.7.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Asim Vokshi,	anëtar;
Sonila Bejtja,	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 2.7.2026
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të



dokumenteve çështjen nr. 32 (E) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Evis Berberi, përfaqësuar nga avokatët Elda Zotaj dhe Gentjan Rumano, me prokurorë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, përfaqësuar nga prokurori Dritan Prençi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 370, datë 30.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 194 (87-2024-282), datë 10.10.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-159, datë 30.1.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilët vazhdon masa e sigurimit “Arrestimi në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, të caktuar ndaj shtetasit Evis Berberi me anë të vendimeve nr. 21, datë 13.3.2025 dhe nr. 27, datë 16.3.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, miratuar me vendimin nr. 16, datë 25.4.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 15, 17, 18, 27, 29, 31, 32, 38, 42, 42, 131, pika 1, shkronja “F”, dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, 6, 7, 10, 14 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 32 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit Evis Berberi (*kërkuari*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme, pas referimit të Byrosë Kombëtare të Hetimit (*BKH*), në datën 29.9.2023, ka regjistruar procedimin penal nr. 214/2023 për veprën penale “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal (*KP*), pa regjistruar emrin e ndonjë personi nën hetim. Në vijim, në datën 5.3.2024, në regjistrin e njoftimit të veprave penale, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar edhe veprat penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, të kryer në bashkëpunim, “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 244 e 25, 259 dhe 287/2 të *KP*-së. Për këto dy të fundit në regjister është shënuar edhe emri i kërkuarit, si person i dyshuar për kryerjen e tyre.

2. Konkretisht, nga Prokuroria e Posaçme, bazuar në provat e grumbulluara gjatë hetimit, është ngritur dyshimi se kërkuari, gjatë kohës së ushtrimit të detyrës së drejtuesit të Agjencisë së Eficiencës së Energjisë (*AEE*) dhe, më pas, të drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit Rrugor Shqiptar (*ARRSH*), ka kërkuar, ka pranuar dhe ka marrë në mënyrë të tërthortë nga një shoqëri tregtare (shoqëria “N”) përfitime të parregullta monetare, nëpërmjet një shoqërie tjetër tregtare të kontrolluar prej tij (shoqëria “D”). Marrja e përfitimeve të parregullta ka ndodhur pas fitimit prej shoqërisë “N” të procedurave të prokurimit publik të zhvilluara nga autoritetet publike kontraktore, titullar i të cilave ka qenë kërkuari, të cilat, më pas, i kanë kaluar vlerat monetare përmes transaksioneve të kësaj shoqërie me shoqërinë “D”, të zotëruar nga ai indirekt. Në vijim, vlerat monetare të përfituara në mënyrë të parregullt janë investuar për blerjen e pasurive të paluajtshme në emër të shoqërisë “D”, të cilat përbëjnë edhe produkte të veprës penale.

3. Në lidhje me këtë, sipas Prokurorisë së Posaçme, ka dyshime të bazuara në prova se gjatë kryerjes së detyrave publike në fjalë kërkuari ka përdorur dhe vazhdon të përdorë dy shoqëritë tregtare për të përfituar në mënyrë të paligjshme interesa financiarë prej tyre përmes shtetasit V.B., i



cili është në marrëdhënie shoqërore me të dhe shërben si lidhje mes tij dhe shoqërive tregtare në fjalë. Këto shoqëri janë krijuar nga shtetasi V.B., në gusht dhe në tetor 2017 dhe kërkuasi, në regjistrat tatimorë, shfaqet si i punësuar në to, në periudha të ndryshme. Ndërsa për shoqërinë “N” shtetasi V.B. ka vijuar të jetë ortak i vetëm dhe administrator, për shoqërinë “D”, sipas të dhënave të regjistrat tregtar, kuotat e saj, në datën 7.9.2018, i janë shitur kërkuasit për çmimin 100.000 lekë. Në datën 31.1.2019 kërkuasi ia ka shitur kuotat e kësaj shoqërie shtetasve B.B., në marrëdhënie shoqërore me bashkëshorten e tij, për çmimin 500.000 euro, kurse në datën 23.12.2021, kjo e fundit ia ka shitur ato shtetasit V.B. për çmimin 200.000.000 lekë. Dy muaj më pas, në datën 21.2.2022, kuotat e shoqërisë i janë shitur shtetasit E.L. për të njëjtin çmim dhe, pak më shumë se një muaj më pas, në datën 29.3.2022, ato i janë rishitur sërish shtetasit V.B. për çmimin zero lekë. Të gjitha këto transaksione, sipas Prokurorisë së Posaçme, janë fiktive, me qëllim për të mbuluar faktin e zotërimit nga kërkuasi të kësaj shoqërie, si dhe përfitimin nga ai, përmes kësaj shoqërie, të përfitimeve të parregullta dhe ligjërimin e tyre.

4. Kështu, sipas Prokurorisë së Posaçme, gjatë kohës kur kërkuasi ka ushtruar detyrën e drejtuesit të AEE-së, në vitet 2019-2021, shoqëria “N” ka deklaruar fatura tatimore shitjeje, duke përfituar nga AEE-ja të ardhura në shumën 85,756,654 lekë. Po kështu, gjatë kësaj periudhe, në vitin 2020, kjo shoqëri është shpallur fituese në tre procedura prokurimi publik të zhvilluara nga AEE-ja, për një vlerë totale 137,400,000 lekë, pa TVSH. Ndërkohë, gjatë kohës kur kërkuasi ka ushtruar detyrën e drejtorit të përgjithshëm të ARRSH-së, gjatë viteve 2021 dhe 2022, shoqëria “N” është shpallur fituese në tri procedura prokurimi publik të zhvilluara nga ARRSH-ja, për vlerën totale 101,811,343.88 lekë, pa TVSH. Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe, deri në datën 4.12.2023, referuar të dhënave të regjistrave tatimorë, ka rezultuar se shoqëria “D” ka deklaruar fatura tatimore shitjeje në drejtim të shoqërisë “N.” në vlerën totale 223,480,476 lekë, si dhe fatura tatimore për blerjen nga shoqëria “N” në vlerën totale 7,655,000 lekë.

5. Po kështu, nga të dhënat e dokumenteve bankare për shoqërinë “D” të drejtë veprimi në llogaritë bankare ka pasur edhe kërkuasi, i cili ka kryer veprime edhe gjatë kohës kur formalisht nuk kishte lidhje me këtë shoqëri. Gjithashtu, për

shoqërinë “N” ka pasur të drejtë për të kryer veprime në llogarinë e saj bankare edhe motra e kërkuasit. Ka rezultuar gjithashtu se shoqëria “D” ka bërë disa pagesa për faturat telefonike për numrin celular në përdorim të kërkuasit. Nga përmbajtja e telefonave celularë të sekuestruar personave ndaj të cilëve zhvillohen hetime, përfshirë edhe kërkuasin, kanë rezultuar komunikime për procedura prokurimi publik dhe veprime bankare mes shtetasve V.B., V.L. dhe B.B., por edhe mes shtetasve V.B. dhe V.L. me kërkuasin. Së fundmi, ka rezultuar se dy shoqëritë në fjalë janë bashkëpronare në pesë pasuri të paluajtshme të ndodhura në Tiranë.

6. Pas kërkesës së Prokurorisë së Posaçme të datës 7.3.2024, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 21, datë 13.3.2024, ndër të tjera, ka vendosur pranimin e saj, duke caktuar ndaj kërkuasit masën e sigurimit personal “Arresti në burg”. Kjo masë sigurimi personal është ekzekutuar po në datën 13.3.2024, ora 21:30.

7. Në datën 14.3.2024 Prokuroria e Posaçme ka kërkuar verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit personal edhe ndaj kërkuasit në zbatim të nenit 248 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). GJKKO-ja e Shkallës së Parë me vendimin nr. 27, datë 16.3.2024, ndër të tjera, ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg” të dhënë ndaj kërkuasit me vendimin nr. 21, datë 13.3.2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Pas ankimit edhe të kërkuasit, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 16, datë 25.4.2024, ka vendosur miratimin e vendimeve nr. 21, datë 13.3.2024 dhe nr. 27, datë 16.3.2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, për sa është disponuar për kërkuasin. Ky i fundit ka ushtruar rekurs dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-1690, datë 17.10.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Ky proces gjyqësor është bërë objekt kontrolli nga Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*), e cila, me vendimin nr. 40, datë 23.3.2026, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

8. Ndërkohë në datën 30.7.2024, pas 4 muajve nga caktimi i masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, kërkuasi i është drejtuar GJKKO-së së



Shkallës së Parë me kërkesë për dhënie informacioni në lidhje me hetimet e kryera për çështjen penale në ngarkim të tij, për procedimin penal nr. 214/2023, si dhe zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” me një masë sigurimi më të lehtë për shkak të rrethanave familjare dhe gjendjes shëndetësore të bashkëshortes, pasi është në pamundësi për të ushtruar të drejtat dhe detyrat ndaj fëmijëve.

9. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 370, datë 30.7.2024, ka vendosur: “Vazhdimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP-së, të caktuar ndaj kërkuesit me vendimin nr. 21, datë 13.3.2024 të GJKKO-së të Shkallës së Parë, të miratuar me vendimin nr. 16, datë 25.4.2024 të GJKKO-së së Apelit.”. Sipas asaj gjykate, edhe pse kërkuesi ka kërkuar dhënien e informacionit nga Prokuroria e Posaçme, bazuar në nenin 246, pika 6, të KPP-së, në thelb, kërkesa e tij është fokusuar te zëvendësimi i masës së sigurimit, për shkak të gjendjes shëndetësore të bashkëshortes së tij. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se nga informacioni me shkrim dhe nga aktet e paraqitura nga organi i akuzës nuk rezulton se ka ndryshuar ndonjë rrethanë në favor të kërkuesit, çka do të sillte dhe zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, por vazhdon të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm në lidhje me veprat penale në ngarkim të tij, i cili mbetet i pranishëm si në fazën fillestare të caktimit të asaj mase.

10. Po sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, edhe pas 4 muajve nga caktimi i masës së sigurimit, mbetet i pranishëm, ashtu si në momentin fillestar, rreziku ose frika e cenimit të marrjes ose të vërtetësisë së provave nga qenia e tij e lirë, apo me një masë më të butë, duke rrezikuar mbledhjen tërësore të provave dhe vërtetësinë e tyre, në kushtet kur procedimi penal është kompleks dhe provat janë ende të padokumentuara e në proces mbledhjeje. Në vlerësimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, vazhdon të jetë rreziku i ikjes së kërkuesit, si dhe rreziku/frika e përsëritjes së sjelljes së tij në kundërshtim me ligjin, duke vlerësuar gjithashtu se nevojat e sigurimit edhe në këtë moment ose stad të ecurisë së hetimeve paraprake janë në të njëjtin nivel me momentin e caktimit të masës së sigurimit “Arresti në burg”.

11. Lidhur me pretendimin e kërkuesit që ka të bëjë me rrethanat dhe situatën familjare, GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka konsideruar të paaftë për të influencuar rëndësinë e nevojave të sigurimit, për sa

kohë që në kriteret e veçanta përjashtuese të aplikimit të masës së sigurimit “Arresti në burg”, nuk parashikohet situata e veçantë familjare dhe situata e referuar nga kërkuesi nuk përfshihet në asnjë nga rastet që parashikon neni 230, pika 2, i KPP-së. Në këtë drejtim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se rrethanat e paraqitura nga kërkuesi nuk rezultojnë të jenë të tilla që të përligjin zëvendësimin e masës së sigurimit në kuptim të nenit 260, pika 2, të KPP-së.

12. Për ankimin e kërkuesit, GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 194 (87-2024-282), datë 10.10.2024, ka vendosur miratimin e vendimit nr. 370, datë 30.7.2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke vlerësuar se masa e sigurimit “Arresti në burg” ndaj kërkuesit është aktuale dhe e domosdoshme për të përmbushur nevojat e sigurimit. Sipas GJKKO-së së Apelit, elementet provuese të marra nga organi procedues tregojnë qëndrueshmërinë e masës së sigurimit të caktuar ndaj të hetuarit dhe, bazuar në provat e paraqitura nga organi i akuzës, dyshimi i arsyeshëm ndaj tij jo vetëm nuk është zbehur, por vijon të jetë i pranishëm dhe aktual, duke e përforcuar më tej atë (dyshimin e arsyeshëm) dhe nuk rezulton që të jenë zbutur nevojat e sigurimit. Për këtë arsye, sipas GJKKO-së së Apelit, masa e sigurimit “Arresti në burg” është më e përshtatshme.

13. Po sipas GJKKO-së së Apelit, është aktuale ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik qoftë marrjen e provave të tjera, qoftë vërtetësinë e tyre dhe çdo masë tjetër është e papërshtatshme për t'u vendosur ndaj të hetuarit, pasi rrezikshmëria e veprave penale që i atribuohet është e lartë dhe rrezikshmëria e autorit është e lartë. Në këtë kuptim, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se plotësohen kushtet e caktuara të nenit 228 të KPP-së, si dhe kriteret e përcaktuara nga neni 229 i KPP-së, pasi i hetuari dyshohet të ketë kryer vepra penale të cilësuar nga ligjvënësi si shumë të rënda.

14. Në vlerësimin e proporcionalitetit të masës së sigurimit, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se kërkuesi dyshohet se ka kryer veprat penale në bashkëpunim dhe që për sa i përket llojit të bashkëpunimit, nevojitet të zhvillohen hetime të thelluara për të konkluduar drejt në atribuimin e fakteve penale. Sipas GJKKO-së së Apelit, faktet e paligjshme të parashikuara nga nenet 259 dhe 287 të KP-së, për të cilat kërkuesi dyshohet, janë të konsiderueshme, sepse ato vepra penale kanë një



rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe bëhen akoma dhe më të rrezikshme nga prania e rrethanës bashkëpunuese, për përcaktimin e llojit të të cilit (bashkëpunimit) nevojiten hetime të thelluara nga organi procedues. Në këto kushte, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se kjo masë sigurimi është masa proporcionale më e përshtatshme me shkallën e nevojave të sigurimit, duke pasur parasysh natyrën dhe rëndësinë e faktit penal, sanksionit dhe të rrethanave rënduese që ekzistojnë së bashku me dyshimin për kryerjen e veprës penale atribuar të hetuarit.

15. Po kështu, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se masa e sigurimit “Arresti në burg” konsiderohet si më e përshtatshme për të mbrojtur nevojën paraprake, pasi ajo është në gjendje të shmangë rrezikun e ndotjes ose të marrjes së provave dhe çdo masë tjetër rezulton jo e përshtatshme ndaj nuk mund të urdhërohet të vendoset një masë sigurimi “më e butë”, sepse asnjë masë tjetër siguruese e ndryshme nga ajo e caktuar nuk është e aftë që të pengojë kontaktet me subjektet e tjera me të cilat mund të ketë bashkëpunuar kërkuesi. Ndërsa për kërkesën e kërkuesit për zëvendësimin e masës së sigurimit për shkak të gjendjes shëndetësore të bashkëshortes së tij, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se ajo është e pabazuar në ligj, pasi, bazuar në pikën 2 të nenit 230 të KPP-së, vazhdimësia e saj qëndron në raport me gjendjen shëndetësore veçanërisht të rëndë të vet personit që duhet t’i nënshtrohet masës së sigurimit.

16. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-159, datë 30.1.2025, ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, në praktikën e tij është mbajtur qëndrimi se jo çdo sëmundje e familjarëve të të arrestuarit mund të trajtohet si rast për mosaplikimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, ose për zëvendësimin e kësaj mase sigurimi me një masë tjetër më të butë, me përjashtim të rastit kur ndodhemi para një gjendjeje “*veçanërisht të rëndë shëndetësore*” dhe “*një rrethanë e tillë nuk mund të merret apriori duke u mbështetur në çfarëdo lloj pretendimi të palës kërkuese apo në akte shkrësore të paraqitura prej saj*”, pasi në një përfundim të tillë gjykata mund të arrijë vetëm nëpërmjet një akti ekspertimi mjeko-ligjor të caktuar sipas rregullave procedurale penale, në konkluzionet e të cilit duhet të përcaktohet qartë “gjendja veçanërisht

e rëndë shëndetësore” e familjarëve, njëkohësisht dhe “domosdoshmëria e prezencës së personit nën hetim” për të përmbushur funksionet familjare.

17. Sipas Kolegjit Penal, nga shqyrtimi i vendimmarrjes së gjykatave të faktit, konstatohet se gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë nuk është kërkuar kryerja e ndonjë akti ekspertimi mjeko-ligjor, ku të dokumentohet gjendja shëndetësore e bashkëshortes së rekursuesit në raport me aftësinë e saj për t’u kujdesur për fëmijët e mitur, por janë paraqitur akte ekspertimi të cilat janë kryer në rrugë private, ndërsa ligji procedural penal përcakton se gjatë hetimit paraprak akte/provat merren nga organi që procedon në këtë fazë (neni 151, pika 1, i KPP-së). Në këtë kuptim, Kolegji Penal ka arsyetuar se nga aktet e verifikuara nuk rezulton që gjendja shëndetësore e bashkëshortes së kërkuesit të jetë veçanërisht e rëndë ose që ajo është në pamundësi absolute për t’u kujdesur për fëmijët e mitur, duke mbështetur argumentet e gjykatave të faktit se kjo rrethanë nuk mund të jetë përcaktuese për ndryshimin e masës së sigurimit ndaj të hetuarit, kur kjo vihet në raport me faktin penal dhe me nevojat e sigurimit për vijimin e hetimit.

18. Po kështu, Kolegji Penal ka arsyetuar se pretendimet e kërkuesit se nuk ekzistojnë shkaqe që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provave, apo se nuk ekziston rreziku i ikjes dhe i kryerjes të së njëjtës vepër penale, apo më të rëndë, janë marrë në shqyrtim nga gjykatat më të ulëta dhe arsyetimi i gjykatës së apelit në këtë drejtim është i mjaftueshëm referuar rrethanave të faktit dhe provave që mbështesin dyshimin se i hetuari mund të jetë i përfshirë në kryerjen e veprave penale që paraqesin rrezikshmëri. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, arsyetimi i GJKKO-së së Apelit është i bazuar në fakte e në prova, duke dhënë arsytet se përse ndaj të hetuarit duhet të vijojë zbatimin e masës “Arresti në burg”, në përputhje me parimin e përshtatshmërisë dhe të proporcionalitetit.

19. Në datën 16.9.2025 (sipas shënimit të shërbimit postar) kërkuesi i është drejtuar Gjykata me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 28.10.2025. Kolegji i Gjykatës, në datën 30.12.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seance plenare mbi bazë të dokumenteve.



II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

20. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

20.1. *E drejta për liri personale*, e garantuar nga neni 27 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë nuk ka pranuar kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, për shkak të kushteve veçanërisht të rënda, duke dhënë një vendim pa një analizë të mjaftueshme ligjore të nevojshmërisë dhe të proporcionalitetit të saj. Gjykata e Lartë, në kundërshtim me ligjin, me praktikën gjyqësore, me jurisprudencën kushtetuese dhe atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka pranuar arsyetimin e gjykatës së apelit për rrëzimin e kërkesës edhe pse ka pranuar rrethanën e trajtimit të çështjes për shkak të kushteve veçanërisht të rënda të familjes. Masa e sigurimit personal “Arresti në burg” e caktuar ndaj kërkuesit, në kushtet aktuale familjare, për shkak të gjendjes shëndetësore dhe psikologjike të bashkëshortes së tij nuk është e përshtatshme dhe proporcionale me nevojat e sigurimit. Kushtet familjare, konkretisht ato që kanë të bëjnë me shëndetin e bashkëshortes, gjendjen e pamundësisë për t’u kujdesur plotësisht për fëmijët, gjendjes së rënduar psikologjike të tyre, krijojnë premisat për mundësinë e zëvendësimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”. Në rastin konkret, gjykatat nuk kanë arsyetuar në mënyrë konkrete dhe të individualizuar, por kanë dhënë vetëm një arsyetim teorik. Arsyetimi i gjykatave është tërësisht i kufizuar pa marrë në konsideratë interesin më të lartë, që është ai i jetës, i shëndetit fizik dhe psikologjik.

20.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit në drejtim të mbajtjes së standardeve të dyfishta të gjyqimit nga Gjykata e Lartë*, pasi vendimi i asaj gjykate përmban arsyetim të ndryshëm nga çështje të ngjashme, për sa i përket rëndimit të pozitës procedurale të kërkuesit në vështrim të hetimeve paraprake, duke mos respektuar shkaqet e ankimit dhe duke gjykuar me standard të dyfishtë rekursin e tij. Gjykata e Lartë nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur shkaqeve të paraqitura, analizës së tyre, bazës ligjore dhe ka konkluduar më pas në vendimmarrjen e saj në kundërshtim me ligjin procedural dhe me Kushtetutën. Vendimi i Gjykatës së Lartë që ka miratuar vendimin e GJKKO-së së Apelit duhet të

konsiderohet si arbitrar ose me standard të dyfishtë arsyetimi në çështje të ngjashme.

20.3. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor në drejtim të parimit të proporcionalitetit*, pasi gjykatat e posaçme nuk kanë arsyetuar mjaftueshëm për vlerësimin e masave të tjera të sigurimit të vlerësuar si masa më të buta, por kanë arsyetuar vetëm në mënyrë teorike për rrezikun e ikjes dhe ndikimit të provave. Në rastin konkret, për sa kohë konstatohet mungesë në vlerësimin e elementit të nevojës për kufizimin e të drejtave dhe lirive të kërkuesit, në raport mbarrëvajtjen e procedimit penal, çka është e detyrueshme sipas Kushtetutës dhe KPP-së, kjo përbën shkak të mjaftueshëm për të konstatuar cenimin e parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës “Arresti në burg”. Mungesa e arsyetimit të nevojës në caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg, në kushtet kur arsyetimi i gjykatave ka përmbajtje vetëm teorike dhe aspak të mbështetur në bazën e provave të parashtruara nga prokuroria, tregon, ndër të tjera, mosvlerësimin e këtij aspekti kushtetues dhe ligjor nga ana e gjykatave në caktimin e masave të sigurimit personal. Për rrjedhojë, caktimi i kësaj mase ka cenuar, në aspektin substancial, të drejtën për proces të rregullt ligjor. Vendimet e gjykatave nuk kanë arsyetuar mjaftueshëm dhe nuk u kanë dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të kërkuesit.

20.4. *Trajtimi degradues*, pasi gjykatat kanë rrëzuar *a priori* kërkesën, ankimin dhe rekursin, pa marrë dhe pa administruar një mendim të specializuar të mjekëve si ekspertë. Gjykata e Lartë në pjesën “arsyetuese” ka kundërshtuar vendimmarrjen e gjykatave të posaçme kur pranon që duhet të shqyrtohet kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit personal për shkak të kushteve të rënda të familjes, por në anën tjetër ka arsyetuar se kërkesa për zëvendësim shqyrtohet vetëm në rastet nëse kushtet veçanërisht të rënda shëndetësore i ka personi nën hetim dhe jo familjarët e tij. Analiza e Gjykatës së Lartë për të përdorur si kriter veprat penale, për të cilat akuzohet kërkuesi, bie në kundërshtim me natyrën e nenit 3 të KEDNJ-së, i cili mbron një të drejtë absolute. Kërkuesit, duke mos iu ndryshuar masa e sigurimit, i janë rrezikuar shëndeti fizik dhe mendor i familjes, pasi në kushtet e burgimit, nuk mund t’i ofrohet kujdesi bashkëshortes, që ka dëmtime serioze të shëndetit, si dhe fëmijëve.



21. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

21.1. Pretendimet e kërkuarit për *cenimin e lirisë personale* janë të pabazuara, pasi nga gjykatat është respektuar kriteri kushtetues i dyshimit të arsyeshëm për justifikimin e kufizimit të asaj lirie, duke arsyetuar mjaftueshëm lidhur me kushtet e përcaktuara nga neni 228 i KPP-së. Po ashtu, edhe Gjykata e Lartë i ka shqyrtuar pretendimet e ngritura në rekurs nga kërkuari sipas rregullimeve ligjore që normojnë shqyrtimin e rekursit, duke analizuar ligjshmërinë e vendimarrjes së gjykatave më të ulëta dhe duke arsyetuar qëndrimin e saj. I pabazuar është dhe argumenti i kërkuarit se gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë interesin më të lartë të jetës dhe shëndetit fizik e psikologjik, pasi gjykatat jo vetëm që kanë arsyetuar në drejtim të mospërmblidhjes së kriterëve ligjore për një pretendim të tillë, por kanë arsyetuar edhe mbi provat e paraqitura nga kërkuari në këtë drejtim.

21.2. I pabazuar është edhe pretendimi për *cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi nga Gjykata e Lartë janë marrë në shqyrtim, janë analizuar dhe iu është dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuarit, brenda shkaqeve të rekursit. Po ashtu, rezultojnë se gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm lidhur me legjitimitetin, përmblidhjen e kriterëve ligjore të shkaqeve të mjeteve të ankimit, fakteve të çështjes, si dhe përmblidhjen ose jo të kriterëve ligjore për ndryshimin e masës së sigurimit, duke respektuar kështu edhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në këtë kuptim, kërkuari i është garantuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

21.3. Pretendimi i kërkuarit për *cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në drejtim të parimit të proporcionalitetit* është i pabazuar, pasi gjykatat në vendimet e tyre kanë dhënë arsyetim të plotë dhe të mjaftueshëm lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, bazuar në provat konkrete, si dhe mbi ekzistencën e shkaqeve ligjore për caktimin e masës së sigurimit, përfshirë rrezikun e cenimit të marrjes ose vërtetësisë së provave, po ashtu edhe rrezikun e largimit të tij, të vlerësuar këto në raport me rrethanat e faktit dhe personalitetit të tij. Gjykatat kanë arsyetuar edhe në lidhje me vlerësimin se asnjë masë sigurimi tjetër me e butë nuk do të ishte e përshtatshme për garantimin e mbarëvajtjes së procesit penal.

21.4. I pabazuar është edhe pretendimi për *trajtimin denigrues*, pasi referuar vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, gjendja shëndetësore e bashkëshortes së kërkuarit është marrë në shqyrtim nga ai kolegji, nga ku rezultojnë se është në ndjekje terapeutike, trajtohet me fizioterapi dhe se mënyra e mjetshme e kurimit varet nga ecuria e gjendjes shëndetësore, duke rezultuar kështu se gjendja shëndetësore e saj nuk është “veçanërisht e rëndë” që të ndodhet në pamundësi absolute për t’u kujdesur për fëmijët e mitur. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, neni 3 i KEDNJ-së zbatohet vetëm nëse trajtimi i shtetit ndaj individit arrin një nivel minimal ashpërsie, i cili vlerësohet mbi bazën e pasojave fizike ose mendore që i shkaktohen vetë personit të ndaluar, ndërsa kërkuari ka kërkuar zëvendësimin e masës për shkak të gjendjes shëndetësore të bashkëshortes së tij. Po ashtu, caktimi i ekspertit mjeko-ligjor nuk përbën detyrim për gjykatat, por varet nga nevoja për sqarimin e rrethanave që kanë rëndësi për vendimarrjen. Gjykatat kanë shqyrtuar në mënyrë të plotë dhe të arsyetuar pretendimet e kërkuarit, duke balancuar interesat e dala nga rrethanat konkrete të çështjes, me interesin publik më të lartë, sikurse është garantimi i mbarëvajtjes së procesit penal.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

22. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

23. Duke pasur parasysh natyrën kumulative të kriterëve të legjitimitetit dhe jurisprudencën e saj,



Gjykata vëren se kriteret *rationae personae*, *shterimi i mjeteve juridike*, në drejtim të aspektit formal, lidhur me natyrën e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara dhe *ratione temporis* janë të përmbushura. Në lidhje me to nuk rezulton të ketë çështje që kërkojnë analizë të mëtejshme. Po ashtu, as subjekti i interesuar nuk ka ngritur ndonjë prapësim.

24. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në drejtim të aspektit substancial, lidhur me pretendimet e ngritura në ankimin kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se ky kriter kërkon që pretendimet që parashtrohen përpara kësaj Gjykate të jenë paraqitur më parë në gjykatat e zakonshme, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 41, datë 26.3.2026; nr. 3, datë 15.1.2026; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë degraduese, duke argumentuar, në thelb, se gjykatat kanë rrëzuar *a priori* kërkesën, ankimin dhe rekursin, pa marrë dhe administruar një mendim të specializuar të mjekëve, si ekspertë. Sipas kërkuesit, duke mos u ndryshuar masa e sigurimit me një masë më të butë, atij i është rrezikuar shëndeti fizik dhe mendor i familjes, pasi në kushtet e burgimit nuk mund t'i ofrohet kujdesi bashkëshortes, që ka dëmtime serioze të shëndetit, si dhe fëmijëve të tij. Në lidhje me këtë pretendim, referuar kërkesës dhe materialeve të ardhura me të, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk e ka ngritur atë në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë. Për këtë arsye, Gjykata evidenton se ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në aspektin substancial për këtë pretendim, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim. Për sa u takon pretendimeve të tjera, Gjykata konstaton se ai i ka shteruar mjetet juridike efektive për to.

26. Ndërsa në lidhje me legjitimin *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi, sipas tij, vendimi i Gjykatës së Lartë përmban arsyetim të ndryshëm nga çështje të ngjashme, por nuk ka paraqitur ndonjë argument konkret ose vendim të Gjykatës së Lartë që përmban këtë arsyetim të ndryshëm nga çështja e tij. Gjykata në jurisprudencën e saj, kur janë ngritur pretendime në lidhje me cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit për mënyrën sesi gjykatat kanë vendosur në raste të ngjashme, ka theksuar se vlerësimi kushtetues i

mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti, duke iu referuar edhe rastit konkret. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *a priori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 17, datë 23.3.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në vështtrim të jurisprudencës kushtetuese së mësipërme, Gjykata çmon se jo vetëm argumentet e paraqitura nga kërkuesi në mbështetje të pretendimit për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* janë të përgjithshme, po edhe Gjykata e Lartë në vendimmarrjen e saj nuk rezulton të ketë vendosur në mënyrë të ndryshme me ndonjë vendim unifikues a njëses të praktikës gjyqësore. Për rrjedhojë, fakti që Kolegji Penal i asaj gjykate mund të ketë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, nuk përbën argument që mund të mbështesë pretendimin për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor nga pikëpamja kushtetuese, ndaj ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim.

28. Po në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae* në ankimin kushtetues individual, kërkuesi, ndër të tjera, i ka parashtuar pretendimet e tij në drejtim të cenimit të: i. lirisë personale në aspekt të mungesës së analizës së gjykatave për nevojshmërinë dhe proporcionalitetin e vazhdimt të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, për shkak të kushteve familjare të tij; ii. së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

29. Gjykata, në rastin e masave të sigurimit, ka pohuar se ajo i trajton pretendimet në drejtim të lirisë personale, si e drejtë substanciale, ndërsa pretendimet për proces të rregullt i trajton si aspekte procedurale të lirisë personale, duke u ndalur në aspekte të veçanta, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 41, datë 26.3.2026; nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 29, datë 16.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon të analizojë në themel pretendimet e tjera të kërkuesit



për cenimin e lirisë personale, në raport me parimin e proporcionalitetit, lidhur me standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, për përshtatshmërinë e vazhdimit të masës së kufizimit të lirisë personale.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë personale, në raport me parimin e proporcionalitetit, lidhur me standardin e arsyetimit

31. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë në vendimin e saj nuk ka bërë një analizë të mjaftueshme ligjore të nevojshmërisë dhe proporcionalitetit të vazhdimit të masës së sigurimit “Arresti në burg” dhe nuk ka marrë parasysh kushtet veçanërisht të rënda të familjes së tij, konkretisht bashkëshortes. Sipas kërkuesit, masa e sigurimit personal “Arresti në burg” e caktuar ndaj kërkuesit, në kushtet aktuale familjare, për shkak të gjendjes shëndetësore dhe psikologjike të bashkëshortes së tij, nuk është e përshtatshme dhe proporcionale me nevojat e sigurimit dhe mbarëvajtjen e procedimit penal. Në këtë rast, sipas kërkuesit, gjykatat nuk kanë arsyetuar në mënyrë konkrete dhe të individualizuar, por kanë dhënë vetëm një arsyetim teorik, pa marrë në konsideratë interesin më të lartë, që është ai i jetës, shëndetit fizik dhe psikologjik. Po ashtu, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat nuk kanë arsyetuar mjaftueshëm për vlerësimin e masave të tjera të sigurimit.

32. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar duke argumentuar se nga gjykatat është respektuar kriteri kushtetues i dyshimit të arsyeshëm për justifikimin e kufizimit të lirisë, duke arsyetuar mjaftueshëm lidhur me kushtet e përcaktuara nga neni 228, i KPP-së. Po sipas subjektit të interesuar, gjykatat kanë marrë në konsideratë interesin më të lartë të jetës dhe shëndetit fizik e psikologjik, duke i arsyetuar vendimet e tyre në drejtim të mospërbushjes së kriterëve ligjore për një pretendim të tillë, dhe kanë arsyetuar edhe mbi provat e paraqitura nga kërkuesi në këtë drejtim. Sipas Prokurorisë së Posaçme, gjykatat kanë dhënë arsyetim të plotë dhe të mjaftueshëm për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, bazuar në provat konkrete: ekzistencën e shkaqeve ligjore për caktimin e masës së sigurimit, përfshirë rrezikun e cenimit të marrjes ose vërtetësisë së provave; rrezikun e largimit të kërkuesit, të vlerësuar këto në raport me rrethanat e faktit dhe personalitetit të tij; si dhe në lidhje me vlerësimin se asnjë masë siguri tjetër me e butë

nuk do të ishte e përshtatshme për garantimin e mbarëvajtjes së procesit penal.

33. Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (*pika 1*) dhe se liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastin kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj (*pika 2, shkronja “e”*). Në nenin 28 të Kushtetutës janë parashikuar garancitë procedurale në rastet e heqjes së lirisë, ku përfshihet edhe e drejta për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të pasur një gjykim brenda një afati të arsyeshëm ose për t'u proceduar i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit.

34. Gjykata ka pohuar se kushtet, kriteret dhe procedurat gjyqësore për rivlerësimin dhe zëvendësimin e arrestit në burg janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e lirisë së personit (*shih vendimet nr. 41, datë 26.3.2026; nr. 51, datë 18.10.2023; nr. 40, datë 18.7.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Masa e sigurimit personal mund dhe duhet të ndryshohet, duke u zëvendësuar me një më të lehtë ose më të rëndë, në varësi të ndryshimit të kushteve që ekzistojnë kur ajo është caktuar (*shih vendimet nr. 41, datë 26.3.2026; nr. 40, datë 14.5.2024; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Gjykata në jurisprudencën e saj, gjithashtu, ka pohuar se, në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja “c”, të Kushtetutës, caktimi i arrestit në burg kërkon ekzistencën e disa kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, përfshirë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individi ka kryer një vepër penale (*neni 228 i KPP-së*), si dhe përmbushjen e disa kriterëve të veçanta (*neni 230 i KPP-së*). Vijimi i ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm është një kusht *sine qua non* për vlefshmërinë edhe të vazhdimit të paraburgimit. Megjithatë ka një dallim të dukshëm midis situatës kur gjykatat shqyrtojnë për herë të parë, “menjëherë” pas arrestimit, nëse personi i dyshuar do të qëndrojë në paraburgim, me situatën kur pas një kohe të caktuar nevojitet vijimi i masës së arrestit. Në këtë rast të fundit, me kalimin e kohës, dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova nuk mjafton. Prandaj organet proceduese duhet të japin njëkohësisht arsye të qarta, relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar vijimin e paraburgimit, konform rrethanave individuale të secilit rast penal (*shih*



vendimet nr. 41, datë 26.3.2026; nr. 7, datë 28.1.2026; nr. 86, datë 30.12.2024, të Gjykatës Kushtetuese).

36. Po në këtë këndvështrim, në lidhje me kohëzgjatjen e arrestit, Gjykata ka pohuar se çështja nëse një periudhë kohore e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte, por në bazë të fakteve të secilit rast dhe veçorive të tij specifike. Prandaj, vazhdimi i paraburgimit mund të justifikohet në një rast të caktuar vetëm nëse ka tregues specifikë të një kërkesë të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale të përcaktuar në nenin 27 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së (*shih vendimet nr. 41, datë 26.3.2026; nr. 86, datë 30.12.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se, në kuptim të nenit 28, pika 3, të Kushtetutës, në lidhje me nenin 27 të saj dhe nenin 5, paragrafi 3, të KEDNJ-së, kalimi i kohës në paraburgim përbën një faktor me rëndësi kushtetuese në kontrollin e vijimit të masës së sigurimit “Arresti në burg”. Megjithatë, ai në vetvete nuk sjell automatikisht zëvendësimin ose revokimin e masës, por rëndon barrën e organeve proceduese për të provuar se vijnë të ekzistojnë kushtet dhe nevojat e sigurimit që e justifikojnë vijimin e paraburgimit. Në këtë kuptim, prokuroria duhet të tregojë se ka vepruar me kujdesin e nevojshëm dhe pa vonesa të pajustificuara në kryerjen e veprimeve hetimore ose procedurale, ndërsa gjykata duhet të verifikojë, në mënyrë të pavarur dhe të individualizuar, jo vetëm vazhdimësinë e dyshimit të arsyeshëm, por edhe nëse arsyet e tjera të paraqitura për mbajtjen e personit në paraburgim mbeten konkrete, të rëndësishme, të mjaftueshme dhe të domosdoshme. Po ashtu, gjykata duhet të shqyrtojë nëse, me kalimin e kohës, nevojat e sigurimit që kanë përlligjur fillimisht masën vazhdojnë të jenë reale dhe aktuale, si dhe nëse ato mund të garantohen nëpërmjet garancisë pasurore ose masave të tjera më të lehta të sigurimit. Kjo analizë duhet të zhvillohet në mënyrë të individualizuar, duke iu përgjigjur fakteve dhe rrethanave specifike të rastit konkret, pa e zhvendosur barrën te personi i paraburgosur për të provuar arsyet që justifikojnë lirimin e tij. Kjo nuk përjashton detyrimin e personit të paraburgosur që rrethanat që zbusin nevojat e sigurimit t’ua bëjë të ditura organeve proceduese në përputhje me nenin

260 të KPP-së (*shih vendimin nr. 41, datë 26.3.2026, të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Gjykata konstaton se objekti i ankimit kushtetues individual lidhet në thelb me vendimet gjyqësore të cilat nuk kanë pranuar kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, ndonëse kërkuesi ka parashtruar që bashkëshortja e tij ishte në gjendje të rëndë shëndetësore. Prandaj, Gjykata, në vijim, do të analizojë nëse në rastin konkret gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm në lidhje me vijimin e zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në burg”, caktuar ndaj kërkuetit, si dhe nëse është respektuar kriteri kushtetues i proporcionalitetit për justifikimin e saj.

39. Për sa më lart, Gjykata konstaton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur vazhdimin e qëndrimit të kërkuetit nën masën e sigurimit “Arresti në burg”. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, nevojat e sigurimit edhe në këtë moment ose stad të ecurisë së hetimeve paraprake janë në të njëjtin nivel me momentin e caktimit të masës së sigurimit “Arresti në burg”, pasi i vazhdon të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm në lidhje me veprat penale në ngarkim të tij; *ii*. edhe pse kanë kaluar 4 muaj nga caktimi i masës së sigurimit, ekziston rreziku ose frika e cenimit të marrjes apo vërtetësisë së provave nga qenia e tij e lirë ose me një masë më të butë; *iii*. ekziston rreziku i ikjes së kërkuetit, si dhe frika se ai mund të kryejë sjellje të tjera në kundërshtim me ligjin. Lidhur me kërkesën e kërkuetit për zëvendësimin e masës së sigurimit me një masë të butë, për shkak të gjendjes shëndetësore të bashkëshortes së tij, GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka konsideruar të paaftë për të influencuar rëndësinë e nevojave të sigurimit, për sa kohë që në kriteret e veçanta përjashtuese të aplikimit të masës së sigurimit “Arresti në burg” nuk parashikohet situata e veçantë familjare dhe situata e referuar nga kërkuesi nuk përfshihet në asnjë nga rastet që parashikon neni 230, pika 2, i KPP-së (*shih paragrafin 9 të vendimit*).

40. Gjatë gjykimit pranë GJKKO-së së Shkallës së Parë, mbrojtësit e kërkuetit në seancën e datës 30.7.2024 kanë paraqitur raportin mjeko-ligjor dhe atë psikologjik të bashkëshortes së kërkuetit, të bërë në mënyrë private, si dhe i kanë kërkuar asaj gjykate caktimin e një eksperti për të kryer një akt ekspertimi tjetër. Në përfundim të seancës, GJKKO-ja e Shkallës së Parë i ka pranuar si të rregullta aktet e depozituara nga mbrojtja e kërkuetit dhe ka



konsideruar se nuk është e nevojshme që të kryhet një akt ekspertimi mjeko-ligjor ose psikologjik tjetër *(shih procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 30.7.2024)*.

41. Ndërkohë, mbi ankimin e kërkuarit, GJKKO-ja e Apelit ka vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke vlerësuar se masa e sigurimit “Arresti në burg” është aktuale dhe e domosdoshme për të përmbushur nevojat e sigurimit, pasi dyshimi i arsyeshëm vijon të jetë i pranishëm e aktual, ndaj masa e sigurimit “Arresti në burg” është më e përshtatshme dhe çdo masë tjetër është e papërshtatshme për t’u vendosur ndaj tij. Sipas GJKKO-së së Apelit, vijon të jetë aktuale ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen e provave të tjera dhe vërtetësinë e tyre, si dhe nevojitet të zhvillohen hetime të thelluara në drejtim të fakteve penale për rrethanën e bashkëpunimit. Lidhur me kërkesën e kërkuarit për zëvendësimin e masës së sigurimit për shkak të gjendjes shëndetësore të bashkëshortes së tij, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se ajo është e pabazuar në ligj, pasi bazuar në pikën 2 të nenit 230 të KPP-së, vazhdimësia e saj qëndron në raport me gjendjen shëndetësore veçanërisht të rëndë të vet personit që duhet t’i nënshtrohet masës së sigurimit *(shih paragrafin 10 të vendimit)*.

42. Mbi rekursin e kërkuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, duke arsyetuar se nuk rezulton që gjendja shëndetësore e bashkëshortes së kërkuarit të jetë veçanërisht e rëndë ose që ajo është në pamundësi absolute për t’u kujdesur për fëmijët e mitur. Sipas Kolegjit Penal, gjatë shqyrtimit të çështjes pranë gjykatës së shkallës së parë nuk është kërkuar kryerja e ndonjë akti ekspertimi mjeko-ligjor, por janë paraqitur akte ekspertimi të cilat janë kryer në rrugë private. Po ashtu, Kolegji Penal e ka vlerësuar të drejtë dhe të mjaftueshëm arsyetimin e gjykatave më të ulëta për pretendimet e kërkuarit se nuk ekzistojnë shkaqe që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provave apo se nuk ekziston rreziku i ikjes dhe i kryerjes të së njëjtës vepër penale ose më të rëndë, duke i vlerësuar ato në përputhje me parimin e përshtatshmërisë dhe të proporcionalitetit *(shih paragrafin 11 të vendimit)*.

43. Në këndvështrim të sa më lart, në analizë të vendimmarrjes së gjykatave të posaçme dhe të Gjykatës së Lartë për informacionin e paraqitur nga Prokuroria e Posaçme, bazuar në kërkesën e kërkuarit, ku, në thelb, ai ka kërkuar zëvendësimin e

masës së sigurimit “Arresti në burg” me një masë më të butë, për shkak të gjendjes shëndetësore të bashkëshortes së tij, Gjykata konstaton se ato (gjykatat) kanë analizuar se dyshimi i arsyeshëm vijonte të ekzistonte, pasi kishte arsye të qarta, relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar vijimin e qëndrimit të kërkuarit nën masën e sigurimit “Arresti në shtëpi” në përputhje me rrethanat individuale të tij. Në këtë rast, Gjykata vëren se gjykatat kanë arsyetuar edhe se Prokuroria e Posaçme ka vepruar me kujdesin e nevojshëm dhe pa vonesa të pajustificuara në kryerjen e veprimeve hetimore ose procedurale, si dhe kanë verifikuar arsyet e tjera (rreziku i ikjes dhe dëmtimi i provave), që sipas tyre mbeten konkrete, të rëndësishme, të mjaftueshme dhe të domosdoshme. Po ashtu, Gjykata eidenton se gjykatat e zakonshme kanë shqyrtuar dhe kanë vlerësuar se edhe pse kanë kaluar 4 muaj nga caktimi i masës së sigurimit “Arresti në burg”, nevojat e sigurimit që kanë përligjur fillimisht atë masë vazhdojnë të jenë reale dhe aktuale dhe kjo analizë është zhvilluar në mënyrë të individualizuar prej tyre, duke iu përgjigjur fakteve dhe rrethanave specifike të rastit konkret, pa e zhvendosur barrën te personi i paraburgosur (kërkuari) për të provuar arsyet që justifikojnë lirimin e tij.

44. Në rastin konkret, për sa i përket pretendimit të kërkuarit për gjendjen shëndetësore të bashkëshortes, si shkak për zëvendësimin e masës së sigurimit personal të dhënë ndaj tij, Gjykata konstaton se gjykatat e posaçme, pasi e kanë marrë në shqyrtim atë, i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar se, nga njëra anë, gjendja shëndetësore e bashkëshortes nuk ishte e tillë që të justifikonte një masë më të lehtë dhe, nga ana tjetër, se neni 230, pika 2, i KPP-së parashikon si shkak për mosvendosjen e masës së sigurimit “Arresti në burg” gjendjen shëndetësore të vet personit ndaj të cilit është caktuar masa. Në vlerësimin e Gjykatës, arsyetimi i gjykatave të posaçme në lidhje me këtë shkak të parashtruar nga kërkuari nuk është i tillë që të cenojë parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes në lirinë e tij personale për shkak të lënies në fuqi të masës së sigurimit “Arresti në burg”.

45. Për sa i takon gjykimit në Gjykatën e Lartë, Gjykata vëren se në vendimin e asaj gjykate ka një pasaktësi lidhur me faktin e paraqitjes nga kërkuari, në gjykatat më të ulëta, të kërkesës për kryerjen e aktit të ekspertimit mjeko-ligjor për gjendjen e bashkëshortes së tij, çka, sipas asaj gjykate, nuk është



kërkuar. Megjithatë, pavarësisht kësaj pasaktësie të konstatuar në vendimin e Gjykatës së Lartë, Gjykata evidenton se ajo nuk është e tillë që të sjellë pasoja në të drejtat substanciale të kërkuesit, konkretisht në lirinë personale dhe të drejtën për proces të rregullt në drejtim të arsyetimit të vendimit gjyqësor, për sa kohë prej asaj gjykate është arsyetuar mjaftueshëm për gjendjen shëndetësore të bashkëshortes së kërkuesit, duke e cilësuar atë si jo veçanërisht të rëndë, si dhe për ndikimin e saj në ndryshimin e masës së sigurimit në raport me faktin penal dhe me nevojat e sigurimit për vijimin e hetimit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara.

46. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale në drejtim të parimit të proporcionalitetit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 2.7.2026.

Shpallur më 17.7.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Asim Vokshi

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 208 lekë



||FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË||Vulosur elektronikisht nga Qendra e
Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 157|Datë: 22.07.2026 15:30:25
+02:00|52a6cca0-039f-4302-9064-cb9eea64d39f

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e
Botimeve Zyrtare)